Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (131). MARS 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Të injoruar, por jo të dorëzuar

Deklaratë e Grupit të Lobimit në përvjetorin e katërt të peticionit për Rrugën e Arbrit



2

Uji derdhet, toka thahet

Nga **Osman Xhili**



21

Fjalori i Hajri Shehut, një nga veprat më të mira leksikografike

Nga prof. dr. **Enver Hysa**



12

TURIZMI, Dibra e panjohur



Liqeni n'Kep (Shtrunkse). Foto: © Agim TOTRAKU

Rruga e Arbrit i shërben zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor

Objektet arkitekturore të Dibrës, *mundësi për zhvillimin e turizmit kulturor*

Për në Petralbë, *një rrugë drejt historisë* **Rabdisht-Bellovë** *një udhëtim i paharrueshëm* **Natyra** *dibrane, "guaska" që mban "perlën" e bukurisë shqiptare* **Banjat dhe mali**, *destinacionet turistike në rritje në Dibrën e Madhe*

Speciale e përgatitur nga **Bashkim LLESHI, Abdurahim ASHIKU, Adi DARSI, Shuaip MARKU, Fatbardh CENA, Grehans UKA** - Faqe **4-11**

NË BRENDËSI: **Shkëlqim Canin** e lamë vetëm **Të shkosh** për Dibër, t'i biesh nga Kina **Kostandini** e Doruntina dhe legjenda e Rrugës së Arbërit **Dibrës** po i ikin të rinjtë… **Muzika dibrane** në buzë të humnerës **Themelohet** Shoqata "Gryka e Vogël - Dibër" **Ertila**, vajza që mundi vdekjen **Lunada Methasani:** Punoni shumë në heshtje, lini suksesin të bëjë zhurmë për ju **Elvis Prençi:** Korabi do të bëhet faktor në Superligë **"Dritëhijet e një poeti",** libri i ri i Shaqir Skarrës **Dy botime** të reja nga Naim Berisha **Selim Alliu**, simbol i dijes, tolerancë dhe mirëkuptimit **Emin Jashari**, mësuesi që i Maqellarës **Letra anonime** nga vendlindja: "Ka bashkëpunuar me Ballin Kombëtar" **Dhimbja** për djemtë kufomë-prishur të mbetur deteve **Mort** në fshatin e largët **Intelektual** i vlerave dhe përkushtimit për jetën **Dodë Bibë Vladi**, kreshniku i Lurës **Mentor Disha** dhe familja Disha nga Dibra **Shefki Lleshi**, 50 vjet këshilltar i fshatit Zogje të Dibrës

Shaban Sinani, dibrani i parë i Akademisë së Shkencave



Dritëro Agolli: "Njeriut që i peshon më shumë truri se trupi"

Shaban Sinani, lindur më 16 prill 1958, në Ndërshen, një nga fshatrat e Lurës piktoreske të Dibrës, është një nga njerëzit dhe studiuesit e rrallë të kulturës dhe shkencës shqiptare. Për të janë bërë plot vlerësime dhe karakterizime, por mund të veçohen tri prej tyre.

I pari është vlerësimi i prof. **Shaban Demiraj**, gjuhëtar e albanolog i njohur, për shumë vjet shef i katedrës së gjuhësisë në universitetin e Tiranës. Duke e njohur studentin e tij, prof. Demiraj kërkoi me ngulm që Sh. Sinani të emërohej menjëherë pas përfundimit të studimeve si pedagog në këtë katedër. Por, ndërkohë Sh. Sinanin e kërkonte edhe gazeta me e madhe e asaj kohe, madje, kryeredaktori i saj, Arshin Xhezo, kishte firmosur edhe emërimin.

(Vijon në faqen 13)

Shaban Sinani, personalitet i veçantë në letrat shqipe

Nga **ALI ALIU**
Nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Rruga në ngjitje e një Akademiku

Nga prof. dr. **ALI XHIKU**
Nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Faqe **12-13**

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 131

Ashtu siç kemi premtuar më 18 mars 2013, peticioni ynë do të mbyllet kur të përfundojë metri i fundit i Rrugës së Arbërit, ndaj ju lutemi vazhdoni të nënshkruani: http://chn.ge/1NZeyGu

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (131). Mars 2017

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:
Samet ZAGRADI
Arsim KOLARI
Bashkim LLESHI
Gazmend KËRKUTI
Fatbardh CENA
Adi DARSI
Grehans UKA
Shuip MARKU
Enver HYSA
Jani THOMAI
Agim TOTRAKU
Zabit LLESHI
Demir OSMANI
Astrit GJUNKSHI
Ilir SPATA
Halil TEODORI
Halil RAMA
Dionis XHAFA
Mevlud BUCI
Dedë DOÇI
Ymer STOJKU

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

DEKLARATË PËR MEDIAT NË PËRVJETORIN E KATËRT TË PETICIONIT PËR RRUGËN E ARBRIT

Të injoruar, por **jo të dorëzuar**

GËZIM ALPION
Në emër të Grupit të Lobimit

Të indinjuar nga injorimi sistematik i Dibrës nga shteti shqiptar, dhe veçanërisht nga premtimet boshe dhe mashtrimet e qeverive që nga viti 2005, më 18 mars 2013, një grup intelektualësh dibranë në Tiranë dhe jashtë vendit iniciuan peticionin online për Rrugën e Arbërit. Për këtë vepër, dibranët po lobojnë pa reshtur që prej një çerek shekulli, me shprese se, në demokraci, edhe ata do të jenë të barabartë mes të barabartëve.

Peticioni filloi para zgjedhjeve si nismë qytetare. Siç premtuam, peticioni ka qëndruar jashtë çdo ndikimi partiak.

Në një vend si Shqipëria, ku shteti nuk funksionin normalisht dhe ku 'besnikëria prej skllavi' ndaj pronarëve të partive në Tiranë dhe sejmenëve të tyre, që operojnë me efektshmërinë e metastazave të kancerit në çdo pjesë të vendit, është shndërruar në 'parim', nuk u çuditëm kur të djathtët na akuzuan që në fillim se ishim 'vegla' të së majtës. Nga ana tjetër, të majtët, të etur për të kapur me çdo kusht shtetin, nga marsi deri në qershor 2013, e panë të arsyeshme të na 'përkrahin' me shpresë se ishim 'të tyret'.

Sapo erdhën në pushet, të majtët veshën petkun e arrogancës, dhe filluan të na sulmonin si individë dhe si grup, duke na bërë presion, shpifur dhe akuzuar se synonim t'u merrnim 'meritat' për 'suksesin' e tyre të 'garantuar'.

Kryeministri Edi Rama ka refuzuar kategorikisht të pranojë dorëzimin formal të peticionin që tani ka 11,000 nënshkrues online dhe formularë, dhe të 'ulë veten' për të filluar një dialog konstruktiv me Grupin e Lobimit. Megjithatë, Kryeministri Rama nuk ka lënë rast pa folur me superlativa për rolin pozitiv të shoqërisë civile, jo vetëm në disa vende në Perëndim, ku shoqëria civile vërtet vlerësohet, po edhe në Kinë.

Ndërsa sejmenët dibranë të Kryeministrit në qeveri dhe parlament, nuk ngurruan të tallen me dibranët përsëri, duke ua uruar rrugën kur nuk



ishte siguruar asnjë qindarkë për ndërtimin e saj.

Si Grup Lobimi, ne nuk arritëm të mbajmë premtimin për t'i dorëzuar qeverisë peticionin formalisht. Për këtë u kërkojmë ndjesë të gjithë përkrahësve. Megjithatë, qëllimi ynë nuk ka qenë dorëzimi formal i peticionit, por këmbëngulja jonë e vazhdueshme që qeveria shqiptare të mbajë premtimet e saj gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2013 të dhëna në Dibër, se 'ndërtimi i Rrugës së Arbërit është një prioritet'. Ndaj ne nuk kemi heshtur për mosmbajtjen e këtij premtimi dhe nuk do të heshtim edhe në të ardhmen. Pavarësisht nga rezultati i zgjedhjeve këtë qershor, ne nuk do të reshtim së lobuari për Rrugën e Arbërit dhe dinjitetin e nëpërkëmbur të Dibrës. Në këtë drejtim, peticioni ynë është simbol proteste në emër të Shqipërisë së 'harruar'.

Në këtë përvjetor të katërt, duam të ndajmë me intelektualët në Shqipëri dhe diasporë mësimin e hidhur nga përvoja jonë lobuese: Mos u mashtroni nga zhurma që bën kjo klasë politike se gjoja është e interesuar për dialog me intelektualët. Udhëheqësit të radhës nuk i duhen intelektualë atdhetarë e të pakorruptueshëm, por marioneta të arsimuara për t'u hedhur hi syve votuesve në prag zgjedhjesh.

Ashtu siç kemi premtuar më 18 mars 2013, peticioni ynë do të mbyllet kur të përfundojë metri i fundit i Rrugës së Arbërit, ndaj ju lutemi vazhdoni të nënshkruani: **http://chn.ge/1NZeyGu**

OPINION

Shkëlqim Canin e lamë vetëm

Muajt e fundit, një valë sulmesh ndaj Shkëlqim Canit janë publikuar në rrjetet sociale, duke e "kryqëzuar" atë si fajtorin kryesor për mosfillimin e punimeve në Rrugën e Arbrit dhe premtime të tjera që Partia Socialiste kishte dhënë katër vite më parë në Qarkun e Dibrës.

Shkëlqi Cani nuk është fajtori i vetëm për këtë. Ai është fajtor, po aq sa janë 2 deputetët e tjerë të majtë në parlament, si dhe 12 të tjerë deputetë të parlamentit nga Dibra apo me origjinë nga Dibra.

Po aq fajtorë sa Shkëlqim Cani janë drejtuesit lokalë në katër bashkitë e qarkut, të cilët bëjnë projekte e kërkojnë fonde për fusha e veprimtari të caktuara, rezultati i të cilave është zero pa Rrugën e Arbrit.

Po aq fajtorë janë anëtarët dhe militantët e partive në pushtet dhe opozitë, të cilët u kërkojnë lloj-lloj nderesh liderëve të tyre, rezultati i të cilave është të mbushin barkun me bukë e t'u mjaftojnë lekët deri më muajin e radhës...

Po aq fajtorë sa Shkëlqim Cani është secili prej nesh, i cili nuk e ka përdorur fuqinë e tij civile dhe shoqërore, që Shkëlqim Cani të mbante premtimet ndaj dibranëve.

Katër vite më parë, Edi Rama tha në Peshkopi se Shkëlqim Cani, si kusht për të qenë kandidat për deputet, i kishte kërkuar "tri gjëra për Dibrën: Rrugën e Arbrit, Rrugën e Arbrit dhe Rrugën e Arbrit". Dhe Rama ia kishte premtuar Rrugën e Arbrit, por i kishte kërkuar edhe dy gjëra të tjera, që lidheshin me Bujqësinë dhe Minierat...

Por, kur Cani u bë Ministër i Financave, ne e braktisëm.

E braktisën kolegët e tij në parlament, veçanërisht dibranët, por e braktisëm edhe ne, qytetarët, votuesit dhe anëtarë të shoqërisë civile.

E braktisëm, se nuk ia kujtuam përditë në statuse facebooku apo protesta në rrugë, se dorëzani te qeveria për ne ishte Shkëlqim Cani,

E braktisëm, sepse nuk e lejuam Shkëlqim Canin të komunikonte me elektoratin dibran, por e degdisëm të bënte propagandën e qeverisë rrugëve të Matit, Klosit e Bulqizës.

E braktisëm, sepse nuk u mblodhëm bashkë kur Edi Rama e pushoi brenda natës dhe nuk dha asnjë shpjegim - siç dha për Sajmir Tahirin para pak ditësh.

E braktisëm, sepse nuk i kujtuam Shkëlqim Canit se është deputet i yni e si i tillë duhet të flasë përditë për të kërkuar realizimin e premtimeve që na dha 4 vite më parë.

Shkëlqim Cani nuk është as nga ata deputetë që paguan badigardë pas, që kur ka mitingje shpërndahen në mes popullit dhe thërrasin "Rroftë deputeti", që pastaj Edi Rama t'i dëgjojë dhe të thotë se "paska mbështetje në popull".

Shkëlqim Cani nuk është as nga ata deputetë që thërret fisin, farefisin, soj e sorollop, u jep numrin e Edi Ramës dhe pastaj ata, në emër të popullit shkruajnë mesazhin "zgjidh Canin deputet" dhe punët e Dibrës i ke vendosur në vijë.

Shkëlqim Cani nuk është deputet që ka shitur vende pune në arsim, shëndetësi, bashki e kudo.

Shkëlqim Cani është një deputet, një qytetar i këtij vendi, si unë e ti që po lexon këto radhë, fuqia e të cilit nuk vlen e vetme, por të gjithë bashkë.

Ndaj, mos u ankoni për Shkëlqim Canin. Me siguri ai e ka bërë punën e tij, por ne nuk kemi bërë tonën: nuk kemi treguar fuqinë që kemi kur jemi bashkë.

Shkëlqim Canit këto muaj i ka mbetur veç një punë: të ndjekë sa të mundet procesin që po zhvillohet për dhënien me koncension të rrugës dhe në qoftë se kjo nuk finalizohet, të japë shpjegime pse nuk ndodh. Të na kërkojë edhe falje pse na e uroi ta gëzonim rrugën akoma pa filluar. Të na tregojë edhe se ku gaboi dhe ku gabuam...

Sepse ne besuam te ai për Rrugën e Arbrit, jo të Edi Rama. Ndaj, aq muaj sa i kanë mbetur, le ta ushtrojë detyrën e tij. Për të tjerat nuk ka nevojë në Dibër. Sepse kemi PDIU!

aktualitet

Uji derdhet, toka thahet

Tokat presin me padurim ujin e bekuar që do t'u njomte buzët e thara. Fermerët presin, në një pritje që nuk dihet sa zgjat. Pa ujin, të gjitha teknikat e teknologjitë shumëzohen me zero.



Në Foto: Liqenet e Kacnisë. (Foto e marrë nga Sektori i Bordit të Kullimit dhe Vaditjes, Peshkopi

Nga **OSMAN XHILI**

Sot, si kurrë ndonjëherë, bota është në kërkim të mënyrave dhe teknologjive të reja për të rritur rezultatet në çdo fushë të jetës. Nganjëherë, kaq e madhe është kjo dëshirë, saqë bëhet në kurriz të cilësisë, duke dëmtuar ndjeshëm vlerat organo – leptike të produktit, e për pasojë, duke dëmtuar dhe shëndetin e konsumatorit. Por, fatkeqësisht, njerëzit harrojnë, se para se të merren me shkencë për rritjen e prodhimeve bujqësore, duhet të mendojnë se si mund t'i vadisin kulturat e mbjella dhe të shtojnë sipërfaqen nën ujë.

Qarku i Dibrës ka një sipërfaqe totale të tokës arë prej 41 078 hektarë. Nga kjo, 23 128 hektarë sipërfaqe e mundshme për t'u vaditur apo më saktë që kanë qenë vaditur dikur, por në fakt vaditen 16 504 hektarë. Që te kjo panoramë e shkurtër lindin disa pyetje dhe përgjigjet janë të vështira për t'u kthyer, pasi janë një mori arsyesh e faktorësh, që në fund të fundit, kanë një gjë të përbashkët: neglizhencën njerëzore.

Për të marrë një informacion më të detajuar, ne shkuam në sektorin e bordit të kullimit dhe vaditjes në Peshkopi. Përgjegjësja Ornela Roçi, edhe pse e re në moshë, ka një përkushtim maksimal për punën. Eksperienca e gjatë e Petrit Laçit dhe Ramazan Doçit, dy bashkëpunëtorët e saj të ngushtë, e bën shumë efikase punën e këtij ekipi të vogël, në zyrë dhe në terren. Po cilat janë shifrat, realitetet, mundësitë dhe objektivat për të ardhmen?

Pas viteve nëntëdhjetë, kjo kohë sikur e ndan me thikë historinë, ca gjëra morën për mirë e ca të tjera për keq. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se gati të gjitha veprat e ujitjes e të kullimit, janë bërë në kohën e regjimit, dhe që atëherë, shumë pak. Bile, ca më keq akoma, një pjesë e tyre janë abandonuar e janë jashtë funksionit. Më konkretisht, situata është e tillë:

Janë 22 rezervuare që funksionojnë sot, me një kapacitet total 4,4 milion metër kub ujë. Specialistët e këtij sektori, këtë shifër e pjesëtojnë me tre, që do të thotë se për të vaditur një hektar tokë, gjatë gjithë periudhës së verës, do të duhen tre mijë metër kub ujë. Pra, këto liqene, vadisin mbi 12 mijë hektarë, kurse pjesa tjetër vaditet me kanale që e marrin ujin nga burime të caktuara uji. Thamë që disa rezervuarë nuk funksionojnë më, si ai i Çernenës në Maqellarë, për çështje pronësie, me një kapacitet mbajtës 45 mijë metër kub ujë. Për të njëjtën arsye nuk funksionon liqeni i Çetushit, i aftë për të vaditur 80 hektarë me 240 mijë metër kub. Liqeni i Vakufit me 120 mijë metër kub, nuk funksionon që nga viti 1991, pasi ka të prishur saraçineskën dhe ushqyesi i tij është i dëmtuar. Një tjetër liqen jashtë përdorimi është ai i Ndërshenës ne Reç, pasi ka probleme me digën dhe ujëlëshuesin. Në total, këto liqene jashtë funksionit kanë një kapacitet ujëmbledhës prej 465 mijë metër kub ujë, që do të thotë se 155 hektarë nuk do të vaditen, për aq kohë sa ne jemi të pa aftë për të zgjidhur këto gjëra të thjeshta.

Nuk kanë munguar përpjekjet, sidomos në këto pesë vitet e fundit, për të rivënë në funksion objektet e dëmtuara. Në vitin 2011 u punua në dy vepra ujore, rezervuari i Kandrit me 450 mijë metër kub, dhe ai i Shumbatit me 600 mijë metër kub, ku është riparuar shkarkuesi katastrofik, si dhe nivelimi i kurorës së digës. Dy vjet më parë, në vitin 2015, u punua në rezervuarin e Gramës, i ndërtuar në vitin 1962, dhe që ka një kapacitet 600 mijë metër kub, i mjaftë për 160 hektarë. U rregullua shkarkuesi katastrofik, puseta e hyrjes, e daljes, saraçineska, si dhe nivelimi i digës.

Janë 22 rezervuare që funksionojnë sot, me një kapacitet total 4,4 milion metër kub ujë. Këto liqene, vadisin mbi 12 mijë hektarë, kurse pjesa tjetër vaditet me kanale që e marrin ujin nga burime të caktuara uji.

Disa rezervuarë nuk funksionojnë më, si ai i Çernenës në Maqellarë dhe liqeni i Çetushit, për çështje pronësie; Liqeni i Vakufit ka të prishur saraçineskën dhe ushqyesi i tij është i dëmtuar, ai i Ndërshenës në Reç ka probleme me digën dhe ujëlëshuesin. Në total, këto liqene jashtë funksionit kanë një kapacitet ujëmbledhës prej 465 mijë metër kub ujë, që do të thotë se 155 hektarë nuk do të vaditen, për aq kohë sa ne jemi të pa aftë për të zgjidhur këto gjëra të thjeshta.

Në vitin 1983 u punua në liqenet e Kacnisë, në Selishtë, duke krijuar një rezervë ujore prej 1,2 milion metër kub ujë. Këto nëntë liqene të bukura, pesë të Shtrungëzës dhe katër të quajtur Bataqe, nuk do të ishin vetëm qendër e vizituar turistike, por do të shërbenin si ushqyes për rezervuarin e Bllacës, nëpërmjet një kanali prej 22 kilometër të gjatë. Por, fatkeqësisht, që nga viti 1996, gjërat nuk funksionuan më. Problemet e pronësisë e gërryen atë investim, si ndryshku metalin, e tani gjërat janë mbuluar me pluhurin e harresës. Duhet pak punë, pak përkushtim, pak investim, për t'i bërë gjërat si më parë, apo akoma më bukur. Për liqenet e Kacnisë duhen tre saraçineska të reja, riparimi i shkarkuesve katastrofikë, si dhe pastrimi i mbetjeve të akumuluara në vite. Gjithashtu, duhet një mirëmbajtës vjetor që të paguhet nga bashkia apo kushdo tjetër.

Për rezervuarin e Bllacës ka kohë që është hartuar një projekt rehabilitimi. Ai përfshin punimet për pastrim e riparim të rezervuarit, si dhe riparim kanali, nga dalja e liqenit, deri në destinacion, në Maqellarë. E rëndësishme këtu është pjesa nga sifoni deri te ura e Topojanit, e në vazhdim, me një gjatësi prej 7,3 kilometër. Vlera totale e projektit është rreth 2,4 miliardë lekë, ose të themi më pak se dy milion euro. Kapaciteti ujëmbajtës i rezervuarit është 2,4 milion metër kub, që do të shërbente për 800 deri në 1000 hektarë të fushës së Maqellarës. Do të doja t'i referohesha vetëm rastit të fundit e të bëja një llogari të thjeshtë. Të supozojmë se nga një dynym tokë arë e vaditur do të përfitohen 100 euro të ardhura në vit, kurse nga një hektar do të kishim 1000 euro. Sikur të vadisnim 1000 hektarët në Maqellarë, me ujin e liqenit të Bllacës, të ardhurat do të kapnin shumën e një milion eurove, gjë që do të thotë se investimi i bërë prej dy milion eurosh do të shlyhej brenda dy vjetësh.

Ne i referohemi liqenit të Bllacës, meqë ai ka ekzistuar më parë, por unë mendoj që nuk ka pse të shkohet deri atje. Malet që i rrinë Maqellarës si një kurorë e bukur mbi krye, janë në gjendje të gjenerojnë jo aq ujë sa duhet, por dhe më tepër. Në fshatrat e Kërçishtit, Obokut, Popinarës, apo kudo tjetër mund të gjesh ujë me shumicë, mjafton të kesh pak njohuri dhe pak dëshirë t'u shërbesh atyre njerëzve në nevojë.



Liqeni i Gramës

Gati e njëjtë është situata dhe me kanalet vaditëse, ku ka nevojë qoftë për ndërhyrje urgjente e po ashtu studime afatmesme, apo afatgjata. Kanali Llixha - Brezhdan, ndërtuar për 450 hektarë, aktualisht, vadit 350 hektarë, pasi ka nevojë për riparime në lagjen Kamen, në një gjatësi prej 800 metra.

Kanali Muhur – Brezhdan ka një gjatësi prej 17 kilometra dhe shërben për të vaditur 510 hektarë, por tani nuk përballon më shumë se 380 hektarë. Kërkohet investim nga vepra e marrjes, në pjesën e Gjaricës dhe në dy degëzimet, për në Brezhdan e Vakuf.

Kanali Çernievë – Shumbat, është i gjatë 22 kilometra dhe është planifikuar për 600 hektarë. Shërben për vaditjen e tokave të fshatrave Kallë, Vleshë, Sllovë, Lugje, Palaman, Trojak dhe Shumbat. Kryen funksionin dhe si ushqyes për rezervuarin e Shumbatit. Realizimi i projektit të tij, kap vlerën e 1,5 milion eurove.

Në vitin 2012 u investuan një milion euro, për kanalin Fushë Alie – Kandër, me një gjatësi prej 17 kilometër. Sot me të vaditen 550 hektarë.

Investime kërkohen dhe në kanalin Setë – Arras – Laçe, me një gjatësi 9,5 kilometër. Sot, me të vaditen vetëm 60 – 70 hektarë të fshatit Arras, kurse 200 hektarë të tjerë mbetën jashtë këtij shërbimi. Inxhinierët e ujërave mendojnë se 150 mijë euro do të ishin të mjafta, për të bërë të mundur vaditjen e tyre.

Rezervuarët dhe liqenet me ujërat që ato bartin, mund të kryejnë dhe një shërbim tjetër, jo pak të rëndësishëm. Nëse hedhim pak rasat peshku dhe nuk e ulim nivelin e ujit në fund të vaditjes deri në pikën e vdekjes, do të shtonim sasi të konsiderueshme peshku në tryezat tona, pothuajse pa asnjë lloj kostoje. Banorët e fshatit Bllacë, më tregonin se kishin kapur peshq me peshë mbi 20 kilogram, në kohën kur liqeni i tyre mbushej me ujë.

Janë këto probleme që akumulohen në vite. Ashtu siç i përmendëm më lart, disa e kanë prekur investimin dhe janë vënë në rrugën e zgjidhjes, të tjerat flenë në sirtarët e burokracisë shtetërore prej një çerek shekulli, si një i burgosur që nuk di kur i mbaron dënimi. Tokat presin me padurim ujin e bekuar që do t'u njomte buzët e thara. Fermerët presin, në një pritje që nuk dihet sa zgjat. Pa ujin, të gjitha teknikat e teknologjitë shumëzohen me zero. Kryeministri na bëri optimistë, kur tha se do të shtohen fondet për vaditjen e kullimin. Të shpresojmë që ka ardhur momenti i shumëkërkuar.

Rruga e Arbërit nr. 131

Kushdo që vonon hapjen e Rrugës së Arbrit dhe pengon kryerjen e investimeve në Dibër, pengon jo vetëm zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të kësaj treve, por edhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit malor në zonat që përshkon kjo rrugë, pengon integrimin në Europë të këtyre trojeve të vjetra europiane.

turizëm

Rruga e Arbrit i shërben *zhvillimit* *të mëtejshëm të* **turizmit malor**

Rruga e Arbrit i shërben jo vetëm zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit tonë dhe të trevave që do të përshkojë, por si një nga rrugët më të bukura turistike, si rruga më e shkurtër që pret Shqipërinë nga perëndimi në lindje do t'i shërbejë edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor në Shqipëri.

Nga **BASHKIM LLESHI**

Rruga e Arbrit i shërben jo vetëm zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit tonë dhe të trevave që do të përshkojë por si një nga rrugët më të bukura turistike, si rruga më e shkurtër që pret Shqipërinë nga perëndimi ne lindje do ti shërbejë edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor në Shqipëri.

Ajo pasi kalon qytetin e Tiranës në drejtim të Tufinës, sipas rrugës së vjetër të Dibrës që e ka fillimin në qendër të Tiranës, vazhdon më tej për gjatë luginës së lumit të Tiranës duke prerë vargmalin e Dajtit, gjatë luginës shumë të bukur e piktoreske që kalon nga Brari në Zall Dajt. Pjesa e rrugës që pret gëlqerorët e vargmalit të Dajtit do të jetë një nga rrugët më të bukura turistike të vendit tonë, fare pranë kryeqytetit të vendit tonë, Tiranës. Kjo pjesë e rrugës që zgjat rreth 5km kalon nëpër luginën e ngushtë të lumit të Tiranës që ka krijuar kanione të ngushta e të thella në shkëmbinjtë gëlqerorë të vargmalit të Dajtit me një bukuri të rrallë natyrore.

Rruga kalon pranë shtratit të lumit dhe kanioneve të bukura të kësaj zone në lartësitë nga 200m tek Ura e Brarit, në 335m në dalje të shkëmbinjve gëlqerorë tek gurorja e Zall Dajtit, ku në të dy krahët ngjiten shpatet e pjerrëta të luginës që kanë lartësi nga 1214m në majën e Brarit në pjesën veriore në 1531m në majën e Tujanit në pjesën jugore.

Në shpatin e majës së Tujanit ka kaluar rruga e vjetër e Dibrës, në të quajturën shkalla e Tujanit (Tiranës) e cila kalohej edhe me kafshë me vështirësi shumë të mëdha. Në dalje të shkëmbinjve gëlqerorë mbi kanionin e ngushtë të bukur e të thellë të Zall Dajtit, në shtratin e lumit të Tiranës, në të majtë të rrjedhjes së tij, përball gurores së Zall Dajtit kemi burimin e ftohtë të Zall Dajtit që e zbukuron akoma më tepër këtë luginë piktoreske.

Pasi kapërcen vargmalin e Dajtit nëpërmjet kësaj lugine të ngushtë e piktoreske rruga del në luginën e gjelbër të Zall Dajt – Shupalit, duke ndjekur krahun e majtë të rrjedhjes se lumit të Tiranës, i quajtur në këtë zonë lumi i Shupalit, deri tek vendi ku bashkohet lumi i Selitës me përroin e Zall Bastarit. Lugina në këtë zonë zgjerohet, ka ujë të bollshëm dhe është një luginë e freskët dhe e gjelbëruar.

Nëpërmjet një ure poshtë bashkimit të këtyre dy degëzimeve, rruga do të vazhdojë të ngjitet për gjatë përroit të Zall Bastarit në afërsi të lagjes Kurte (Shupal), pranë lagjes Marec, për gjatë përroit të Marecit në drejtim të lagjes Zdralla dhe më tej në lagjen Bastar (Kaçu) në përroin e Kaçujt, ku në lartësine 850m është parashikuar të jetë hyrja e tunelit të Murrizës.



Qafa e Tujanit. Rruga e Arbrit kapërcen malin e Dajtit në afërsi të Zall Dajtit. Në krahun e djathtë sipër në horizont, Rruga e vjetër e karvaneve Tiranë - Dibër. Foto © Bashkim Lleshi, nëntor 2012

Nëpërmjet kësaj rruge do të përshkohen vargmalet e Dajtit dhe Malit me Gropa për një orë nga Tirana, duke çuar në një zhvillim të shpejtë të turizmit malor në këtë zonë me bukuri të rralla turistike, duke shijuar në verë bukuritë e rralla të Malit me Gropa, Bizës, Ballejës e Kaptinës së Martaneshit, apo freskinë e burimeve të Murrizës, Gurit të Bardhë, Linosit, Bizës, Ballejës, Lenës, Kaptinës dhe liqeneve të bukur malorë të kësaj zone si liqeni i Sopeve, liqeni Zi, liqeni i Bardhë, etj. Në këto zona turistike shumë afër Tiranës do të krijohet mundësia për të shkuar edhe gjatë dimrit duke zhvilluar edhe sportin e bukur të skive në Bizë, Ballejë e Kaptinë.



Pamje e luginës së lumit Mat tek Ura e Vashës. Mbi Urën e vjetër të Vashës ku lugina e lumit është më e ngushtë duhet të ndërtohet Ura e Re e Rrugës së Arbëri. Foto © B.Lleshi 2014.

Kjo është e vetmja ngjitje e kësaj rruge e cila në këtë zonë do të kapërcejë vargmalin e Murrizës nëpërmjet një tuneli të gjatë rreth ose mbi 3000m për të dalë nga shpati perëndimor i malit të Murrizës në shpatin lindor, në afërsi të Shkollës së vjetër fillore të Xibër Murrizës, në rrjedhjen e sipërme të zallit të Mashnorit. Tuneli i Murrizës do t'ia shtojë bukurinë kësaj rruge, duke kaluar poshtë majës së Skërtecit me lartësi 1455m në veri të Qaf Murrizës ku kalonte rruga e vjetër e Dibrës. Nëpërmjet këtij tuneli do të kalohet nga lugina e Tiranës në luginën e Matit.

Sapo të dalë në luginën e bukur të Matit në horizont të del përpara Kalaja e vjetër e Petralbës, përball së cilës vendoset fshati turistik i Gurit të Bardhë. Nga Guri i Bardhë, nëpërmjet përmirësimit të rrugës ekzistuese, për 2 - 3km shkohet në burimin e bukur karstik të Linosit dhe futesh në parkun e madh turistik të Malit me Gropa, një nga bukuritë e rralla turistike të vendit tonë, që pas ndërtimit të kësaj rruge do të jetë larg Tiranës më pak se një orë, ose do të shkohet në fushën e bukur, mes malesh të Bizës së Martaneshit, për një orë, ose në Ballejën turistike dhe malin e Kaptinës e në Liqenin e Zi të Tërnovës për një orë e gjysmë.

Pra nëpërmjet kësaj rruge do të përshkohen vargmalet e Dajtit dhe Malit me Gropa për një orë nga Tirana, duke çuar në një zhvillim të shpejtë të turizmit malor në këtë zonë me bukuri të rralla turistike, duke shijuar në verë bukuritë e rralla të Malit me Gropa, Bizës, Ballejës e Kaptinës së Martaneshit, apo freskinë e burimeve të Murrizës, Gurit të Bardhë, Linosit, Bizës, Ballejës, Lenës, Kaptinës dhe liqeneve të bukur malorë të kësaj zone si liqeni i Sopeve, liqeni Zi, liqeni i Bardhë, etj. Në këto zona turistike shumë afër Tiranës do të krijohet mundësia për të shkuar edhe gjatë dimrit duke zhvilluar edhe sportin e bukur të skive në Bizë, Ballejë e Kaptinë.

Pasi kalon nëpërmjet një tuneli të shkurtër poshtë Gurit të Bardhë, në vazhdim rruga kalon tek aksi i vjetër i rrugës së Dibrës, ku kemi dy urat e vjetra me gurë e dopio qemer, atë të Skurës, mbi përroin Zalli i Dishit dhe Urën e Vashës, mbi lumin e Matit. Mbi urën e vjetër të Vashës është parashikuar të ndërtohet një urë e lartë rreth 120 m që do të kapërcejë luginën e ngushtë e mjaft piktoreske të lumit të Matit nga krahu i Gurit të Bardhë në krahun e Planit të Bardhë.

Pasi përshkon luginën e Planit të Bardhë e kapërcen me tunel Qafën e Buallit del në luginën e Vajkalit duke kaluar mes për mes qytetit të Bulqizës, të Minierës më të madhe të kromit në vendin tonë, minierës me karakter unikal botëror, nga e cila në vitet 1948 - 2015 janë prodhuar afro 15 milionë ton krom duke mbajtur pas naftës, peshën kryesore të ekonomisë kombëtare të vendit tonë në periudhën e monizmit. Me përfundimin e rrugës qyteti i Bulqizës dhe Miniera me të njëjtin emër do të jenë vetëm 50 km. larg Tiranës.

Rruga e re do të përshkojë luginën e bukur të Vajkalit dhe Fushë Bulqizës me ujëra të freskëta të lumit të Bulqizës e Zerqanit duke kaluar pranë burimeve karstike të Peladhisë, në krah të fshatit të bukur e piktoresk të Zerqanit, tek burimet e tre Çezmave në afërsi të Sofraçanit dhe aty ku bashkohen Zalli i Bulqizës me atë të Okshtunit në afërsi të Urës së Çerenecit nëpërmjet një ure do të kalojë rrëzë kodrave të Gjoricës ku të del përpara fusha e bukur e Gjoricës, Shupenzës, Maqellarës e Dibrës së Madhe. Për rreth 70 km rrugë nga Tirana futesh në luginën e bukur e piktoreske e panoramike të Dibrës ku fillon gjarpërimet e veta lumi Drinit i Zi.

Pasi kalon kodrat e Gjoricës, aty ku lugina e Drinit te Zi është më e ngushtë, është menduar të ndërtohet një urë për të kaluar Drinin dhe rruga do të vazhdojë në territorin e Maqedonisë, nga kodrat e Kojnarës për të shkuar në qytetin e Dibrës së Madhe, në veri të Urës së vjetër të Spiles e cila sot është e mbuluar nga diga e liqenit të Hidrocentralit të Dibrës. Kur del në kodrat e Kojnarës të del përpara qyteti i bukur i Dibrës së Madhe në veri lindje dhe liqeni i bukur pranë qytetit të Dibrës së Madhe në jug, që formojnë një kompleks shumë të bukur turistik në këtë zonë.

Duke vazhduar rrugën bregut të liqenit

rruga

Gazeta "Rruga e Arbërit" në 10 vitet e botimit, nëpërmjet shkrimeve të bashkëpunëtorëve të saj ka propaganduar vlerat e mëdha turistike që ka rajoni i Dibrës nga Bulqiza e Zerqani, në Dibër të Madhe, Maqellarë e Peshkopi, Grykë të Vogël e Katër Grykët, në Luzni e Muhurr, Kastriot, Çidhën, Sllovë e Radomirë, Reç e Dardhë dhe deri në Lurën e bukur malore me liqejt e saj mahnitës.

Rruga e re do të përshkojë luginën e bukur të Vajkalit dhe Fushë Bulqizës me ujëra të freskëta të lumit të Bulqizës e Zerqanit duke kaluar pranë burimeve karstike të Peladhisë, në krah të fshatit të bukur e piktoresk të Zerqanit, tek burimet e tre Çezmave në afërsi të Sofraçanit dhe aty ku bashkohen Zalli i Bulqizës me atë të Okshtunit në afërsi të Urës së Çerenecit nëpërmjet një ure do të kalojë rrëzë kodrave të Gjoricës, ku të del përpara fusha e bukur e Gjoricës, Shupenzës, Maqellarës e Dibrës së Madhe. Për rreth 70 km rrugë nga Tirana futesh në luginën e bukur, piktoreske e panoramike të Dibrës, ku fillon gjarpërimet e veta lumi Drini i Zi.



Pamje e liqejve të Allamanit. Foto © Bashkim Lleshi 2002.

të Dibrës për gjatë luginës së Drinit të Zi shkohet brenda një ore në qytetin e Strugës për të shijuar freskinë dhe bukurinë e liqenit të Ohrit në komplekset turistike të qyteteve të Strugës dhe Ohrit deri në perlën e këtij liqeni, Shën Naumin e famshëm historik e turistik. Pra nga rruga e re e bukur, turistike dhe historike e Dibrës mund të dilet në liqenin Ohrit nga Tirana për dy orë.

Kështu, qyteti i Dibrës se Madhe do të jetë larg Tiranës, Kryeqendrës së Shqipërisë vetëm 75km larg ose e thënë ndryshe vetëm një orë larg. Dibranët që banojnë në Tiranë brenda një ore mund të shkojnë në qytetin e tyre të lindjes, të takojnë të afërmit, të çmallen e të pinë një kafe, të shkojnë e të bëjnë banjë në llixhat kuruese të Banishtit e Kosovrastit, pranë qytetit të Dibrës, e të kthehen përsëri në Tiranë, ndërsa Dibranët që banojnë në Dibër e në fshatrat e luginës së Dibrës, jo vetëm që mund të vijnë e të kryejnë hallet e tyre brenda ditës e të kthehen në darkë në shtëpi, por mund të banojnë në Dibër, e të punojnë në Tiranë apo në Durrës, duke realizuar ëndrrën e kahershme të Dibraneve për tu afruar me Tiranën dhe Durrësin.

Rruga e re e Dibrës do të afrojë edhe llixhat kuruese të Peshkopisë me Tiranën e Durrësin, duke shtuar frekuentimin e qytetarëve vendas e të huaj në këto zona të bukura kuruese e turistike. Kjo rrugë do të afrojë gjithë pellgun e Dibrës nga Reçi, Dardha e Muhurri, nga Kalaja e Dodës, Sllova e Kastrioti e zona të tjera të pellgut të Drinit të Zi, duke krijuar mundësitë për të ardhur në Tirane për rreth 2 orë.

Rruga do të vazhdojë më tej për gjatë grykës së bukur turistike të lumit të Radikës, degë kryesore e lumit të Drinit të Zi. Kjo luginë e ngushtë dhe e bukur anash së cilës ngrihen shpatet jugore të vargmalit të Kërçinit, vazhdon deri në afërsi të qafës së Mavrovës, ku të del përpara zona e bukur turistike e Mavrovës me liqenin, lëndinat, pyjet dhe Kompleksin turistik të pushimeve verore për klimë të freskët malore dhe dimërore për zhvillimin e bukur të sportit të skive.

Pasi kalon zonën e bukur të Mavrovës rruga zbret për tu bashkuar me rrugën e Gostivarit që vjen nga Struga e Kërçova, dhe te del përpara fusha e bukur e pjellore e Pollogut dhe vazhdon në drejtim te Gostivarit, Tetovës e Shkupit nëpër autobandën e re të ndërtuar në Maqedoni. Kështu Rruga Tiranë Shkup do të shkurtohet rreth 100 km.

Për propagandimin e vlerave turistike të zonave që përshkon kjo rrugë në territorin e Dibrës, Studioja Grafike "M&B" në Tiranë, në vitin 2003 botoi Kalendarin "2003 - Viti i Rrugës së Arbrit" me ide të Hysen Ukës e Bujar Karoshit dhe në vitet në vazhdim ka botuar Kalendarë me pamje të bukura turistike të territorit të Dibrës që do të marrin zhvillim me ndërtimin e kësaj rruge.

Gazeta "Rruga e Arbërit" në 10 vitet e botimit, nëpërmjet shkrimeve të bashkëpunëtorëve të saj ka propaganduar vlerat e mëdha turistike që ka rajoni i Dibrës nga Bulqiza e Zerqani, në Dibër të Madhe, Maqellarë e Peshkopi, Grykë të Vogël e Katër Grykët, në Luzni e Muhurr, Kastriot, Çidhën, Sllovë e Radomirë, Reç e Dardhë dhe deri në Lurën e bukur malore me liqejt e saj mahnitës.

Që në vitin e parë të botimit, në tetor të vitit 2006 në gazetën "Rruga e Arbërit" u botua artikulli "Rruga e Arbrit i shërben edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit" *(B.Lleshi, tetor 2006)*. Në Kuvendin Shkencor për Rrugën e Arbrit të organizuar nga shoqata LID në maj të vitit 2007 krahas referimeve për mundësitë e reja që do të krijohen për vënien në përdorim të pasurive minerale të këtij qarku *(Vesel Hoxha, Bashkim Lleshi, Ilir Alliu, Sefedin Shabani, Naim Karaj për Peshkopinë e Bulqizën dhe Agim Shenjatari për Matin, maj 2007)*, një referat i veçantë u mbajt vetëm për zhvillimin e turizmit në rajonin ku do të kalojë kjo rrugë. *(Bashkim Lleshi, Avni Dibra, maj 2007)*

Bashkëpunëtorë të tjerë të gazetës "Rruga e Arbërit si: Gazmend Kërkuti, Shuip Markja e Tafë Ameti, Abdurahim Ashiku, Shaqir Skara, Hysen Likdisha, Hysen Uka, Agron Totraku, Selman Mziu, Vesel Hoxha, Rruzhdi Bitri, Metush Skeja, Grehans Uka, etj, etj. në shkrimet e intervistat e tyre kanë folur edhe për bukuritë e natyrës së Dibrës, për liqejtë e bukur e mahnitës malorë të Lurës, Balgjajt, Bulqizës e Gramës, për burimet e freskëta të Bulqizës, Okshtunit, Zerqanit, Tuçepit, Kovashicës, Delgjurrës, Selishtës, Luznisë e Muhurrit, Ilnicës, Rabdishtit, Cerjanit, Gramës e Radomirës, për gjurrat e Mazhicës, Lishanit e Muhurrit, për burimet e Reçit e Dardhës, Sllovës, Gramës e Radomirës, për Veleshicën, Setën e Mollën e Lurës, etj.



Pamje e liqenit të Dibrës dhe Grykës së Radikës. Foto © Gazmend Kërkuti.

Me përfundimin e Rrugës së Arbrit, nga Tirana do të shkohet në luginën e bukur të Dibrës për një orë. Por për të shkuar tek liqejt e Kacnisë e të Balgjajt, në Delgjurrë apo Komavec, në Liqenin e Zi të Tërnovës, apo në Kaptinë, te liqejt e Lurës apo në Mollë të Lurës, në Bjeshkën e Zonjave apo në Korab ka mangësi të mëdha në infrastrukturën brenda rrethit, ku për 25 vite rresht, përveç rrugës për në Kala të Dodës, në rrugët e zonave të tjera nuk është bërë pothuajse asnjë investim dhe janë në gjendje të mjerueshme. Kështu, njësive vendore të Peshkopisë e Bulqizës u del detyra që në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit e të Transporteve, nëpërmjet deputetëve që do të zgjidhen në parlamentin e këtij viti, ta kthejnë fytyrën edhe nga Dibra sepse ka 25 vite që marrin vota nga dibranët, por investimet për zhvillimin e Dibrës kanë munguar.

Në korrik të vitit 2016 gazeta "Rruga e Arbërit" i kushtoi një botim special bukurive natyrore të trevës së Dibrës për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit malor në këtë krahinë me bukuri të rralla natyrore por të harruar nga pushteti.

Agim Totraku përshkruan bukuritë e rralla të liqejve të mrekullueshëm me origjinë akullnajore të Balgjajt, mes ajrit të freskët, florës së mrekullueshme dhe faunës së egër. Përshkruhen bukuritë e 5 liqeneve të Shtrugës të vendosur si me dorë sipër njeri tjetrit si, liqeni i Pishës së Lice, Liqeni i zi, 3 liqenet Barzane, liqeni n'Kep, liqeni i Kolemadhit dhe liqeni i vogël i Loshe. Në drejtimin jug lindor kemi liqenin e Rame, liqenet e Bataçeve të Kacnisë (të Kalisë, Milloshit, Bruçe, etj.). Sapo të dalësh në kurriz në krahun perëndimor të tyre qëndrojnë madhështorë e të bukur liqejt e Allamanit, numri i të cilëve së bashku me ato të Kacnisë arrin në 15.

Për rreth tyre kemi një florë shumë të pasur si, bredhi i bardhë, pisha e zezë, plepi i egër, armeni, qershia e egër (boronica), lulja e pishës, lulja e zonjës, lule delja, mjedra, lule shtrydhja e egër, lulja agulice, manushaqja blu dhe e verdhë, shtara, drunakuqi, etj. ndërsa nga fauna mund të përmenden, dhia e egër, kaprolli, derri i egër, lepuri, kaprolli, ariu i murmë, ujku, gjeli i egër, dhelpra, shqarthi, macja e egër, rriqebulli, etj. *("A. Totraku, Rruga e Arbërit", Nr 123, korrik 2016)*.

Shuip Marku përshkruan, bukuritë e masivit malor të Deshatit, pjesë e vargmalit Sharr - Korab - Deshat - Stogovë - Karaorman, me majën më të lartë Velivarin (2373m.), liqenin e Lokuvit, njerin prej 5 liqeneve akullnajorë të Deshatit, luginën e bukur të lumit Radika me ujë të kthjellët, të pastër e të ftohtë me nuancë të ngjyrës së gjelbërt të errët, ujvarën e Dufit në rrëzë të malit të Radostushës, shpellën e Sharkut në parkun nacional të Mavrovës, shpellën e kristaltë të Selenitit brenda gjipseve të Kosovrastit, shtegun malor Banjisht - Kosovrast, fshatrat turistikë të Gajres, Galiçnikut e Kiçinicës, hamamet e ri e të vjetër të Dibrës, objektet historike të qytetit të Dibrës e rrethinave si, shtëpia e vjetër e Suri Veliut, objektet religjioze si xhamia e Inqarit, Xhamia Bajram Beg, Kisha e Shën Mërisë, Manastiri Bigorski, Kisha Shën Jovan Preteça, Manastiri Shën Gjergji fitimtari, Ura e Kaprollit dhe shumë vende historike në Banjisht, Dibër e Kosovrast. *(Sh. Marku, "Rruga e Arbërit", Nr 123, korrik 2016)*.

Djaloshi 24 vjeçar Grehans Uka i certifikuar nga GTZ dhe Shoqata Alpine Gjermane në një intervistë tregon disa nga destinacionet e turizmit malor në zonën e Peshkopisë që mund të vizitohen nga turistë vendas e të huaj si, kompleksi i llixhave në Peshkopi, duke vijuar në fshatrat Bellovë, Rabdisht, Cerjan e Zagrad; itineraret Peshkopi - Bjeshka e Cerjanit - Mali i Gramës - Liqeni i Gramës; Peshkopi - Radomirë - Liqeni i Gramës - Maja e Korabit; organizimin e raftingjeve në lumin e Drinit të zi, etj. *(G.Uka, "Rruga e Arbërit", Nr 123, korrik 2016)*

Rruzhdi Bitri në reportazhin "Prapë na çeli Grama" përshkruan bukuritë e bjeshkës së Gramës të cilën e kanë vizituar mjaft biologë, mjekë, gjeologë e udhëtarë të tjerë të mençur, Gramën e bukur ku kanë jetuar zonjat ilire, romake e kastriotët, Gramën e ndaluar nga regjimi monist se ishte zonë kufitare. Ai përshkruan bukuritë e bjeshkës së Gramës, stanet e Blliçasve, legjendën e Gramës baxhierin Elez Cibaku, Bjeshkën e Zonjave si kryezonjë të kësaj bjeshke, gjeomonumentet e Gramës si Guri i kuq, Pasqyrat, Shllinasit, Lakja e Xhipçe, etj. të shkelura e studjuara nga gjeologu i pasionuar dibran profesor Vesel Hoxha. *(R.Bitri, "Rruga e Arbërit", Nr 123, korrik 2016)*.

(vijon në faqen 6)

Rruga e Arbrit i shërben zhvillimit të mëtejshëm të **turizmit malor**



Pamje e liqejve të Shtrungës. Foto © Agim Totraku 2016.

(vijon nga faqja 5)

Destinacione të tilla të turizmit malor që mund të vizitohen nga turistë vendas e të huaj mund të organizohen edhe në zona të tjera të Dibrës si:

Në zonën e Bulqizës (Bulqizë - Almarinë - Liqeni i Skënderit - Maja e Dhoksit; Bulqizë - Kodra e Lerës - Fushë Hutër - Liqenjt e Balgjajt; Bulqizë - Qaf Buall - Luçanë - Batër - Lugu i Gjatë - Fusha e Lopës - Liqeni i zi i Tërnovës ; Fush Bulqizë - Dushaj - Stanet e Peladhisë - Komavec - Delgjurrë - Prat etj.

Në zonën e Zerqanit e Valikardhës për në Tërnovë - Liqeni i Zi - Kaptinë ; Zerqan - Tërnovë - Okshtun - Prodan, Tre çezmat e Zerqanit (hidromonument) - Sofraçan - Gropat e Ukut - Kovashicë - Zogje - Xhiteca e Sute - Qaf Mollë - Xhiteca e Kazane Gjuras, Shpella e ftohtë (gjeomonument), etj.

Në zonën e Gollobordës në drejtimin Shupenzë - Ramnagore - Ostren - Klenjë - Steblevë - Fushë Studën, ose në drejtimin Tuçep - Trebisht - Steblevës, etj.

Në zonën e Grykës së Vogël, Ura e Serbinit - Gjurra e Kovashicës e Kovashicës - Zogjaj - Guri i Çetës - Teqja e Bllacës - Livadhi i Marke - Shullani i ri - Delgjurrë - Komavec ; Ura e Topojanit - Topojan - Mazhicë - Qafa e Shtushanit - Qaf Mollë - Xhiteca e Gjurasit - Qafa e Fangut - Delgjurrë - Prat, etj.

Në zonën e Luznisë e Muhurrit për të dalë në Selishtë, Kacni, Qaf Murrë e Lukan , deri tek liqejt e Kacnisë e të Balgjajt në drejtim të Kacnisë dhe deri në Mbas Dejë e Gurin e Vashës në drejtim të Lukanit.

Në zonën e Arrasit, Zall Dardhës e Zall Reçit për t'u ngjitur në drejtim të Gur Lurës e liqejve të Lurës nga lugina e bukur e madhështore e Setës e përshkruar aq bukur nga gjeologu dibran Vesel Hoxha, apo në drejtimin Çidhën - Prat - Lan Lurë - Fushë Lurë; Zall Dardhë - Lashkizë - Lan Lurë - Fush Lurë; Zall Reç - Reç - Ndërshenë - Lanë Lurë - Fushë Lurë; Zall Reç - Reç - Arrë Mollë - Pregj Lurë - Krej Lurë nëpërmjet luginës së bukur të lumit Molla e Lurës.

Në zonën e Lurës, Fushë Lurë - Liqeni i Madh - Liqeni i luleve - Liqeni i zi - Fusha e Pelave; Krej Lurë - Qafa e Kumbullës - Blaç - Nezhda e Lurës; Krej Lurë - Vlashaj - Lajthizë - Fusha e Vjerthit - Fushat e Lugje e kthim në Krejë ose në Konaj - Reps (në rrugën e Kombit) ose Lajthizë - Nome - Arrën i Kukësit.

Tafë Ameti, anëtar i kryesisë së Shoqatës për kulturë "Reka e Epërme", në një intervistë tregon për bukuritë e Rekës së Epërme dhe për takimin e organizuar nga 31 korrik deri më 5 gusht për prezantimin e veshjeve tradicionale të Rekës, të traditave e zakoneve, të lojrave popullore, folklorit dhe ushqimeve tradicionale të kësaj ane, para vendasve dhe mysafirëve të ardhur për të ndjekur këtë aktivitet. *(T.Ameti, "Rruga e Arbërit", nr. 123, korrik 2016).*

Metush Skeja në reportazhin "Pesë kuriozitete rreth Kalasë së Dodës" shkruan se: "Në Kala të Dodës ndodhet mali më i lartë në Shqipëri, Korabi i cili i tëri është për turizëm duke filluar nga pylli me mështekna në Ploshtan, Rafshi i Sorokolit, Liqeni i Zi mbi Tejës, Fusha e Korabit, Panairi, ujëvarat, liqenet karstike, shpella e Ago Ymerit e Kepi i Stogit.

Në Kalanë e Dodës është tabani i këngës së bukur të fushës së Korabit me tre mijë vargje. Në kohën e perandorisë Osmane Kalaja e Dodës ka qenë zona më e pasur me një milion krerë bagëti të imta. Ajo është vizituar nga konsulli austriak Han në vitin 1863. Kalaja e Dodës ka nxjerrë një nga personalitetet më të mëdha të Rilindjes kombëtare, Dervish Carën e Cerenit. Ajo në kohën e perandorisë osmane ka qenë "kaza" dhe quhej Kazaja e Radomirës. *(M. Skeja, "Rruga e Arbërit", nr. 123, korrik 2016).*

Përveç këtyre bukurive, Dibra duke filluar nga Qafa e Buallit në kufi me Matin deri në Kala të Dodës në kufi me Kukësin është pëllëmbë e histori, në çdo vend do të ndeshësh një ngjarje të hershme ose të vonshme historike, kështu që krahas zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor, njohjes me bukuritë e natyrës së Dibrës, njohjes me gjeomonumentet, hidromonumentet e biomonumentet *(Perikli Qirjazi, Skendër Sala 2006),* vizitorët vendas e të huaj do të njihen edhe me historinë e lavdishme të Dibrës në shekuj.

Me përfundimin e Rrugës së Arbrit, nga Tirana do të shkohet në luginën e bukur të Dibrës për një orë. Por për të shkuar tek liqejt e Kacnisë e të Balgjajt, në Delgjurrë apo Komavec, në Liqenin e Zi të Tërnovës, apo në Kaptinë, te liqejt e Lurës apo në Mollë të Lurës, në Bjeshkën e Zonjave apo në Korab ka mangësi të mëdha në infrastrukturën brenda rrethit ku për 25 vite rresht, përveç rrugës për në Kala të Dodës, në rrugët e zonave të tjera nuk është bërë pothuajse asnjë investim dhe janë në gjendje të mjerueshme. Kështu njësive vendore të Peshkopisë e Bulqizës u del detyra që në bashkëpunim me ministrinë e Turizmit e të Transporteve, nëpërmjet deputetëve që do të zgjidhen në parlamentin e këtij viti që t'a kthejnë fytyrën edhe nga Dibra sepse ka 25 vite që marrin vota nga dibranët, por investimet për zhvillimin e Dibrës kanë munguar.

Kushdo që vonon hapjen e kësaj rruge, dhe pengon kryerjen e investimeve në Dibër, pengon jo vetëm zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të kësaj treve, por edhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit malor në zonat që përshkon kjo rrugë, pengon integrimin në Europë të këtyre trojeve të vjetra Europiane.

Referimet

Agim Shenjatari - "Pasuritë minerale të rrethit të Matit që vihen në lëvizje për ekonominë e tregut me ndërtimin e Rrugës së Arbrit" Kuvendi tekniko - shkencor për Rrugën e Arbrit" maj 2007

Agim Totraku - "Liqenet e Balgjajt , bukuria e heshtur", gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016).

Bashkim Lleshi - "Rruga e Arbrit i shërben edhe zhvillimit më të shpejtë të turizmit malor dhe njohjes së mëtejshme të historisë" Rruga e Arbërit nr.6 tetor 2006

Bashkim Lleshi, Avni Dibra - "Rruga e Arbrit premisë për zhvillimin e turizmit" Kuvendi tekniko - shkencor për Rrugën e Arbërit" maj 2007

Hysen Uka, Bujar Karoshi, - Kalendari i vitit 2004 ,Tiranë 2004

Grehans Uka, Bujar Karosh i - "Guida malore, ja vendet që mund t'i vizitoni" gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016

Metush Skeja - "Pesë kurizitete rret Kalasë së Dodës" gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016)

Perikli Qirjazi, Skendër –"Monumentet e natyrës së Shqipërisë" Tiranë 2006

Rruzhdi Bitri - "Prapë na çeli Grama" gazeta Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016)

Shuip Marku - "Uji dhe mali aty ku shërohet trupi dhe shpirti" Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016).

Tafë Ameti, Bujar Karosh i - "Ringjallja e Rekës së Epërme" Rruga e Arbërit nr.7 (123) korrik 2016

Vesel Hoxha etj. - "Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbrit", Kuvendi tekniko - shkencor për Rrugën e Arbërit" maj 2007



Trego bukuritë e vendlindjes tënde

Më 8 dhe 9 prill zhvillohet në Tiranë, në sheshin e Pazarit të Ri, Ditët e Turizmit Dibran, ku marrin pjesë katër bashkitë e Qarkut të Dibrës. Agjensia e Zhvillimit të Rajoneve fton qytetarët të vizitojnë stendat e panairit si dhe hap konkursin e fotografisë dhe videos, me qëllim prezantimin e burimeve turistike të rajonit.

"Trego bukuritë e vendlindjes tënde" është konkursi i fotografisë dhe i videove, me qëllim prezantimin e burimeve turistike të Dibrës. Ky konkurs është i hapur për publikun dhe aplikantët mund ti ngarkojnë fotografitë e tyre në linkun www.vendlindja.al.

Në kuadër të Panairit Ndërkombëtar të Turizmit, më 7 - 9 prill 2017 do të zhvillohen në Tiranë, në sheshin pranë Pazarit të Ri, Ditët e Turizmit Dibran. Në funksion të këtij panairi është menduar edhe organizimi për të rinjtë e Qarkut Dibër, i konkursit kreativ "Trego Bukuritë e Vendlindjes Tënde". Konkursi është i hapur deri më datë 5 prill 2017, ndërsa me datën 8 prill në qytetin e Tiranës do të shpallen fituesit e këtij konkursi. Për çdo Bashki të Qarkut Dibër do të shpallet një fitues, i cili do të nderohet me çmim nga bashkia përkatëse, ndërsa në nivel Qarku do të shpallet një fitues që do të nderohet me çmim nga Agjensia Rajonale e Zhvillimit 2.

"Qëllimi i kësaj nisme, sipas organizatorëve, është që vetë të rinjtë e Qarkut të Dibrës të promovojnë bukuritë e vendlindjes së tyre. Me këtë konkurs kreativ duam të ndërtojmë të ardhmen e përbashkët në vendlindje, por edhe për të treguar se sa i shumëllojshëm është vendi ynë. Aty çdo njeri mund ta gjejë veten si në shtëpinë e tij, pavarësisht se prej nga vjen".

"Nëse ke një vend ku ti gjen një kënaqësi të veçantë, qetësi për të menduar dhe ku merr energji pozitive, provo me kamerën tënde ta prezantosh në këtë konkurs dhe na lejo të mësojmë se çfarë është vendi yt i dashur. Nuk bëhet fjalë shumë për perfeksion teknik apo për pajisje speciale. Bëhet fjale për motive interesante, foto të kompozuara bukur dhe mbi të gjitha për shumë kreativitet", thuhet në shpjegimet për pjesëmarrësit.

Postimi i fotos apo videos, bashkë me një përshkrim të shkurtër mbi çfarë përfaqëson ajo, duhet të bëhet në: www.vendlindja.al. Paraprakisht duhet bërë regjistrimi online, duke plotësuar edhe një deklarim për pranim të kushteve të pjesëmarrjes.

Pas hedhjes së fotos ose videos je pjesë e konkurrimit. Më pak klikime ti mund të shtosh informacionet që duhen për ta bërë vendlindjen tënde të vizitueshme nga turistë dhe udhëtarë vendas e të huaj. Informacionet në këtë app mund të hidhet edhe nëpërmjet celularit, nëse disponon një smart-phone që ka internet dhe GPS.

Organizatorët japin edhe disa këshilla për t'u pasur parasysh. Fotot dhe videot duhet të jenë bërë prej jush dhe të drejtat e autorit të këtyre fotove të përkasin ty. Pranohen vetëm foto origjinale (jo foto të marra nga interneti). Nuk lejohet të bëhen ndryshime të përmbajtjes së fotos (p.sh. montime të fotove në kompjuter).

Të lejohet të dërgosh deri në katër foto dhe një video për çdonjërën nga kategoritë që janë prezantuar si: fshat i bukur me perspektive si destinacion turistik; atraksion turistik (kulture, natyre, agro-biodiveristet etj); akomodim tradicional (bujtine, stan); ushqim tipik i zonës (gatime të veçanta, një restorant tipik); artizanate të veçanta; komunitete me tradita të veçanta.

FITUESIT

Qëllimi i projektit nuk është shpallja e fotos apo videos fituese, por destinacioni që promovohet. Për këtë arsye edhe sistemi i vlerësimit është i thjeshtë: Do të klasifikohen fitues në varësi të pëlqimeve (Like) të marra.

Më pas, juria e ngritur për këtë qëllim do të verifikojë dhe vlerësojë fituesit! Pra, përpiqu të bësh sa më shumë miq për vendlindjen tënde, që të rritësh mundësinë për të fituar!

Fituesit për çdo kategori do të përfitojnë:

- Një program marketingu për t'i përfshirë në destinacionet turistike dhe përfshirja në paketën promocionale të turizmit malor për vitin 2017 nga AKT.

-Në bashkëpunim me bashki dhe projekte të veçanta do të vlerësohen fitues në nivel lokal, të cilët do të përfitojnë projekte mbështetëse për zhvillimin e turizmit dhe do të përcaktohen dhurata të veçanta.

-Platforma është tërësisht e integruar në Facebook, ku do të shërbejë si facebook app. Të gjitha postimet që ju do të bëni do të jenë në të njëjtën kohë edhe në faqen e internetit, që është krijuar enkas për këtë nismë www.vendlindja.al

Mos harroni, koha e dorëzimit të fotove dhe videove për fazën e parë të konkursit është deri me 5 prill 2017.

Trego vlerat e Dibrës është një iniciativë promovuese e ARZH2 dhe Bashkive Dibër, Bulqizë, Klos dhe Mat. Platforma e këtij konkursi është krijuar nga Ministria e Turizmit, AKT dhe projektet e bashkëpunimit të GIZ, UNDP dhe Instituti Kanadez i Teknologjisë.

Ndërkohë, ju mund informoheni edhe në facebook https://www.facebook.com/tregovendlindjen ose në www.vendlindja.al

turizmi kulturor

Mjeshtëria ndërtimore dibrane është e lashtë dhe dëshmohet nga kërkimet arkeologjike në trevën dibrane. Ndërtimit të kalave, veç krahëve të shumtë të punës, i nevojiteshin edhe mjeshtra të talentuar ndërtimi me njohuritë përkatëse që kërkonte teknika ndërtimore e kohës.

Objektet arkitekturore të Dibrës, mundësi për zhvillimin **e turizmit kulturor**

Nga **Dr. FATBARDH CENA**

Arkitekturë tradicionale është arkitektura e së kaluarës me zbatim kohor relativisht të gjerë. Monumentet arkitekturore janë pjesë e trashëgimisë kulturore materiale dhe vlerësohen për realizimin dhe ndërtimin e tyre në arkitekturë të veçantë e artistike. Rrethi i Dibrës dallohet për punime arkitekturore origjinale dhe karakteristike. Kjo pasi dibranët njihen në mbarë vendin si mjeshtra në fushën e ndërtimit. Monumentet arkitekturore përbëjnë trashëgiminë më të pasur materiale të rrethit të Dibrës.

Mjeshtëria ndërtimore dibrane është e lashtë dhe dëshmohet nga kërkimet arkeologjike në trevën dibrane. Ndërtimit të kalave, veç krahëve të shumtë të punës, i nevojiteshin edhe mjeshtra të talentuar ndërtimi me njohuritë përkatëse që kërkonte teknika ndërtimore e kohës. Punimet për zgjerimin e rrugës automobilistike në vitin 1983 rreth kalasë së Grazhdanit dhe pastrimi i mureve rrethuese nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, nxorën përdorimin e blloqeve kuadratikë të lakuar, dëshmi kjo e punimit të gurit që në periudhën qytetare ilire, shek. III-II p.e.s. Blloqet dëshmojnë për mjeshtra të talentuar të skalitjes së gurit. Shkallë të lartë njohurish ndërtuese dëshmojnë edhe materialet e ndërtimit si: tulla, tjegulla etj., të cilat dallohen për një teknologji të lartë punimi, që është për t'u admiruar. Mjeshtëria ndërtimore në Dibër duket se u trashëgua gjatë shekujve deri në ditët tona, duke u pasuruar edhe me përvojën e vendeve fqinje ku punuan ndërtuesit dibranë. Dibranët janë njohur si mjeshtra ndërtimi të gdhendjes së gurit e të drurit jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj në Bullgari, Greqi, Serbi dhe Turqi.

Stili i ndërtimit të banesës në Dibër është mjaft i kristalizuar, megjithatë në zona të ndryshme vërehet edhe trajtimi i ndryshëm arkitektonik e konstruktiv me elementë të veçantë që kushtëzohen nga faktorë të tillë si: relievi, klima, materialet rrethanore, ndikimet e krahinave fqinje etj. Ajo që në përgjithësi e dallon banesën në krahinat malore nga ajo fushore të Dibrës është materiali që përdorej për ndërtimin e saj. Në malësi si në Reç, Lurë, Selishtë, Çidhën, Cerjan, Bellovë, etj., si material kryesor është përdorur guri, rrasa, furda, ndërsa në fushë si Maqellarë, Kastriot, etj., qerpiçi e tjegulla. Dibra është e njohur për arkitekturën karakteristike të ndërtimit të shtëpive në Shqipërinë e Veriut, që janë kullat. Kullat janë të përhapura në të gjithë territorin e saj. Një pjesë e tyre kanë statusin e monumenteve të kulturës pasi ruhen nga shteti.

Dibranët kanë pasur një shije të hollë artistike për ndërtimin e banesave të veta, të cilat qenë shumë funksionale për kohën. Për ndërtime kanë shfrytëzuar materiale rrethanore. Këto materiale ndryshojnë në viset malore, me ato në vise fushore. Janë përdorur vazhdimisht për zbukurimin e banesës dibrane edhe elementë zbukurimi si arkitrarë prej guri të gdhendur, tavane dekorative prej dërrase të zdruktuar, daljet në formë ballkoni të formave të ndryshme etj. Shtëpitë dibrane ishin njëkatëshe e dykatëshe dhe rrallë, edhe trekatëshe. Shtëpitë e të varfërve, që përbënin shumicën dërrmuese ishin vetëm një katëshe, ndërsa të bejlerëve, agallarëve etj., ishin kulla dykatëshe dhe trekatëshe.

Sipas të dhënave të vitit 2016 nga DRKK Shkodër, sektori Dibër, në rajonin tonë të studimit janë të listuara dhe ekzistuese këto monumente kulture me vlera arkitekturore:

Banesa e Tashko Markos, fshati Herbel, NJA Maqellarë.
Banesa e Mudë dhe Sali Kadrisë, fshati Bellovë, NJA Melan.
Banesa e Selman Tollës, fshati Fushë Lurë, NJA Lurë.



Harta 1. *Shpërndarja e monumenteve të kulturës në rrethin e Dibrës. Burimi: DRKK Shkodër, sektori Dibër. Punoi: Fatbardh Cena.*


Banesa e Reshit Zunës

Banesa e Zef Doçit, fshati Fushë Lurë, NJA Lurë.
Banesa e Reshit Zunës, fshati Sohodoll, NJA Kastriot.
Banesa e Vehap Isakut dhe Ramadan Hysës, NJA Peshkopi.
Kulla e Dine Hoxhës, fshati Muhurr, NJA Muhurr.
Kisha e Shën Sotirit, fshati Kërçisht, NJA Maqellarë.
Kisha e Shën Dhimitrit, fshati Kërçisht, NJA Maqellarë.
Kisha e Shpërfytyrimit fshatin Herbel, NJA Maqellarë.
Xhamia e Allajbegisë, fshati Burim, NJA Maqellarë

Banesa e Selman Tollës është shpallur monument kulture me datë 18.12.1987, nga Komiteti i Kulturës dhe Arteve. Kjo banesë e tipit kullë, ndodhet në qendër të fshatit Fushë Lurë dhe dallohet për vlera të mëdha arkitektonike. Ndërtesa është trekatëshe, tipike për zonën dhe ndahet në tre ambiente. Kati i parë është për të qëndruar shërbëtorët, kati i dytë për familjarët dhe kati i tretë për miqtë. Kulla është ndërtuar me teknikën vendase të kohës me gurë dhe llaç gëlqeror. Në cepet e mureve dhe përreth derës e dritareve, janë vendosur gurë në forma katrore, që i japin pamje të bukur objektit.

Banesa e Zef Doçit është shpallur monument kulture me datë 27.07.2006, nga MTKRS. Kjo banesë e tipit kullë është trekatëshe dhe me strehë guri. Ndryshe nga kullat dhe banesat e tjera, pamjen ballore e ka nga ana e veriut. Banesa është ndërtuar me teknikën vendase me gurë e llaç gëlqeror dhe ka elemente tipike të kullës së Veriut, karakteristike për zonën. Çatia e saj është e mbuluar me furde, diçka e rrallë në vendin tonë. Banesa e Zef Doçit ndodhet në qendër të fshatit Fushë Lurë, buzë rrugës së asfaltuar.

Banesa e Mudë dhe Sali Kadrisë është shpallur monument kulture me 18.12.1987, nga Komiteti i Kulturës dhe Arteve. Kjo banesë është trekatëshe me një planimetri të thjeshtë. Dritaret e saj janë ndërtuar me materiale druri dekorativ dhe frengji ndërsa dyert prej druri të punuar mirë dhe me hark nga sipër me punim guri. Çatia e banesës nuk është uniforme ku një pjesë e saj është e mbuluar me llamarinë, ndërsa pjesa tjetër me tjegulla vendi. Materialet e ndërtimit janë gurë, llaç dhe breza druri. Tavanet janë prej dërrase dekorative ndërsa dyshemeja është prej betoni. Teknika e ndërtimit të banesës është unikale në llojin e saj.

Banesa e Reshit Zunës është shpallur monument kulture me datë 08.01.1977, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Kjo banesë e tipit kullë ka një planimetri të thjeshtë katërkëndëshe me përmasa 7×7.7 metër dhe lartësi 11 metër. Kulla ka 7 dritare me përmasa 1×0.7 metër ndërsa porta e kullës ka përmasa 0.96×1.60 metër. Është ndërtuar me gurë dhe gëlqere ku gjerësia e murit është 1 metër. Katet nga i dyti e lart kanë frengji me hekura të shumta. Teknika e ndërtimit është e veçantë në llojin e saj.

Banesa e Tashko Markos është shpallur monument kulture me datë 08.01.1977, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Kulla është dykatëshe dhe ka dy lloje dritaresh, të mëdhaja dhe të vogla ndërsa gjerësia e murit të kullës është 0.5 metër. Planimetria e saj është e thjeshtë, në formë katërkëndëshe. Banesa është ndërtuar me gurë, baltë e breza druri dhe rrethohet me avlli. Porta e banesës është e madhe me punim druri ndërsa çatia është mbuluar me tjegulla vendi.

Banesa e Vehap Isakut dhe Ramadan Hysës është shpallur monument kulture me datë 08.08.1980 dhe 25.10.1980, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Kjo banesë është trekatëshe e ndërtuar me gurë, llaç gëlqereje, shtuf dhe breza druri. Hyrja në katin e parë bëhet nëpërmjet tre portave në formë harku. Ndodhet në lagjen "Treg" në qytetin e Peshkopisë.

Kulla e Dine Hoxhës është shpallur monument kulture me datë 17.05.2010, nga MTKRS. Kjo kullë trekatëshe është ndërtuar në vitin 1929 me gurë, llaç dhe breza druri. Secili kat është i ndarë në një ambient të vetëm, kati i parë për të qëndruar shërbëtorët, kati i dytë për pjesëtarët e familjes dhe kati i tretë për miqtë. Qoshet e mureve të kullës janë ndërtuar me gurë të punuar, ndërsa çatia është mbuluar me tjegulla vendi.

Kisha e Shën Sotirit (Sveti Spas) shpallet monument kulture me datë 30.05.1970, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Muret e saj janë të ndërtuara me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Në këto mure ruhen afreske me përmasa 7×3.2 metër, por që janë të dëmtuara. Çatia është e mbuluar me rrasa guri. Kjo kishë është ndërtuar në vitin 1270.

Kisha e Shpërfytyrimit është shpallur monument kulture me datë 30.05.1970, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Është ndërtuar para pushtimit turk, me një teknikë të thjeshtë trefaqeshe. Teknika e ndërtimit është artizanale, kulturë bizantine, periudha mesjetare e hershme. Muret e saj janë të ndërtuara me gurë dhe llaç gëlqereje. Megjithëse numri i besimtarëve ortodoksë është i vogël, kisha respektohet dhe mirëmbahet nga popullsia e zonës.

Xhamia e Allajbegisë është shpallur monument kulture me datë 30.05.1970, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Xhamia është ndërtuar në vitin 1585, ka formë kubike me kupolë si dhe sallën e lutjeve me përmasa 6.4×6.27 metër. Minareja e saj ka


Kisha e Shën Dhimitrit

bazament shumëfaqesh dhe 10 dritare me korniza guri. Teknika e ndërtimit është artizanale, sipas kulturës shqiptare.

Kisha e Shën Dhimitrit është shpallur monument kulture me datë 25.09.2007, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kjo kishë është ndërtuar nga muratorë vendas në vitin 1892, me gurë e llaç gëlqereje dhe anon nga kultura bizantine. Çatia e saj ka konstrukt druri të mbuluar me rrasa guri ndërsa tavani është i zbukuruar me afreske.

Literatura:

Bashkia Peshkopi, *Guidë turistike*, Tiranë 2010.
Bunguri, A., *Prehistoria e Dibrës*, Tiranë 2010.
Cena, F., *Natural and cultural heritage of Dibra district,* The 4-th International Multidisciplinary Conference in Integrating Science in New Global Challenges, Dubrovnik, Croatia 2015.
Cena, F., *Turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm në rrethin Dibër,* Studime gjeografike 19, Tiranë 2015.
Cena, F., *Turizmi në rrethin e Dibrës.Studim gjeografiko-turistik.* Disertacion, Tiranë 2017.
Daci, F., *Enciklopedia e Dibrës*, Vëll. I, Tiranë 2006.
Grupi Lokal i Veprimit "Deshati", *Mirësevini në vargmalin Korab-Deshat*.
Kaca, I., *Rrugët e vjetra të Dibrës*, Tiranë 2003.
Shini, Xh., *Një vështrim mbi banesën karakteristike e ndërtimet tona të sotme*, Dibra dhe dibranët, Vëll. I, Peshkopi 1981.
Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër, sektori Dibër.
Të dhëna nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.
Ligj nr. 93/2015 "Për turizmin".
Ligj nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore".
Ligj nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën".
Ligj nr. 7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme".
Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".



Për në **Petralbë**, *një rrugë* **drejt historisë**

Nga **ADI DARSI**

Banorëve të Klosit dhe fshatrave për rreth, kur dëgjuan zhurmën e mjetit që hapte rrugën për në Kalanë e Petralbës, duhet tu jetë dukur një gjë normale. Prej vitesh nëpër fshatra po bëhen përpjekje të mëdha për të ndërtuar infrastrukturën aq shumë të nevojshme dhe po aq shumë të munguar. Traktorët hapin kudo akse që në të shumtën e rasteve dimri i bën përsëri të pakalueshme. Është një betejë që vazhdon për vite me radhë. Ndaj dhe zhurma që vinte nga fshati Fshat duhet të jetë dukur si diçka e zakonshme. Por nuk është ashtu. Rruga për në Petralbë nuk është si gjithë të tjerat. Ajo edhe pse jo më shumë se sa disa qindra metra është më e gjatë se gjithë të tjerat. Është një rrugë që shkon drejt identitetit të të gjithë zonës. Është një rrugë që të çon drejt historisë së lavdishme të trevës "që ka nxjerrë mbretër". Është lidhja e fushës breg Lezedrës e Matit me majën nga ku shfaqet me gjithë madhështinë e vet e gjithë ajo që njihet kudo si Lugina e Matit.

MË MIRË VONË SE KURRË

Ndërtimi i një rruge lidhëse nga fshati Fshat për në Kalanë e Petralbës është një iniciativë e Bashkisë Klos. Saktësisht ajo është këmbëngulja e kreut të Bashkisë, Basir Çupa, i cili duke qenë i lindur aty e sheh rrugën si nisjen e një projekti më të madh kulturor. Krijimi i mundësisë për ta vizituar lehtësisht kalanë, nëpërmjet rrugës, hap shtigjet edhe për më shumë kujdes për të, lehtëson punën për ta pastruar e ristrukturuar aty ku është mundësia. Në këtë mënyrë ajo nuk mbetet më thjeshtë një legjendë dhe citim prej "Historisë së Skënderbeut" të Marin Barletit, por në të njëjtën kohë bëhet edhe një realitet i prekshëm për të gjithë banorët, pse jot ë mos e themi edhe për brezat që do ti vijnë. Kalaja ka qenë aty në majën e malit. Ashtu siç u ka mbijetuar dikur betejave e luftrave i është dashur ti mbijetojë edhe braktisjes e moskujdesit. Rruga e nxjerr atë nga "shkurret" ku ishte zhytur për qindra vite me radhë, e bën atë të vizitueshme dhe njerëzit kanë mundësinë të shohin me sytë e tyre madhështinë e luginës ku ata jetojnë, e luginës ku sipas Barletit ka jetuar dhe luftuar edhe vetë Heroi Kombëtar, Skënderbeu. Është një punë që duhet të ishte bërë shumë kohë më parë. Por...kot nuk thonë: Më mirë vonë se kurrë.

NJË MUZE? PSE JO.

Kryetari i Bashkisë së Klosit, Basir Çupa thotë se gjithçka po bëhet me fondet e vetë pushtetit vendor. Ka nisur si një projekt i vogël, me shpresën se një ditë do të mund të realizohet gjithçka ajo kala e meriton. Pas rrugës, planifikohet të pastrohet terreni përreth për të evidentuar me mirë kalanë. Më pas në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës po synohet të hartohet një projekt restaurimi, për të mundur të kthehen disa nga vlerat e asaj kalaje, që për nga rëndësia vjen e dyta pas Krujës. Është e konfirmuar tashmë nga burimet historike se ajo kala ka qenë "shtëpia e dytë" e Skënderbeut. Por kryebashkiaku Çupa synon të bëjë edhe më shumë. Në anë të kalasë po punohet për hapjen e një sheshi i cili mund të jetë trualli ku mund të ndërtohet një muze. Është paradoks por zona me aq shumë histori nuk e ka një muze historik. Bashkia e synon ta bëjë dhe meriton përgëzime. Do të duhet shumë punë ndoshta deri atë ditë, do të duhen koordinuar shumë ekspertë e institucione, por ama pa u nisur asgjë nuk bëhet.

NË PRITJE TË RRUGËS SË ARBRIT

Petralba është kalaja e dytë më e rëndësishme e shtetit të Arbërit. Por ajo është edhe pse më kryesorja vetëm një pjesë e mozaikut "Arbër". Gjithçka që ka qenë në shërbim të saj, urat e gurta, kalldrëmet, kalët e tjera më të vogla e karakollet do të marrin një kuptim të vërtetë të një vlere të turizmit historik, do të mund të kthehen në atraksione vetëm pasi të jetë ndërtuar e shumë pritura Rruga e Arbrit. Është aksi më historik i Shqipërisë mesjetare, që ashtu si Kalaja e Petralbës e harruar mes shkurreve në majë të malit të Fshatit, është harruar në shkurret e burokracisë dhe zilive shtetërore prej më shumë se 30 vjetësh. Për të deri më tani vetëm flitet e premtohet e asgjë nuk bëhet. Nuk dihet sa do të vazhdojë kjo histori. Por kreu i Bashkisë së Klosit shpreson. Rrugën për në Kalanë e Petralbës ai e ka lidhur direkt me vendin ku kalon projekti (ende jo rruga) i Rrugës së Arbërit. Po ndërtohet mundësia që madhështinë e Petralbës ta shohin të gjithë.

Petralba, shtëpia e dytë e Skënderbeut

Petralbën populli i zonës e ka quajtur ndryshe edhe "Kalaja e Skanderbegjut". Aty për shekuj me radhë janë rrënojat e saj, e bashkë me ato edhe sot e kësaj dite ruhen dhe toponimet. Studiuesi Aqif Ymeri, që është marrë prej kohësh me këtë temë, përmend shumë prej tyre si Tanushë, Gurëza, Maja e Qytetes, Dyqanet e Venedikasve etj. Kalaja ngrihet mbi lartësinë 878 m në majën e malit tëfshatit Fshat, në anën më jugore të Bashkisë së Klosit. Muret e saj janë të ndërtuara me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Thuhet se deri në vitet 70 të shekullit të kaluar, aty dalloheshin dhe më një shikim sipërfaqësor, themelet e dy kullave të fortesës, si edhe fragmentë të murit rrethues të fortesës.

E vendosur në një pikë strategjike mbi luginën e Matit, Petralba kontrollonte pjesën më të madhe të saj si edhe akset lidhëse, ku më kryesorja ishte padyshim Rruga e Arbrit, që niste nga Durrësi, Albanapoli, Pershqopi e Petrela, Qafë Murrize, zbriste në këmbë të fortesës së Petralbës. Aty rruga ndahet në dy degë: njëra nga veriu kalonte në kalanë e Cerujës, në kalanë e Stelushit e për të zbritur më pas nëpër luginën e Drinit drejt Prizrenit. Dega tjetër ishte nga lindja Petralbë-Qafëbuall, Ura e Topojanit, kalatë e Grazhdanit e Sfetigradit e shkonte drejt Shkupit. Po ashtu Petralba zotëronte edhe lidhjet e brendshme të luginës së Matit. Ende ka gjurmë të aksit që e lidh me qytezën e Komsisë e cila, kalon nëpër fshatrat Dars, Fullqet, Gurrë, Komsi, për të vijuar më pas lidhjet e tjera nga Qafa e Shtamës.

Përshkrimin më të plotë të rëndësisë historike të Kalasë së Petralbës e gjejmë tek "Histori e Skënderbeut" e Marin Barletit, i cili në origjinal e quan atë Petram Albam, që në shqip është Guri i Bardhë. Sipas Barletit, Skënderbeu në vitin 1443 pasi ka marrë Krujën dhe Petrelën i është drejtuar Petralbës. "Duke vazhduar drejt rrugën, arritëm në Petralbë, e cila është larg nga Petrela 30 mijë hapa, nga Kruja po 30 mijë, ndërsa Petrela nga Kruja 25 mijë hapa. Ky është një qytet në Mat, i ndërtuar mu në majë të një mali të vogël, por që s'i trembet, megjithëkëtë, përveç urisë, asnjë fuqie armiku. Veç kësaj, lumi i Matit, që rrjedh rrëzë malit, duket se i shton këtij vendi jo më pak bukurinë sesa fuqinë mbrojtëse dhe dobinë. Sapo ushtria zuri vend e nguli çadrat nën muret, erdhën disa të dërguar nga ata të qytetit te Skënderbeu dhe i bënë me dëshirën e vet dorëzimin e qytetit. Edhe këtyre u dhanë dhe ua mbajtën gjithë zotimet, që u kishin dhënë e mbajtur më parë petrelasve, dhe bashkë me rojën armike u dërguan disa nga tanët për t'i ruajtur se mos pësonin gjë nga banorët e krahinës", shkruan Barleti.

Më pas merr edhe Stelushin dhe më28 nentor 1443 Skënderbeu zotëron fronin e të atit Gjonit. Ndërsa në një tjetër rast, tek përshkruan pushimet mes betejave, Barleti



Pamje Kalaja e Petralbës.

shkruan: "E shpërndau mbledhjen e ushtrinë i la të gjithë të lirë të ktheheshin në shtëpi, ndërsa ai vetë, bashkë me Hamzën dhe me pak kalorës, shkoi në Petralbë. Atje ai kishte lënë të shoqen që në fillim të verës, gjë që e bëri pastaj gjatë gjithë kohës së mbretërisë, me qëllim që verën dhe vjeshtën të qëndronte atje për prehje, kurse kohën tjetër në Krujë, me përjashtim të rasteve kur vinte Mehmeti apo ndonjë mizëri tjetër me ushtarë". Pikërisht në këtë rast Barleti bën edhe një përshkrim unikal të zonës. "Rrëzë kështjellës ishte një fushë me një bukuri të veçantë, si nga hijeshia e vetë natyrës dhe e vendit, si dhe nga punimi plot kujdes i banorëve, saqë s'i mungonin as pemët, as hardhitë, as frutat, asgjë nga ato që begatojnë dhe zbukurojnë tokën. Atje, zonja, bashkë me familjen dhe me vargje të pambaruara vajzash e me shërbime mbretërore, sipas zakonit, e kalonte atë pjesë të vitit. Rreth e rrotull, nga çdo anë e fushës ishin pyje të paafrueshme dhe ngushtica luftëtarësh për ruajtjen e saj. Dhe vetë qytetin e kishte të pajisur si jo më mirë me burra, armë dhe ushqime për çdo rast".

Barleti e provon plotësisht faktin se Skenderbeu ka ndenjur familjarisht në Petralbë. Madje sipas gojëdhënave ashtu si ai vetë edhe i biri i tij, Gjoni kanë lindur pikërisht në këtë kala. Por Petralba, nuk ishte thjeshtë e vetëm një zonë banimi. Për Skënderbeun, gjithnjë sipas Barletit, kalaja dhe zona ishin edhe një prapavijë shumë e rëndësishme luftarake. "Skënderbeu, pasi arriti në kamp, i cili ishte vendosur në një vend që quhet Petralbë, 15 000 hapa larg armikut, ku kishte 8 000 kalorës dhe 4 000 këmbësorë nga më trimat, po armatosej e po bëhej gati për t'u nisur kundër armikut", shkruan Berleti teksa përshkruan betejën e Vajkalit mes Skënderbeut e Ballaban Pashë Batrrës.









Monumentet e trashëgimnisë kulturore në Bashkinë Klos

LISTA E MONUMENTEVE KULTURORE E HISTORIKE BASHKIA KLOS

Kalaja e Petralbës	Gur i Bardhë	***1963***
Kalaja e Xibrit	Xibër	***1973***
Urae Halilit	Dars	***1977***
Ura e Gurrave	Gur i Bardhë	***1984***
Ura e Hoxhajve	Gur i Bardhë	***1984***
Ura e Vashës	Fshat	***1983***
Kisha e varri monumental	Suç	***1984***
Kulla e Elmaz Muharemit	Gurrë të Madhe	***1973***
Kulla e Sul Lëkursit	Gurrë e Madhe	***1973***
Kulla e Abdulla Zylfit	Kurdari	***1973***
Kulla e Ali Seftës	Kurdari	***1973***
Kulla e Çelës	Patin	***1973***
Banesa e Rexhep Karait	Dars	***1973***
Banesa e Asllan Hutës	Plan të Bardhë	***1973***
Banesa e Jakup Kurtit	Plan të Bardhë	***1977***
Banesa e Hysen Dedollit	Bejn	***1977***
Banesa e Bajram Allushit	Klos Katund	***1977***
Banesa e Rexhep Lleshit	Klos Katund	***1977***
Banesa e Veli Domit	Gur të Bardhë	***1977***
Banesa e Elmaz Dezhgiut	Gur i Bardhë	***1977***
Banesa e Xhelal Bodës	Gur të Bardhë	***1977***

Nga viti 1963 e deri më 1977 në zonën e Klosit janë identifikuar mbi 20 monumente të trashëgiminisë kulturore.

Mati përgjithësisht dhe Klosi në veçanti janë të përmendur për ndërtimet e tipit kullë, ndërtesa që kanë qenë të përhapura gjerësisht. Shumica e tyre, edhe për shkak të mundësive financiare dhe të kujdesit për mirëmbajtje nuk kanë mundur ti rezistojnë kohës, por mjaft prej tyre janë edhe sot.

Për tu shtyrë më thellë në kohë zona është e përmendur edhe për kalatë e shumta dhe urat e gurta që dëshmojnë akset lidhëse të asaj kohe. Të tilla përmenden kalaja e Xibrrit, kalaja e Cerujës, si edhe Ura e Vashës që është me e bukura e mbetur mbi Mat. Thuhet të ketë qenë edhe një urë tjetër mbi Mat shumë më e madhe se ajo, ura që i kishte dhënë emrin edhe pazarit (Pazari i Urës) , por sot nuk ka asnjë gjurmë të saj. Zona është e përmendur edhe për prodhimin e barotit, por gjurmë të kësaj zeje nuk ekzistojnë më, ndonëse deri vonë ka patur një numër të madh mullinjsh bloje me ujë, vende ku mund të kenë qenë edhe digat e barutit. Aktualisht për gjithë këtë trashëgimini historike, sidomos pas viteve 90 është bërë shumë pak dhe mjaft prej atraksioneve janë harruar dhe më keq akoma edhe rrënuar.

Gazeta "Rruga e Arbërit" do të vazhdojë t'ju njohë me guida të tjera në qarkun e Dibrës, me qëllim nxitjen e zhvillimit të turizmit në rajon.

Rabdisht-Bellovë
një udhëtim i paharrueshëm



Pamje nga fshati Rabdisht. Fotot: © Grehans Uka

Nga GREHANS UKA*

Fshatrat Bellovë, Cerjan, Zagrad dhe Rabdisht ndodhen në një distancë jo më larg se 7 km larg qytetit të Peshkopisë, në njësinë administrative Melan. Kjo zonë mbart vlera historike, kulturore dhe vlera natyrore, të cilat vlerësohen si tërheqëse për njerëzit që e vizitojnë për herë të parë. Por si pika më tërheqëse janë fshatrat e Bellovës dhe Rabdishtit.

Për të gjithë personat, të cilët shprehin interesin për të vizituar këtë zonë, itinerari që ofrohet është një ditor dhe nis nga Muzeu i Peshkopisë vazhdon për në fshatin Rabdisht, Bellovë dhe mbyllet në Stacionin e Llixhave të Peshkopisë. I gjithë itinerari është lehtësisht dhe i mundur që të përshkohet në ecje me këmbë.

Pika nisjes së këtij itinerari fillon tek Muzeu i qytetit të Peshkopisë, i cili dikur ka shërbyer si Shtëpia e Kulturës për trevën e Dibrës. Ecja vazhdon drejt shëtitores kryesore "Elez Isufi", e cila përveç emrit të një prej figurave historike të Dibrës, dallohet për gjerësinë e saj dhe karakterizohet prej pemëve të blirit dhe pishës, që e bëjnë më të veçantë ecjen. Gjithashtu, përgjatë kësaj shëtitoreje mund të shikojmë Pallatin e Kulturës "Haki Stërmilli" dhe bustin e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit- Skënderbeu.

Pasi lëmë pas shëtitoren kryesore të qytetit përballemi me disa shtëpi të vjetra të punuara me gurë ose me mure prej balte, jo më shumë se 2 kate. Të gjitha të vendosura mbi njëra-tjetrën dhe me nga një oborr të vogël para. Këto shtëpi përbëjnë lagjen e vjetër të qytetit, e cila ishte qendra e aktiviteteve tregtare dhe institucionale. E karakterizuar nga rrugicat me gurë dhe arkitektura tradicionale e qendrave kryesore të para 100 viteve shtrihej mbi përroin e llixhave. Aty aktivitetet kryesore ishin tregu i zejtarëve dhe fshatarëve të zonave përreth, shkollat e para shqipe, ku në sy bie shkolla e parë e vashave, e hapur më 1915. Gjithashtu, janë edhe objektet e kultit, ku duket xhamia e vjetër, si dhe institucione më të rëndësishme shtetërore për kohën. Ndër fiset e vjetra që jetojnë në këtë lagje janë: Fisi Stojku, Bardulla etj.

Duke lënë pas këtë lagje ngjitemi në lagjen e Bulkllarëve, ku emrin e ka marrë nga fisi Bulku; me drejtimin drejt Parkut Natyror të Bugjunecit dhe pastaj në Gradishtën e Peshkopisë.

Ndalesa e parë vjen në Gradishtën e Peshkopisë. Krahas një pushimi, do të shikohen gjurmët e një murri rrethues të një prej kalave, njëkohësisht dhe të kishës së njohur me emrin si Peshkopata e Stefanikës nga ku mori emrin Peshkopia. Mendohet që është ndërtuar gjatë kohës së perandorit romak Justinian në vitet 527-565 (shek. VI pas Krishtit) dhe mendohej të kishte një sipërfaqe prej 1500 m^2.

Duke lënë Gradishtën e Peshkopisë para do të na shfaqet një hapësirë e madhe, ku fare thjesht përpara dallohet vargmali i Korabit, ku në këtë pjesë dallohen Bjeshkët e Rabdishtit dhe Cerjanit. Para tyre dallohet Mali i Rabdishtit, që ka formën e një piramide natyrale. Duke ecur përkrah përroit dhe shpatit të gipsit me pisha (monument natyre i njohur si Borovëjku), ne i afrohemi një kryqëzimi të madh me tre drejtime: drejtimi drejt Rabdishtit, Zagradid dhe ai drejt fshatrave të Bellovës e Cerjanit. Pranë këtij kryqëzimi ndodhet edhe njëri nga burimet me ujë të ftohtë termalë që përdoret për qëllime shëndetësore, por edhe si atraksion turistik. Këtu është edhe ndalesa e dytë, ku shijojmë natyrën që ofron vargmali me pisha dhe nën zhurmën që krijon uji termal që del nga thellësia e malit të Rabdishtit.



I drejtohemi Rabdishtit. Me të mbërritur në fshatit këtë fshat shijojmë mjedisin që krijon arkitektura e tij dhe ngjyra gri e gurëve të rrugicave dhe shtëpive e ndërthur me mikpritjen e banorëve. Interesant është fakti që banorët po i restaurojnë shtëpitë sipas mënyrës tradicionale. Ndalesa në këtë fshat do të jetë në njërën nga shtëpitë pritëse për turistë, në familjen e Haki Golecit ose Sabri Shahinit. Aty, përveç mikpritjes, shijohet edhe ushqimi tradicional nga produktet prodhuar nga vetë banorët, që nga pula me jufka, patatet, gatimet me miell misri e djathi deri tek frutat e fermës së këtyre familjeve dhe rakia. Gjithashtu, shikojmë edhe mikpritjen e ngrohtësinë që përçojnë tek miqtë këta banorë.

Pasi lëmë pas fshatin e Rabshtit, i ngjitemi malit të Rabdishtit që na krijon idenë e ngjitjes drejt një piramide natyrale. Pasi ngjitemi në lartësinë 1800 m mbi nivelin e detit, shikojmë qartazi fshatin Rabdisht, ndërsa në krahun tjetër të malit shfaqet Gradsihta e Bellovës dhe fshtrat Cerjan e Zagrad, në largësi dhe në afërsi Bellova. Sa më shumë zbresim, aq më shumë afrohemi drejt fshatit Bellovë, ku do të vizitojmë kompleksin e Sul & Mudë Kadrisë, që dallohet për kompozimin dhe mënyrën e ndërtimit me çardak. Për këtë, në 18 dhjetor 1987 është shpallur si monument kulturor.

Pasi lëmë edhe fshatin e Bellovës, nisemi drejt Peshkopisë. Përpara do të shikojmë një mulli të vjetër, i ndërtuar në vitin 1951 nga familja Saraçi dhe i restauruar në 2015 nga Korpusi i Paqes dhe Outdoor Albania Association në bashkëpunim me një grup studentësh të Universitetit të Vjenës. I ngritur pranë një burimi tjetër termal ujit të ftohtë, e gjithë puna e këtij mulliri për përgatitjen e miellit realizohet nga uji, që vë në lëvizje gjithë mekanizmin. Gjithashtu, vlerësohet si aset turistik, sepse është interesant ruajtja e këtij mekanizmi pune.

Më poshtë është burimi në natyrë me ujin e nxehtë me përmbajtje squfuri dhe gipsi që shërben si mjet kurativ për shumë sëmundje. Gjithashtu, furnizon edhe kompleksin e llixhave, i cili është ndërtuar rreth viteve 1970. Në këtë kompleks ofrohen edhe seanca kurative me baltën e kësaj zone, sepse shërben për sëmundjet reumatizmale, nervin shiatik etj.

EMËRTIMI I SHTEGUT:
Peshkopi- Rabdisht- Bellovë- Peshkopi
Ku niset: Muzeu - Peshkopi
Ku përfundon: Kompleksi i Llixhave
Distanca në km: 14km
Kohëzgjatja e udhëtimit: 5 orë
Pikat kryesore përgjatë shtegut:
1. **Lagjja dhe Pazari i vjetër i Peshkopisë**
2. **Gradishta e Peshkopisë**
3. **Stacioni i Llixhave**
4. **Burimet e ujërave termalë (Burimi i ujit të ngrohtë dhe të ftohë)**
5. **Mulliri i përgatitjes së miellit (mulli me punim me ujë)**
6. **Banesa e Sali Kadrisë (në fshatin Bellovë).**
7. **Borovëjku (Shpati gëlqeror i mbuluar prej pishave, në rrugën e Rabdishtit)**
8. **Fshati Rabdisht**
9. **Gradishta e Bellovës**

VENDQËNDRIMET KU TURISTËT MUND TË KALOJNË NATËN OSE NJË NDALESË PËR USHQIM TRADICIONAL:

1. **Hotel dhe Restorant "Ballkan"**
2. **Hotel dhe Restorant "Natyra e Qetë"**
3. **Hotel dhe Restorant "Alpin"**
4. **Shtëpi pritëse Goleci, Rabdisht (Fitim Goleci)**
5. **Shtëpi pritëse Shahini- Rabdisht (Sabri Shahini)**
6. **Shtëpi pritëse Feta- Zagrad (Nexhat Feta)**

Kostoja e shërbimit të guiderit: 30 euro (vetëm shërbimi si guider)









Këtu mbyllet vizita një ditore në itinerarin Peshkopi – Rabdisht – Bellovë - Peshkopi.

Autori është një guidë e certifikuar nga GTZ dhe Shoqata Alpine Gjermane. Për të shijuar këtë guidë, mos hezitoni të kontaktoni me Grehans Ukën në numrin e telefonit (+355) 0673625835 (What's app & Viber) ose përmes emailit
<udhetomegresin@gmail.com>

Në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit" do t'ju njohim me guida të tjera në qarkun e Dibrës, me qëllim nxitjen e zhvillimit të turizmit në rajon.

Rruga e Arbërit nr. 131

mendim

Një “udhëtim” malli dhe dashurie nëpër trevën ku linda dhe u rrita, një “udhëtim” me shpirt, nga larg...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



Natyra dibrane, *“guaska” që mban* **“perlën”** *e bukurisë* **shqiptare**

“Në shtyp flitet për “minierat e kaltra”, për bregdetin tonë bukuri rrallë e vlerat e tij turistike. Mirë bëhet. Por mos harrojnë Lurën dhe simotrat e saj, “minierat e kaltra, të gjelbërta e të bardha”. Shfrytëzimi i tyre ka reflekse të gjëra e të thella në zhvillimin ekonomik e shoqëror të zonave malore, në lidhjen e brezit të ri me një veprimtari që sjell kulturë e qytetërim të maleve”.

Më 10 maj 1991, atëherë kur mendimi nuk kishte fre, pata përcjellë për botim një shkrim pesë faqesh me titullin Ndërmarrja turistike “Liqenet e Lurës”.

Ishte koha kur njerëzit kishin filluar jo thjesht të ëndërronin për një jetë tjetër por edhe të “shtronin rrugë” drejt saj.

E kam njohur Dibrën në tërë përmasat e saj nga Draj—Reçi në Llangë, nga Mërkurthi në Rrafshat e Korabit...

“Kur flasim për Lurën, shënoja atëherë, mendja na shkon tek bukuria e saj natyrore, tek liqenet-tejet të bukur, tek pyjet-tejet madhështorë, tek livadhet luleshumë e kullotat që ushtojnë nga blegërima e qengjave, tek...

Shkrimet e shumë autorëve thekëset i vënë gjithnjë në bukuritë e Lurës. Për begatinë e saj gati-gati nuk bëhet fjalë. Edhe kur ndonjëri bën ndonjë tentativë nuk shkon më tej se sa tek thirrja ekologjike për mbrojtjen e gjithëçkaje të virgjër e natyrore që ka kjo zonë. Kjo vjen nga inkopetenca e disave dhe nga mungesa e guximit e disa të tjerëve, sidomos e specialistëve, zëri i të cilëve ka ardhur koha të dëgjohet në “kor” për shfrytëzimin e pasurive të tilla materiale e shpirtërore si Lura dhe simotrat e saj në male. Burokracia dhe monizmi i kanë shumë borxhe Lurës dhe simotrave të saj në Dibër e gjetkë”.

Më tej vazhdoja:

“Bukuria e kësaj treve nuk mund të kuptohet pa praninë dhe dorën e njeriut. Lura është një perlë e natyrës sonë kur atë e kundrojnë dhe shijojnë njerëzit, veçanërisht të rinjtë dhe të rejat. Por perla është e bukur në gjerdanin e thurur mjeshtërisht nga kujunxhiu e jo në guaskën e moluskut.

Estetët dhe specialistë e tjerë në Lurë janë të domosdoshëm. Estetë nga vendi, por edhe nga bota, afaristë të mirëfilltë të estetikës malore, njerëz që nesër e pasnesër do të fiksojnë në retinën e syrit të vizitorit e pushuesit “një Lurë që i del përpara Zvicrës”. Por para tyre, madje ata që duhet tu ngjiten të përpjetave “me vrap”, janë ekonomistët, afaristët bashkëkohorë. Bukuria që ofron Lura duhet të “shitet”, të sjellë të ardhura. Nuk jemi mësuar me këtë “term”, ndaj e vura në thonjëza. Duhet të mësohemi, të mprehim hollë mendimin afarist për pasuritë tona tejet të mëdha.

Në Mërkurth, Tajan apo Mazdejë, në këto tre qafa që lidhen me rrugë automobilistike me Lurën, është koha të vëmë “postblloqe” ku çdo njeri që hyn të paguajë kënaqësinë që ofron Lura e bukur me peizazhin e saj të papërsëritshëm. Turistët e huaj të paguajnë me dollarë, turistët vendas me lekë në dorë. Kërkesa dhe oferta duhet të veprojnë edhe në turizëm. Qejfin sot bota e paguan me çmime shumë të larta.

Që të arrijmë deri këtu duhet menduar dhe investuar në dy krahët: në ndërtimin e veprave dhe mjediseve turistike dhe në “ndërtimin” e koncepteve të reja për shfrytëzimin e dhuntive që ofron natyra jonë...”

“...Turistit këtu mund ti ofrohet kos në kupa druri (prodhuar nga mjeshtrit e Lurës), mish qengji apo keci (të prerë para syve të turistit e të kaluar në hell), kërpudha të freskëta pylli, mish të freskët gjahu, mjaltë bjeshkësh në hoje, pije freskuese alkoolike të prodhuara nga frytet natyrorë të zonës si mjedra, luleshtrydhja, thana, qershigla, dëllinja etj. etj.kundrejt çmimeve të larta turistike.

> Lura është një perlë e natyrës sonë kur atë e kundrojnë dhe shijojnë njerëzit, veçanërisht të rinjtë dhe të rejat. Por perla është e bukur në gjerdanin e thurur mjeshtërisht nga kujunxhiu e jo në guaskën e moluskut.

Në liqenet e Lurës mund të rritet trofta e të bëhet gjueti turistike e peshkut me grep ashtu si mund të rritet kujdesi për kafshët dhe shpendët e gjahut e të organizohet gjuetia turistike e tyre...”

“Folëm për Lurën, për Parkun Kombëtar të liqeneve të Lurës, park i cili duhet zgjeruar me ligj e me kufij natyrorë Qafën e Mërkurthit, Masdejës, Tajanit, Pregj-Lurës... Fusha e Pelave me përmasat e një aeroporti të madh, 2-3 kilometra larg liqenit të Luleve është një bukuri më vete ashtu siç është edhe Lan-Lura e Krej-Lura, dy pika shumë të favorshme për ngjitjen dhe zbritjen e helikopterëve turistike...”

“...Liqenet e Kacnisë janë po aq të bukur (në mos më të bukur) se Liqenet e Lurës. Po ashtu edhe Liqenet e Tërnovës. Po ashtu edhe Grama me lartësitë e Korabit me bjeshkën e Zonjave, pyllin, liqenin artificial, burimet e shumta që të bien ballit, vend i mrekullueshëm për turizëm dimëror e veror...”

“Në shtyp flitet për “minierat e kaltra”, për bregdetin tonë bukuri rrallë e vlerat e tij turistike. Mirë bëhet. Por mos harrojnë Lurën dhe simotrat e saj, “minierat e kaltra, të gjelbërta e të bardha”. Shfrytëzimi i tyre ka reflekse të gjëra e të thella në zhvillimin ekonomik e shoqëror të zonave malore, në lidhjen e brezit të ri me një veprimtari që sjell kulturë e qytetërim të maleve”.

* * *

Duke lexuar ato që kam shkruar më 10 maj 1991, duke kujtuar Lurën asokohe të virgjër dhe ëndrrën e një njeriu që në shpirt e deshi Lurën Zonjë, bukuritë e Dibrës si “perlë në gjerdan”, ndjeva mall dhe emocion, boshllëk shpirtëror tek mësoj se pyjet e Lurës janë prerë e sakatuar, se liqenet po thahen e burimet shterojnë, se Lurasit e kanë braktisur vendin në kërkim të një jete që nuk të jep jetën e humbur, se Lura ka po ato rrugë me kalldrëm e me bar si i ka pasur më se një çerek shekulli më parë...

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me bukuritë e tjera të Dibrës, edhe me rrugët e saj, edhe me rrugën e premtuar në të gjitha fushatat elektorale, Rrugën e Arbrit.

* * *

Dibra ka një monument, bukurie dhe trimërie, një monument që flet më shumë se sa njëqind lektorë njeri pas tjetrit. Kam kaluar “gjoksit” të këtij monumenti, rrugës “litar hedhur në shkëmb”. Kam kaluar vetëm njëherë atëherë kur isha i ri dhe tensionin arterial e kisha normal. Do desha të kaloj edhe njëherë, shumë herë, i kapur jo pas litarit në shtegun e ngushtë ku pa tre pika mbështetje (asokohe “dy këmbë në rrugën litar dhe një dorë poshtë shkëmbit të zi) por në një rrugë të sigurt turistike.

Në librin “Po Dibrës! Jo Skavicës! në shkrimin “Kthimi i Gjergj Gjon Kastriotit në vendlindje” ndalesha në disa rreshta tek Gjalicat e Lurës, tek Kanali i Çidhnës, në idenë që një digë natyrore ta kthente mjedisin e ngushtë në një liqen-hidrocentral...

Shënoja...

“...Brezit që do të vijë do të desha që pas digës së Setës, diku në Grykën e Gjalicave të Lurës, të gjenin një “mol gondolash” që do ti përcillnin midis asaj pamje mahnitëse të Gjalicave, atij “tuneli” shpatesh të thepisura malesh nga kalon “kanali i piketuar me pushkën e Gani Tuçepit” ai i Çidhnës tek burimet e Setës në Gurë Lurë e prej andej, me teleferik ti ngjisnin në bregun e Liqenit të Luleve e në Fushën e Pelave...”

Një ëndërr? Lexojeni si të dëshironi.

Unë do të thosha... “Një bukuri natyrore dhe një heroizëm tipik popullor dibran-një piketim me karabinë gjermane nga Heroi i veprave ujore Gani Tuçepi, një piketim me mjete teknike të kohës nga Laureati i Çmimit të Parë të Republikës Beqir Kalia dhe një zbatim me kazma e baromina, me barut të nxjerrë nga fishekët trofe të Luftës së Dytë Botërore, nga njerëz që nuk dinin të frikeshin”

Kanali i Çidhnës, mjedisi natyror, është po ai i vitit 1967; i paprekur, i pa tjetërsuar, monument i natyrës dhe njeriut...

Ka vend të hidhet vështrimi mbi të...

Në shkrimin “Seta është monument historie dhe trimërie” shënoja:

“Në korrik të vitit 1967 uji i Setës vaditi për herë të parë tokat e Çidhnës për të vijuar në vitet më tej drejt Dardhës e Reçit nga njëra anë, me sifon drejt Sinës e po me sifon drejt Fushës së Çidhnës dhe Kastriotit deri në Vakuf në dhjetor 1969...

Edhe sot, po të kalosh anës kanalit të Setës, Gjalicave, rrugicës si fije peri që varet pas shkëmbinjve, pyet i habitur “Çfarë njerëzish kanë qenë ata që u varën në këto hone të thella, që çanë malin dhe krijuan këtë vepër ujore, këtë vepër arti me përmasa marramendëse?”

Në gazetën “Bashkimi” profesori i mirënjohur i gazetarisë HamitBorici më 30 gusht 1967 shkruante: “...Më 1 mars filloi puna. Uji në bazë të planit duhej tu jepej fshatarëve në vitin 1969, kurse ai filloi të rrjedhë 6 muaj pas fillimit të punimeve, pra dy vjet para afatit...Ishte planifikuar të punohej gjatë tre vjetëve, të hapeshin tre tunele, të punohej në 6 fronte pune. U punua 6 muaj, u hapën 13 tunele, u punua në 26 fronte pune njeri më i vështirë se tjetri...”

Në vjetarin statistikor 1966 të rrethit të Dibrës, vepër e ekonomistit të talentuar dibran Shemsi Hoxha shënohet:

“Kanali i Çidhnës... ka gjatësi 6 kilometra, midis të cilave 800 metra tunel në shkëmbin e Gjalicave. Vaditi për herë të parë në korrik 1967. Inaugurimi i ba më 24 gusht ...”

* * *

Kam kërkuar në një shkrim (Kthimi i Gjergj Gjon Kastriotit në vendlindje” që monumenti i Skënderbeut të vendoset në pikën dominuese që sheh dhe fsheh historinë e Dibrës.

Ndër të tjera shënoja:

“Mendimi im është që Gjergj Gjon Kastrioti të vendoset në Sukë të Arrasit, në atë kodër që i qëndron gjithë luginës së Dibrës si far. Aty, Gjergj Gjon Kastrioti - Skënderbeu duhet të vendoset në atë mënyrë që djathtas të ketë “Shëgjethin”, majtas “Çelinë”, poshtë “Fushën e Torviollit” dhe përpara Dibrën mbarë. Ai duhet ta vështrojë Lindjen si sfidë që i bëri asaj në të gjitha betejat. Pas ai duhet të ketë Malet e Dibrës, ato male që iu bënë mburojë e që luftuan deri në fëmijën e fundit pas vdekjes së tij, Çidhnën...

Piedestali i lartë dhe mjedisi rreth e qark krijojnë mundësinë e “shkrimeve” të tjera në art për bëmat e mëvonshme të dibranëve si “Kuvendi i Arrasit” dhe ngjarje të tjera të shumta historike të zonave për rreth. Një kompleks turistik, një restorant me ballkone që shohin malet me Korabin në krye dhe luginën e Drinit në të dy krahët, një restorant me “Troftë Sete”, pse jo edhe një qendër administrative të komunës, me një muze që mund të “shpërngulet” nga Sina, do të përbënin perlën turistike të historisë së Dibrës.

Më ka ndodhur që në vitet tetëdhjetë të jem ciceron i një grupi gazetarësh të huaj në udhëtimin e tyre tek Liqenet e Lurës, Kanali i Setës etj. Në Qafë të Arrasit kërkova të ndalojë autobusi i vogël turistik. I udhëhoqa gazetarët në shkallët e sajuara drejt majës, midis dy rreshtave të ngarkuar me kumbulla të pjekura, drejt Sukës së Arrasit. U befasuan nga pamja mbrëmësore me Drinin nën këmbë e Korabin mbi krye. Por, kur u tregova për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, vendlindjen dhe vend luftimet e tij fitimtare, kur për një çast i ktheva pesë shekuj më pas duke u thënë që t’i përfytyronin radhët e mollëve të Kastriotit dhe Ostushit dhe radhët e kumbullave të Shumbatit, si ushtarë në betejën e parë të Skënderbeut dhe në fitoren e parë historike të botës së asaj kohe mbi hordhinë osmane, befasia e tyre arriti kulmin. Aty, për të dytën herë atë ditë, pas pamjes së bukur tek Liqeni i Madh, pash një njeri të ulet në gjunjë e të lutet si para Zotit...

Vendosja e monumentit të Gjergj Gjon Kastriotit mbi Sukë të Arrasit mendoj se duhet parë edhe në një tjetër këndvështrim.Dibra ka një festë të vetën, një festë popullore me rrënjë pagane. Ajo festë ka emrin e Gjergjit, “Shën Gjergji”. Festohet gjithnjë më 6 maj.

A nuk do të ishte bukur që kjo festë të shpallej si “Festë Popullore e Dibrës” ashtu siç tashmë është shpallur (edhe si festë zyrtare) “Dita e Verës e Elbasanit”?

Vendi, por edhe pozicioni gjeografik, lejon veprimtari të bukura në natyrë. Lejon që aty të zhvillohet një garë e bukur blegtorale se kush do të sillte në konkurs “qengjin apo kecin më të madh”, një festival këngësh për pranverën nga fondi shumë i pasur folklorik i zonës, që nga Lura, Selishta e deri në Reç e Kala të Dodës.

* * *

Flitet shumë për agro-turizëm. Nuk ma merr mendja që të ketë ndonjë trevë shqiptare ku bujqësia dhe turizmi të jenë kaq pranë e kaq të lexueshëm se sa në Luginën e Drinit të Zi krahëhapur me “Nëntë Malet” në perëndim dhe me Korabin, Hynoskën e deri me Majën e Zylit në Gollobordë në lindje. Po të dijë ndokush ndonjë vend që e bashkon më mirë bujqësinë me turizmin, ndonjë vend agroturist, kuptohet pa mbytjen e Dibrës nga gjoli i frikshëm i Skavicës, le ta thotë.

* * *

Një “udhëtim” malli dhe dashurie nëpër trevën ku linda dhe u rrita, një “udhëtim” me shpirt, nga larg...

U çlodha, i dhashë shpresë vetes se një ditë dibranët do të kthehen në Dibër për ta nxjerrë “perlën” nga “guaska e moluskut” e për ta varë në gjerdanin e bukurisë dhe historisë së saj, qendër gjeografike e shqiptarëve...

Athinë, 31 mars 2017.

turizëm

Për shkak të lulëzimit ekonomik, pasurisë së banorëve dhe famës së mjeshtrave të ndërtimit në kohën e Perandorisë Osmane vlente proverbi: "Nëse digjet Stambolli, Dibra e ndërton".

Banjat dhe mali, *destinacionet turistike në rritje* **në Dibrën e Madhe**

Nga **SHUIP MARKU**

Rajoni i Dibrës gjendet në skaj të pjesës perëndimore të Republikës së Maqedonisë afër kufirit me Shqipërinë. Qyteti i Dibrës prej Shkupit është në largësi prej 131 km, dhe qytetet më të afërta janë Struga (52 km) dhe Gostivari (71 km). Me Rrugën e Arbrit Dibra e Madhe është larg vetëm 64 km.

Dokumenti i parë që e përmend Dibrën në hartën e Klaudij Ptolemej-it, të bërë rreth mesit të shekullit të dytë në të cilën emërohet *Deborus*. Perandori bizantin Vasili II kishte njohuri për Dibrën, përderisa Feliks Petançiq e quante këtë qytet *Dibri* në vitin 1502. Në fillim të shekullit 19 Dibra është ngritur në kryengritje kundër sulltanit turk, dhe në këtë periudhë siç e përshkruan një udhëpërshkrues francez, Dibra ka pasur 64 shitore dhe 4.200 banorë. Në fund të shekullit, qyteti ka pasur 15.500 banorë, por pas luftës së dytë botërore, ky numër është zvogëluar.

Gjatë shekujve 17-19 ishte shumë e zhvilluar shkolla Dibrane e drugdhendjes. Përfaqësuesit e saj kanë punuar shumë ikonstase në Maqedoni, Shqipëri, Bullgari, Serbi, dhe Rusi. Për shkak të lulëzimit ekonomik, pasurisë së banorëve dhe famës së mjeshtrave të ndërtimit në kohën e Perandorisë Osmane vlente proverbi: "Nëse digjet Stambolli, Dibra e ndërton".

PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT

Ekzistojnë shumë arsye pse njerëzit do të kishin vizituar këtë rajon sepse i njëjti shquhet me një numër të madh të karakteristikave siç janë: turizmi banjor, qendrat dimrore të skive dhe shumë mundësi të tjera për turizëm alternativ dhe rural:

Mundësi për zhvillimin e programeve të veçanta për alpinizëm, sportin e kajakut, turizmin shpellor , turizmin arkeologjik si dhe turizmin që është i lidhur me gjuetinë dhe peshkimin, vizitat e vendeve me monumente të rëndësishme arkitekturore dhe përmendoret kulturore, si edhe bukuritë natyrore që të lënë pa frymë – liqeni Lokuf, ujëvara Duf etj.

Duke marrë parasysh të gjitha këto arsye të shumta , zhvillimi i turizmit duhet të mirret parasysh nga një perspektivë më e gjerë, e cila do të përfshijë - një ose dy sektorët dominantë në turizëm, të tilla siç janë turizmi banjor dhe malor, por gjithashtu do të përfshijë shumë rekreacione dhe sporte shumë aktive të përmendura më herët.

Turizmi banjor është karakteristikë themelore e rajonit të Dibrës, që duhet të zgjerohet në grupe qëllimore të reja, të cilat praktikojnë të jenë të shëndetshëm dhe në mënyrë aktive të sportojnë si edhe me produktet të reja turistike në lidhje me diversitetin në sport - alpinizëm, sportin e kajakut, çiklizmit, fluturim në ajër etj.

Turizmi themelor malor si karakteristik për rajonin e Mavrovës për t'u plotësouar si turizëm rural i zhvilluar, i organizuar nëpërmjet takimeve dhe vizitave nga fshatrat përreth dhe të pasurohet me shijimin e produkte të ndryshme specifike për rajonin -prodhimi i djathit, verës dhe prodhimeve vendore artizanale.

Rajoni të ringjallet dhe me turizmin e lidhur me arkeologjinë, arkitekturën ose speleologjinë, e cila do të zhvillohet si një turizëm hulumtues ose edukativ, e lidhur me ekspedita shkencore ose vizita / ekskursione të lidhura me përvetësimin e njohurive dhe përvojës në disa nga këto degë të shkencës;



Ura e Kaprollit



Dasma e Galiçnikut

DASMA E GALIÇNIKUT

Galiçniku më së shumti njihet sipas zakoneve të Dasmës së Galiçnikut. Fshati është përfaqësues i drejtpërdrejtë i arkitekturës tradicionale, adeteve lokale, dhe traditave indigjene. Fakti se fshati është pjesë e parkut nacional "Mavrova" karakterizon veçanërinë e vet dhe kujdesin e meritуar të cilin e gëzon. Shtëpitë në këtë fshat janë të tipit të mbyllur, me organizim të thjeshtë të brendësisë, të ndërtuara me material lokal. Çardaku, element karakteristik i arkitekturës tradicionale maqedonase, është i pranishëm thuajse në secilën shtëpi dhe është i tipit të mbyllur.

> Turizmi banjor është karakteristikë themelore e rajonit të Dibrës, që duhet të zgjerohet në grupe qëllimore të reja, të cilat praktikojnë të jenë të shëndetshëm dhe në mënyrë aktive të sportojnë si edhe me produktet të reja turistike...

TAKIMET E REKËS SË EPËRME

"Takimet e Rekës së Epërme" janë veprimtari vjetore që realizohen në javën e parë të gushtit, kur janë të pranishëm mërgimtarëve që kthehen në vendlindje për pushimet verore. Veprimtaritë kanë të bëjnë me prezantimin e veshjeve tradicionale të Rekës, të traditave dhe zakoneve, lojërave populore, folklorit dhe ushqimeve tradicionale të kësaj ane, para vendasve dhe mysafirëve me prejardhje nga territoret e Rekës së Epërme dhe të tjerë. Për shkak të rrugës së keqe pjesëmarrja është e vogël, por vit pas viti numri i tyre është në rritje dhe me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, mund të kthehet në një destinacion turistik në të ardhmen.

HAMAMI I RI, DIBËR

Hamami i ri gjendet në qendër të qytetit të Dibrës. Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta se kur është ndërtuar objekti, por shpjegimet datojnë kah shekulli XVIII dhe rindërtimi i cili besohet të jetë realizuar në shekullin e XIX. Hamami sipas konceptit dhe funksionit i takon llojit të zhvilluar të hamamëve. Ky hamam është i njohur pas asaj se është hamami i vetëm në Maqedoni i cili i përmban elementet funksionale - sallë shadërvani, kapallëk, halvet, haznë dhe qulhan, dhe më gjatë ka funksionuar si hamam, deri në vitin 1992. Sot ky objekt është rikonstruktuar, i shëndrruar në galeri arti.



Foto nga takimet e Rekës së Epërme.



Hamami i ri, Dibër.

HAMAMI I VJETËR, DIBËR

Hamami i vjetër i Dibrës është monument kulturor në të cilin janë të dukshme vlerat stilistike dhe arkitekturore të stilit klasik të arkitekturës osmane. Konstrukti është prej mureve masive dhe kupolave të realizuara me gurë dhe tulla me material gëlqeror. Hamami i përmban të gjitha karakteristikat dhe hapësirat e nevojshme për funksionim.

I vendosur në pjesën qendrore të qytetit, Hamami i Vjetër në Dibër, edhe pse momentalisht i braktisur, i larguar prej vëmendjes, përsëri disponon me hapësira dhe energji të cilat mund të shendohen në rikapitulim të vlerave tradicionale dhe ringjalljen e Hamameve.

URA E KAPROLLIT

Është ndërtuar prej kohës së perandorisë Osmane. Me të janë lidhur shumë legjenda e mite, prej të cilave më interesante është ajo kur një aga turk ka dashur të gjuaj një kaproll, i cili tek popullata e atëhershme njihej për shkathtësinë, zgjuarsinë dhe fuqinë, dhe vazhdimisht u ka ikur gjahtarëve. Gjatë një ndjekjeje kaprolli ishte plagosur dhe i shtyrë në një situatë pa rrugëdalje, pra në vendin ku është ndërtuar ura më vonë. Në bregun e lumit të Gajres ai e ka bërë të pamundurën dhe ka arritur ta kapërcejë lumin edhe pse ka qenë i lodhur, dhe me plagë të thellë, e pastaj ka ngordhur. I mahnitur prej guximit të kaprollit dhe këmbënguljes së kaprollit që të luftojë për lirinë e vet deri në fund, beu urdhëroi që për nder të tij të ndërtojë urën, e cila në të ardhmen do të simbolizojë guximin, nderin, forcën dhe luftën që duhet të vazhdohet deri në frymën e fundit. Interesante është që ky monument i kulturës, është se ai është ndërtuar në vendin ku ka kaluar Via Ignatia.

UJËVARA E DUFIT

Ujëvara e Dufit gjendet në rrënzën e Malit të Radostushës, 20 minuta në këmbë prej qendrës së fshatit Radostushë, në lartësi mbidetare rreth 1500 metra.

Ujëvara është vepër e natyrës, që është krijuar prej ujrave të Lumit të madh dhe Lumit të Vogël, të cilat rrjedhin në vendin që është 2 km para rrugës. Në shkëmbinjtë nëpër kanjon ka edhe njëzet shpella të tjera më të vogla e më të mëdha. Dimrit kjo ujëvarë ngrin dhe kriojn një fenomen interesant. Për shkak të kondenzimit të lagështisë, këtu krijohet fenomeni i pikave të ujit, dhe krijohet përshtypja sikur bie shi.



Grupi i Dibrës në Tuz, 2009. Foto: © Abdurahim Ashiku

Muzika dibrane në buzë të humnerës

Nga **ALBAN TUFA**

Vetë pozita gjeografike e krahinës së Dibrës, kufizuar nga Kukësi, Mati, Tetova, Librazhdi, Tirana, Elbasani dhe Mirdita, ka bërë që muzika dhe tradita në tërësi të jetë unike në veten e vet. Muzika popullore dibrane u kultivuar më shumti nëpër dasma dhe konaqe burrash e grash. Vargjet ose ishin të krijuara nga populli ose nuk iu gjendej autori dhe i mbetej sërisht popullit. Veglat muzikore tipike të Dibrës janë kryesisht çiftelia, fyelli, surleja, gajdeja, lahuta, daulleja dhe klarineta (së fundmi).

E gjitha kjo u kultivua fillimish nga ajo popullatë që i deshi, i mësoi dhe i trashëgoi në breza të tërë. Çiftelia shpesh herë u përdor jo vetëm për gëzime por edhe në çaste mërzitjeje ku rapsodi qante hallet me të, po kështu edhe lahuta e gajdeja. Muzika qe i vetmi argëtim ku dibranët ushqyen shpirtin artistik të tyre. Me aheng bënë dasmat, me aheng kaluan mbrëmjet dhe pasdarkat. Me aheng e muhabet i shtynë mendimet largë halleve e brengave që patën.

Pastaj kjo kulturë dhe pasuri gojore e shpirtërore u kalua tek një grup profesionistësh që nisi tek Haziz Ndreu dhe soset tek Dritan Jashari, duke përmend kështu në mesin e tyre Qerim Sulën, Saje Poleshin, Lirie Rashën, Vera Laçin, Arif Vladin, Sherif Dervishin, Myfterim Kupën, etj. Ky qe një brez që e çoi në stadet më të larta që pa muzika Dibrane ndonjëherë. Ndërsa sot jo vetëm muzika popullore dibrane por e gjithë tradita etno-kulturore në vendin tonë është dridhë në themel.

Të rinjtë nuk e duan më muzikën "e vjetër" dhe po shkëputen tërësisht nga ajo. Kompozitori dibran Përparim Tomçini thotë: "Unë kam një shtëpi në katund, dhe shtëpia kur s'ka njeri brenda, shembet. Kështu e ka muzika dhe folklori në tërësi".

Ky brez që përmendem më sipër po shuhet, sepse mosha bën të vetën. Brezat ndërrohen dhe qasja është e tillë: modernizim, larg traditës. Tomçini thotë: " Potenciale kemi, por kur bëjmë një aktivitet, këngëtarë janë amatorë. Këto amatorë vështirë ta këndojë këngën dibrane sepse këndojnë tallava nëpër dasma. Kemi pas arritje, por duhet të ruhet nga shteti. Sepse pjesa dërrmuese e këngëtarëve dibranë kanë bërë kurse 9-mujore për kanto. Nëse sot mbaron dikush një shkollë muzike nuk kthehet në Dibër sepse nuk paguhet".

Kompozitori shpreh shqetësimet e tij për kulturën shqiptare në përgjithësi dhe atë dibrane veçanti. "Edhe me dasht me e mbledh folklorin është e vështirë se nuk

> PËRPARIM TOMÇINI: "Unë kam një shtëpi në katund dhe shtëpia kur s'ka njeri brenda, shembet. Kështu e ka muzika dhe folklori në tërësi".

ka njerëz. Unë Peshkopi e kam të vështirë të gjej njerëz që i bien çiftelisë sepse kanë marr hov pas instrumentave elektronike." thotë ai.

Instrumenti i parë që u humb nga duart e zonës sonë qe lahuta e cila nuk u përdor më pas viteve '80. Ndërsa në ditët e sotme nuk gjendet asnjë instrumentist dibran për gajde, edhe pse është i vetmi instrument që përdoret në vetëm në Skoci dhe Ballkan.

Bashkë me këto vegla ka humbur edhe polifonia e veriut, ose më sakt ajo dibrane. Dy këngë polifonike kam regjistruat, shprehet Tomçini, por më tej nuk bëj më shumë sepse kanë kosto.

I pyetur se nëse do të ishte e nevojshme të mbaheshin konkurse dhe festivale të njësive adminstrative, kompozitori përgjigjet:" Do ishte gje e bukur nese do behej festivali i njësive administrative, por ka një gjë sepse edhe Festivali i Gjirokastrës bëhet sipas ndarjeve administrative. D.m.th, Dibra nuk ka asnjë lidhje me Matin dhe Bulqiza i përket trevës së Dibrës (nënkupton që prezantimi si një grup me Matin është gabim). Treva folklorike e Dibrës ka edhe Mavrovën, Dibrëm e Madhe dhe Dibra si e tillë është coptuar, treva më e coptuar në republikë."

Të flasësh me Përparim Tomçinin për muzikën dhe këngën dibrane, nuk të ka hije të mos e pyesësh për Naim Plakun, poetin e këngës Dibrane. " Unë e kam të vështirë të gjej si Naimi Plaku, ndoshta ka, ama une me Naimin ishim nje. Kam pas bashkëpunime dhe me Gjokë Becin, por jo si me Naimin. Ai e njihte Dibrën dhe traditën dibrane.

Të rinjtë dibranë nuk dinë sa duhet për etnokulturën e tyre. Fajtorët janë shumë, duke nisur nga vetja, mos gjetja mundësive, dhe neglizhenca e institucioneve përkatëse. Globalizimi edhe këtu bëhet një pikë e fortë rëndese. Këtë shohim që nga futja e rrymave të ndryshme nga jashtë, por edhe me harrën e gjërave tona. Kudo vërejmë të rinj që i dinë këngët e huaja përmendësh, ndërsa si identitet të tyre nuk kanë asgjë. Doket zbehen, tradita nuk respektohet, ndërgjegjja jonë kombëtare sa vjen e dobësohet.

Shaban Sinani, personalitet i veçantë në letrat shqipe

Akademik **ALI ALIU***
Nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Mbështetur në konkursin e shpallur nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë për kandidatë të rinj me status akademik i asociuar, nga lëmia e antropologjisë, duke e njohur punën shumëvjeçare dhe tejet frytdhënëse, rezultatet më se të vlerësuara në një fushëveprimtari mjaft të gjerë të interesimeve dhe të studimeve të tij, kam kënaqësi të përkrah kandidaturën e Shaban Sinanit për t'u zgjedhur anëtar i asociuar i institucionit më të lartë të shkencave dhe të dijeve të Shqipërisë, me bindje të thellë se bëhet fjalë për një personalitet të veçantë në letrat shqipe, që meriton të jetë pjesë e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Shaban Sinani, sot sekretar shkencor pranë Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ka një karrierë të gjatë shkencore, gati 35 vjeçare, të nisur rreth viteve 1982-83, në fushat e studimit të letrave dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Pothuaj që nga fillimet e tij ai tërhoqi vëmendjen e studiuesve të gjuhësisë, letërsisë, kulturës popullore apo antropologjisë kulturore, me seriozitetin, thellësinë e mendimit, argumentimeve shkencore, zellin dhe përkushtimin për mbledhjen e materialeve arkivore, analizën dhe studimin e tyre dhe seriozitetin në trajtimin e çështjeve që kishte marrë në shqyrtim. Veçanërisht spikasin kontributet e tij nga lëmi i studimeve antropologjike, të mbështetura në studimet arkivore brenda e jashtë Shqipërisë dhe në përvojën e thellë të këtyre studimeve.

Duke nisur veprimtarinë e tij shkencore me një studim gjuhësor për *Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe*, ai, do të orientohet mbi të gjitha nga filozofia dhe antropologjia duke mbrojtur më 1998 dhe tezën e doktoraturës nga fusha e antropologjisë: *Mitologji në eposin e kreshnikëve,* fushë e interesimit të veçantë që do të pasohet, më vonë, jo vetëm me tri monografitë që ndeshim në bibliografinë e tij, por edhe me një varg studimesh të tjera dhe aktivitetesh të veçanta mbi këta interesime.

E kam ndjekur që nga fillimi veprimtarinë e tij shkencore dhe mund të them me plot bindje se përkundër gjerësisë së interesimeve, një aktiviteti të dendur, që dëshmohet nga bibliografia tejet e pasur - janë mbi tridhjetë tituj librash, studimesh, përmbledhje esesh e artikujsh, monografi, studime letrare, antropologjike, që e venë atë në radhën e studiuesve që kanë zgjeruar diapazonin duke u mbështetur te letërsia, te historia e letërsisë shqiptare mbi të gjitha, te mitet e legjendat, personalitetet e veçanta të letërsiosë (Kadare, Camaj...), deri tek studimet dhe hulumtimet për Kosovën, për historinë e hebrenjve në Shqipëri, etj., Shaban Sinani është aktiv edhe në fusha të tjera të veprimtarisë shkencore e kulturore duke u gjendur shpesh me detyra me rëndësi, duke drejtuar projekte shkencore, qeveritare e ndërqeveritare, duke hartuar programe studimi, universitare e pasuniversitare, duke mbajtur ligjërata si profesor i ftuar, në kurse javore, por edhe semestrale e vjetore, duke drejtuar studime të shkallës së doktoraturës në shumicën e universiteteve brenda Shqipërisë, por edhe jashtë Shqipërisë (Mynih, Pekin, Palermo, Shkup, Tetovë, etj.), dhe duke marrë pjesë, njëkohësisht, në konferenca shkencore jashtë vendit, me kumtesa në disa gjuhë botërore. Siç shihet nga bibliografia, një pjesë e librave të tij janë botuar në gjuhë botërore dhe kanë nxitur interesin e lexuesve dhe studiuesve edhe jashtë kufinjve të Shqipërisë. Po shënoj këtu vetëm listën e botimeve të librave, pa përmendur artikujt e shumtë, studimet dhe kontributet tjera të shpërndara në revista e periodikë në vend dhe jashtë, në përmbledhje dhe dokumente të tjera të aktiviteteve të ndryshme shkencore:

> **Pothuaj që nga fillimet e tij ai tërhoqi vëmendjen e studiuesve të gjuhësisë, letërsisë, kulturës popullore apo antropologjisë kulturore, me seriozitetin, thellësinë e mendimit, argumentimeve shkencore, zellin dhe përkushtimin për mbledhjen e materialeve arkivore, analizën dhe studimin e tyre dhe seriozitetin në trajtimin e çështjeve që kishte marrë në shqyrtim. Veçanërisht spikasin kontributet e tij nga lëmi i studimeve antropologjike, të mbështetura në studimet arkivore brenda e jashtë Shqipërisë dhe në përvojën e thellë të këtyre studimeve.**

> **Shaban Sinani është anëtar i grupit propozues që Eposi i Kreshnikëve të vihet në mbrojtje të UNESCO-s, që u mbështet edhe nga Qeveria e Kosovës.**

Mitologji në eposin e kreshnikëve, (2009, 2015), *Shqiptarët dhe hebrenjtë,* (2014), *Albanian and jeës,* (2015), *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës",* (2011) *Kodikët kronografikë të Shqipërisë,* (2014), *Për prozën e Kadaresë,* (2009), *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të,* (2010, 2015), *Midis dy Rilindjesh,* (2010), *Etnos në epos*, (2011), *Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K.",* (2011), *Camaj i paskajuar,* (2011), *Tradita gojore si etnotekst,* (2012), *"Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit,* (2012), *Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe,* (2013), *Pyetje në albanologji: autorë dhe teza,* (2013), *Berati, Beratinus, Buhara,* (2015), *Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura,* (2015), *Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë,* (2016), *Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi,* (2009), *Një dosje për Kadarenë,* (2005), *Le Dossier Kadaré,* (2006), *Beratinus, antropologji kulturore,* (2004), *Kosova në gjeopolitikë, publicistikë,* (1999), *Kosova në syrin e ciklonit, publicistikë,* (1999), *Përveçime,* (2007), *Pengu i moskuptimit,* (1997), *Një Shqipëri tjetër, publicistikë,* (2006), *Prurje kulturore orientale,* (2007), *Kështjella e virtytit, antropologji kulturore* (2001), *Ura dhe kështjella,* (2006), *Sipërore,* (1998).

Si anëtar dhe nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës kam qenë dëshmitar i shumë paraqitjeve përmbajtjesore të Shaban Sinanit në aktivitetet shkencore të organizuara nga ASHAK, konferenca dhe tryeza shkencore, pastaj në botimet tona, në revistën *Studime* si dhe në aktivitete të tjera të organizuara nga Universiteti i Prishtinës dhe Instituti Albanologjik në Prishtinë. Shaban Sinani është anëtar i grupit propozues që Eposi i Kreshnikëve të vihet në mbrojtje të UNESCO-s, që u mbështet edhe nga Qeveria e Kosovës. Efekti i punës dhe angazhimit të tij është parë edhe së fundmi, në periudhën prej kur është zgjedhur sekretar shkencor i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, në organizimin e shumë aktiviteteve të përbashkëta shkencore midis dy akademive.

Nga të gjitha këto që u përmendën më lart dhe nga bindja se kontributi i tij si anëtar i ASHSH do të jetë më se i nevojshëm dhe dobiprurës në veprimtarinë e mëtejme të këtij Institucioni, mbështetur në rezultatet e punës së tij shumëvjeçare shkencore dhe rezultatet më se të vlerësuara, e përkrah ngrohtësisht kandidaturën e prof. dr. Shaban Sinani për anëtar të asociuar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga fusha e studimeve antropologjike.

** Titulli është i redaksisë. Ky shkrim është hartuar si Letër rekomandimi në mbështetje të kandidaturës së Shaban Sinanit për zgjedhjen akademik i asociuar nga fusha e antropologjisë kulturore.*

cyan magenta yelloë black



© Foto: Bujar Karoshi

Rruga në ngjitje e një Akademiku*

Nga **Prof. dr. ALI XHIKU**

Rruga e formimit dhe e vetëformimit të z. Shaban Sinani si studiues ka nisur prej 35 vjetësh dhe veprimtaria e tij në fushë të kërkimit dhe të letrave shqipe nuk është ndërprerë asnjëherë.

Njohja e drejtpërdrejtë, në funksionin e drejtorit të ish-Institutit të Kulturës Popullore, më lejon të pohoj se, pas një procesi të ndërlikuar formimi pasuniversitar, në të cilin u ndërthurën *gjuhësia*, *gazetaria* dhe *filozofia*, z. Shaban Sinani kreu studimin bazë të profilit të tij shkencor, në fushën e antropologjisë kulturore, me titull *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, e cila u mbrojt si tezë doktorate në vitin 1998. Si anëtar i jurisë dhe oponent i këtij punimi, i cili që nga viti 2000 është ribotuar katër herë, pohoj se vlerësimi prej jurisë qe maksimal (100 pikë). Kandidati Shaban Sinani i vijoi kërkimet në këtë fushë me studime të tjera monografike të thelluara, si *Etnos në epos* dhe *Tradita gojore si etnotekst*. Dy përmbledhje të tjera studimesh, *Kështjella e virtytit* dhe *Ura dhe kështjella*, plotësojnë kërkimet e tij antropologjike.

Studimet antropologjike e ndërdisiplinare të z. Sha ban Sinani u inkurajuan sidomos gjatë periudhës kur ai drejtonte arkivat kombëtare, në dy fusha themelore me karakter ndërdisiplinor:

E para, **t**radita e dorëshkrimeve dhe e shkrimeve që i takojnë trashëgimisë arkivistike shqiptare, *kodikëve filologjikë dhe kronografikë*, parë në kontekstin e traditës botërore të shkrimeve, që gjejnë shprehje në tre studime monografike: *Beratinus*, *Kodikët e Shqipërisë në 'Kujtesën e Botës'* dhe *Kodikët kronografikë të Shqipërisë*. Këtyre kontributeve u bashkohen edhe: paraqitja e dy kodikëve më të hershëm të Shqipërisë në ekspozitën botërore *I Vangeli dei Popoli*; regjistrimi i tyre në programin e UNESCO-s *Memoire du Monde*; përgatitja për botim si kryeredaktor i veprës shkencore të ilustruar *Kodikët e Shqipërisë* dhe së fundmi libri *Berat, Beratinus, Buhara*. Këto kontribute janë recensionuar në disa vende europiane dhe janë tashmë referenciale për studimet kodikografike. Shaban Sinani është gjithashtu skenarist i filmit dokumentar *Beratinus*, fitues i çmimit *Madona e Argjendtë* në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit.

Fusha e dytë e studimeve antropologjike të lidhur me të parën, që z. Shaban Sinani realizoi mbështetur në kërkimet arkivistike brenda dhe jashtë vendit, lidhet me *sjelljen etnotipike shqiptare ndaj të huajve* dhe në radhë të parë ndaj hebrenjve. Ai është bashkëhartues i *Ligjit për Ditën e Kujtesës*; si dhe organizator i disa konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare për mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri. Pasi përgatiti vëllimin me studime *Prania historike dhe shpëtimi i hebrenjve gjatë Luftës: (studime e dokumente)*, z. Shaban Sinani botoi si autor i vetëm dy studime monografike me këtë problematikë: *Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi* dhe *Shqiptarët dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi*. Libri i dytë, me interesimin e shoqatës më të madhe hebreo-amerikane AIPAC, është përkthyer e botuar anglisht, me titullin *Albanians and Jews: The Protection and Salvation*. Studimet në dy fushat e mësipërme, që mund të konsiderohen të shndërruara prej tij në përparësi kërkimore për shkencën shqiptare, duke kapërcyer prej një niveli vullnetarizmi shkencor që ishte trashëguar, janë cilësuar jo vetëm si kontribute për përurimin ndërkombëtar të atyre pasurive që me të drejtë janë quajtur *albanizma*, por dhe si ndihmesa në dijen europiane rreth tyre.

Me këto fusha lidhen edhe kërkimet e z. Shaban Sinani në burimet arkivore për certifikimin e rrugës së letërsisë në një periudhën e ideokracisë të kontrollit ideologjik. Këtu veçojmë studimet e tij monografike shoqëruar me burime parësore *Një dosje për Kadarenë* (I-II), *Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K"*. Libri i tij me studime e dokumente për raportet e I. Kadaresë me pushtetet dhe ideologjinë është botuar dy herë në Francë me titullin *Le Dossier Kadaré*. Libri është recensionuar në shumicën e vendeve europiane.

Kontributi i z. Shaban Sinani në fushën e *historisë së letërsisë*, siç është vërejtur nga kritika, ruan pikëvështrimin antropologjik. Ai është autor i pesë monografive, për katër prej shkrimtarëve më të rëndësishëm të historisë së letërsisë shqipe: Ismail Kadare (*Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë*); Dritëro Agolli (*'Njerëzit e krisur' të Dritëro Agollit*); Martin Camajt (*Camaj i paskajuar*) dhe Jeronim de Rada (*Hieronimi: në botën arbëreshe*). Kandidati, z. Shaban Sinani, ka përfunduar gjithashtu një studim monografik për Migjenin (*Teksti biblik në veprën e Migjenit*). Përveçse tentime rezultative për të verifikuar statusin e këtyre shkrimtarëve në kushtet e hapjes së historisë së letërsisë, pas shthurjes së hierarkive të trashëguara, z. Sinani ka parashtruar mendime dhe teza me interes për riperiodizimin e historisë së letërsisë kombëtare. Këtyre kontributeve u bashkohen edhe përmbledhjet me studime: *Pengu i moskuptimit*, *Sipërore*, *Përveçime*, *Prurje kulturore orientale*, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, *Midis dy Rilindjesh*, *Pyetje në albanologji*, si dhe *Historia e letërsisë: çështje të hapura*.

Shaban Sinani ka gjithashtu botime të posaçme për Kosovën (*Kosova në gjeopolitikë, Kosova në syrin e ciklonit, Kosova në vështrim enciklopedik*).

Gjithashtu ka përgatitur tetë botime shkencore dhe antologjike. Ai është skenarist i mbi 10 filmave dokumentarë.

Shaban Sinani ka drejtuar projekte ndërshtetërore, ndërqeveritare dhe ndërinstitucionale. Ai ka kumtuar në disa gjuhë të huaja (italisht, frëngjisht, anglisht) në konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara nga institucione akademike-universitare në: Romë, Bari, Napoli, Kozencë, Palermo, Athinë, Sofje, Ankara, Cetinjë, Sofje, Vjenë, Varshavë, Poznanj, Pekin, Ningbo, Tetovë, Shkup, Prishtinë. Ka qenë pedagog i ftuar për kurse leksionesh vjetore e semestrale në Mynih, Pekin e Tetovë, si dhe për kurse intensive leksionesh në Palermo e Poznanj. Ai është hartues dhe drejtues programesh universitare në shkallës së masterit dhe doktoratës.

** Titulli është i redaksisë*

Shaban Sinani është kontributori kryesor për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e vlerave kulturore dhe morale të kombit shqiptar përmes tre projekteve të mëdha shkencore, të certifikuara ndërkombëtarisht: pranimi, ruajtja dhe shpëtimi i hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri; ideimi, hartimi dhe dorëzimi i dosjes për t'i shpallur Kodikët e Beratit si "pasuri botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s; dhe, së treti, ideimi, hartimi dhe depozitimi (bashkë me prof. Zymer Neziri) të dosjes për "Këngët e kreshnikëve", eposin e Veriut në UNESCO.

Dritëro Agolli:
"Njeriut që i peshon më shumë truri se trupi"

Shaban Sinani, lindur më 16 prill 1958, në Ndërshen, një nga fshatrat e Lurës piktoreske të Dibrës, është një nga njerëzit dhe studiuesit e rrallë të kulturës dhe shkencës shqiptare. Për të janë bërë plot vlerësime dhe karakterizime, por mund të veçohen tri prej tyre.

I pari është vlerësimi i prof. **Shaban Demiraj**, gjuhëtar e albanolog i njohur, për shumë vjet shef i katedrës së gjuhësisë në universitetin e Tiranës. Duke e njohur studentin e tij, prof. Demiraj kërkoi me ngulm që Sh. Sinani të emërohej menjëherë pas përfundimit të studimeve si pedagog në këtë katedër. Por, ndërkohë Sh. Sinanin e kërkonte edhe gazeta me e madhe e asaj kohe, "Zëri i popullit", madje, kryeredaktori i saj, Arshin Xhezo, kishte firmosur edhe emërimin. Ky rivalitet institucionesh vazhdoi disa kohë derisa çështja shkoi tek kreu i shtetit, Ramis Alia. Kjo është një histori e gjatë që Shabani e tregon mjaft bukur në librin *"Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe"*, libër që i kushtohet pikërisht profesorit të njohur me dedikimin prekës: *"Prof. Shaban Demirajt të parit - pas prindërve të mi - që besoi në punën time, me mirënjohje, Ia kushtoj"*. Ky libër nuk ishte veçse tema e diplomës e studentit që kishte befasuar profesorin në vitin e largët 1983, por që do të botohej si libër pas 30 vjetësh.

Vlerësimi i dytë, edhe ky i bërë shumë vite më parë, është nga **Dritëro Agolli**, i cili duke ndjekur shkrimet e Shaban Sinanit, por edhe duke e njohur nga afër në biseda këtë djalosh të imët e trupvogël do të shprehej në stilin e tij: *"Këtij njeriu i peshon më shumë truri se trupi"*.

Edhe vlerësimi i tretë i takon asaj kohe kur Shaban Sinani nuk kishte bërë akoma "një krah me libra". **Teodor Keko**, poet dhe moshatar, shok fakulteti, do të shkruante e botonte asaj kohe një poezi që e profetizonte Shaban Sinanin si anëtar të Akademisë së Shkencave: *"Akademia me siguri Shabanin do e marrë"*. Dhe Shaban Sinani, më 6 mars 2017, përmes një votimi të fshehtë u përzgjodh me shumicën e votave që në raundin e parë si anëtar i Akademisë së Shkencave. Ndonëse me shumë vonesë, autori i më shumë së 30 veprave shkencore albanologjike, zuri vendin e merituar. Dhe nuk është një vlerësim dhe nder që iu bë atij, por, siç e cilësuan shumë personalitete albanologjike kur morën vesh lajmin, Akademia u nderua dhe fitoi prestigj. Si rrallë kush, për të mos thënë askush, nuk mund të krahasohet me kontributin e Shaban Sinanit në studimet dhe aksionet madhore albanologjike. Shaban Sinani është kontributori kryesor për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e vlerave kulturore dhe morale të kombit shqiptar përmes tre projekteve të mëdha shkencore, të certifikuara ndërkombëtarisht: pranimi, ruajtja dhe shpëtimi i hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri; ideimi, hartimi dhe dorëzimi i dosjes për t'i shpallur Kodikët e Beratit si "pasuri botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s; dhe, së treti, ideimi, hartimi dhe depozitimi (bashkë me prof. Zymer Neziri) i dosjes për "Këngët e kreshnikëve", eposin e Veriut në UNESCO, projekt që mori çmimin special "Europa Nostra" të BE, si projekti më i mirë shkencor për trashëgimi popullore.

Naim Zoto
31 mars 2017

Rruga e Arbërit nr. 131

opinion

Historia e stërzgjatur e Rrugës së Arbërit u kthye në një legjendë që lidhet me besën për ta ndërtuar atë. A nuk i është premtuar prej njëzet vitesh Popullit të Dibrës dhe të tjerëve se Rruga e Arbërit do t'i sillej Popullit nga Qeveritë/ Deri tani, asnjë Qeveri nuk e ka mbajtur besën, ndonëse Populli ia ka kërkuar vazhdimisht me lotët dhe me zjarrin e shpirtit.

Kostandini e Doruntina dhe legjenda e Rrugës së Arbërit

Dr. **Astrit GJUNKSHI**

Në dalje të Tiranës, paksa poshtë varrezave të Tufinës, qëndron një tabelë rrugore me emërtimin "Rruga e Arbërit". Këtu e ka zanafillën kjo rrugë, ndërtimi i së cilës është kthyer ne legjendë. Dhe, si padashur, të shkon mendja tek nje legjendë tjetër e lashtë që lidhet me varrezat, siç është legjenda "Kostandini dhe Doruntina". Në mënyrë të beftë, mendja fillon të punojë e të përqasë këto dy legjenda me analogjitë dhe ndryshimet e tyre.

Legjenda e lashtë ka në themel mbajtjen e besës. Ajo thotë se, kur Doruntinën me 12 vëllezër e kërkoi për nuse një princ i huaj, i cii e kishte mbretërinë "nëntë male kaptuar", ishte Kostandini që i mbushi mendjen së ëmës që kjo martesë të bëhej, duke i dhënë besën se do t'ia sillte të bijën pranë sa herë që ajo do ta kërkonte. Por, të tërë vëllezërit u vranë në luftë bashkë me Kostandinin.

Nëna e tyre e moshuar, që i kishte mbetur gjallë vetëm e bija, shkoi tek varret e djemve të saj dhe ndezi nga një qiri, ndërsa mbi varrin e Kostandinit ndezi dy qirinj dhe derdhi lot, sepse ishte ai që i kishte dhënë besën se do t'ia sillte vajzën kurdo që do ta kërkonte. Legjenda i përket periudhës kur njerëzit e shikonin trupin dhe shpirtin në unitet si dy elementë bazë të ekzistencës dhe krijimit të individit në familje dhe në shoqëri, dhe spjegimi është se Kostandini u ngrit nga varri sapo shpirti i tij dëgjoi vajtimin dhe trupi ndjeu lotin e nënës. Më tej, dihet se ai shkoi dhe mori të motrën dhe ia solli të ëmës.

Për analogji, edhe historia e stërzgjatur e Rrugës së Arbërit u kthye në një legjendë që lidhet me besën për ta ndërtuar atë. Elementët e analogjisë mund të shihen qartë. Kështu, a nuk i është premtuar prej njëzet vitesh Popullit të Dibrës dhe të tjerëve (ashtu siç iu premtua Nënës së legjendës) se Rruga e Arbërit (Doruntina) do t'i sillej Popullit nga Qeveritë/Politika (alias Kostandini)? Por, deri tani, asnjë Qeveri nuk e ka mbajtur besën, ndonëse Populli (Nëna) ia ka kërkuar vazhdimisht me lotët dhe me zjarrin e shpirtit.

Siç duket, shpirti dhe trupi i Politikës nuk janë më të lidhur si dikur ishin aq të lidhura tek Kostandini dhe njerëzit e dikurshëm të besës. Qeveritë, Politika duket se kanë shpirt të tjetërsuar që nuk u bën më përshtypje as loti i vuajtjeve dhe nevojave të Popullit.

Me sa duket, Konstandinët e sotëm të Politikës janë gati të krijojnë një legjendë që është në antitezë të plotë me legjendën e lashtë: ata janë gati të bëjnë çdo gjë që të rrojnë vetë së më gjatë në karriget e tyre, madje duke varrosur edhe motrën e tyre Doruntinën- Rrugën e Arbërit, pikërisht aty ku ajo fillon, në Tufinë!

Tiranë, më 28 mars 2017

Të shkosh për Dibër, t'i biesh nga Kina

Më ka rënë rasti që t'i bie Europës qosh e'm qosh dhe kjo, jo për turizëm. Edhe pse si kurbetqar i mbaj mend mirë të gjitha udhëtimet e mia, me tren, avion dhe më së shumti ato me autobuz. Normal kanë qenë të lodhme nga pagjumësia ose edhe nga sikleti se ç'të sjell e nesërmja. Në gjithë këto ekseperienca e them qartësisht se udhëtimi im më lodhshëm është nga Tirana në Dibër ose anasjelltas, hiq këtu edhe faktin se të pret ëmbëlsia e vendit dhe e familjes. Tash dikush mund të thotë se ne i ke ra m'këmbë deri në Greqi, ama sot po flasim për epokën e zhvillimi dhe bum-it të madh teknologjik.

Tri gjëra absurde e shoqërojnë udhëtimin në rrugicat Tiranë-Dibër dhe anasjelltas. Do ja nis fillimisht pa një rend kronologjik apo sasior, sepse edhe pse jemi në gjendje ta dallojmë absurdin, nuk mundemi ta masim shkallën e tij. E përderisa të jemi në gjendje të mos e bëjmë këtë, le të presim çuditë e radhës.

Kur rrugëton për në Dibër duhet së pari të pish (siç e quajnë rëmdom) "kokërr për avion". Që nga emërtimi del qartë absurdi. Të pish kokërr avioni, sepse po udhëton me furgon në një gjatësi 180 km është një shkallë e thekur absurdi që për dibranët është e gjithpranuar dhe sigurisht e domosdoshme. Unë vetë ua blej prindërve sa herë më duhet t'i përcjell tek furgonat. Duke mos iu mjaftuar ilaçet që pinë për sëmundjet e tyre përkatëse, duhet të marrin edhe doza për të mos i zënë avioni. Sapo të hipësh e të zësh vend fillon refreni i burrave dhe grave me njëri-tjetrin: "A ke pi kokërr?", "Shoferi a ka qese?" Nëpër Europë nuk e pash askund këtë akt fisnik kundrejt vetes. Nuk e kam parë as për në Vlorë, Sarandë dhe asnjë vend tjetër të Shqipërisë. Por kjo është qasja jonë ose më saktë protesat kundrejt vetes për legjendën mitike të së ardhmes, Rruga e Arbërit. Falenderojmë me këtë rast farmacistët të cilët akoma e mbajnë si produkt "kokrrën e avionit" që e pijmë ne të furgonave.

Kur rrugëton për në Dibër duhet së pari të pish (siç e quajnë rëmdom) "kokërr për avion". Që nga emërtimi del qartë absurdi. Të pish kokërr avioni, sepse po udhëton me furgon në një gjatësi 180 km është një shkallë e thekur absurdi që për dibranët është e gjithpranuar dhe sigurisht e domosdoshme.

E pakuptimta tjetër që më përshtyp sa herë e bëj këtë rrugë është se, nuk ka rëndësi nëse nisesh në orën katër të mëngjesit apo në tre të pasdites, taksativisht do të ndalesh në Klos të hash drekë (të shumtën e rasteve pilaf).

Pra, edhe nëse ke ngrënë pak para se të nisesh për rrugë, në Klos, do hash me patjetër, sepse tronditjet që ka pësuar stomaku yt, ta ka tret ushqimin si dhallë në m'ti, ose në rastin më të keq, ushqimin e ke hedhë me qese nga dritarja e furgonit.

Kështu, udhëtimi yt i gëzueshëm, të kthehet në mërzi e madej në një betejë jete a vdekje me kthesat jo rrallëherë mëse 90 gradë. Qafa të zë muskuj të rinj dhe herë-herë harron të të dhembë.

Ndërsa e pakuptimta e tretë (e përmasave relativisht të mëdha) është se kohët e fundit, edhe shoferët, duke qenë se iu ngjajnë të parëve tanë, "kanë zënë t'i bien nga Kina". Në konaqet tona burrat i bien llafit nga Kina, dmth i bien muhabetit rrotull, tuj ardhe e tuj e gushtu rrethin. Alamet shembulli kanë marrë dhe furgobat, i bien nga Kina (Rrësheni). Kjo gjë i ndodh vetëm vendit tonë në të gjithë Kontinentin e Vjetër. Pra, s'e ka kush guximin të thotë se ne s'jemi të veçantë, edhe po ta kishte, do ia kishte fut "s'i kau pelës".

Ekziston edhe një mënyrë tjetër, me i ra nga Bangladeshi (Kukësi), por edhe pse rruga është tepër e rehatshme deri në Bangladesh, kthimi pastaj është tmerr i vërtetë, kështu që kostot janë të papërballueshme. Le t'i biem nga Kina, sepse i kemi pas marrëdhëniet e shëndetshme në epokën e akullit.

E teksa ndodhin këto, në sfond do të kesh këngë që të këpusin shpirtin: tallava dhe hip-hop. Ndërsa këto të fundit dikush i do me zë të ulët, dikush me zë më të lartë. Dikush do xhamin e mbyllur, dikush do kondicionerin e ndezur. Mandej dikush e përdor furgonin për konak dhe fillon e hedh llaf për sendilen prapa, nga sendilja e parë vjen kushtrim i një llafi me peshë, kështu që e gjitha në thelbin e vet bëhet një mish-mash. Të mjerët ata që i zë makina.

Një miku im, tirons dembabadem, po më pyeste një ditë se çfarë relievi ka Dibra, si është qyteti. Normalisht e pyeta nëse kish qenë në Dibër. Jo, - tha, jam nis, por përfundova në spital të Burrelit, më rraskapitën ato kthesat e Shkopetit. Natyra e tij prej poeti filloi të shpjegonte gjithçka me detaj dhe njëkohësisht të justifikonte veten se rruga ishte e keqe, shoferi i priste kthesat shkurt, etj. E kush më mirë se unë do e kuptonte?

Ja i thash, t'i shpjegoj unë arsyet pse të rraskapit makina, sepse ti, miku im, nuk e bërë asnjë nga absurdet që lind kjo rrugë tashmë mitike: ti nuk ke pirë "kokërr avioni", nuk i ke ra nga "Kina", sepse andej është rruga shumë më e rehatshme dhe e fundit, nuk ke ngrënë pilaf Klosi, sepse në mënyrë marramendëse ai pilaf të bën fil sapo të thash pjatën.

Pasi sosa me shkaqet e nxjerra nga mendja ime, ai m'u betua që s'do e marrë më rrugën për Dibër pa u bërë Rruga e Arbërit.

Ndërsa një profesor i imi në fakultet, një burrë i fisëm, por goxha i moshuar, më pat pyetur para pak kohësh: si është rruga për Dibër, se e kam peng të vete një herë? Me keqardhjen më të madhe, së pari për veten, mandej edhe për profesorin, i thashë: "Më mirë të mos nisesh".

Alban TUFA

Dibrës po i ikin të rinjtë…

Vite më parë lindja e një fëmije ishte fillesa e një cikli gëzimi që manifestohej me mënyra të ndryshme, ndërsa sot në Dibër dhe jo vetëm, gjithmonë e më tepër po mendohet mënyra se si ti përcjellin ato sa më sa larg vendit. Mungesa e një prespektive punësimi dhe një të ardhme të vakët në vend janë shkaqet kryesore në largimin masiv të këtyre të rinjeve duke sjellë një mungesë të theksuar e te rinjëve në rrethin e Dibrës. Varfëria e tejskajshme dhe një mungesë e theksuar e mundësive për një jetesë më të mirë detyron jo vetëm të rinjtë të drejtohen drejt largimit, por edhe prindërit duke investuar shuma të mëdha në menyrë ilegale dhe pa mbushur femijet e tyre 15 vjec guxojnë ti largojnë ato nga gjiri i ngrohtë i familjes familjes.

Grupmoshat e reja kryesisht ato pa mbushur moshën madhore preferojnë të largohen në vëndet nordike, në Francë, Gjermani, Austri për shkak se ligjet dhe shkollat e këtyre vëndeve janë më të përshtatëshme për to. Edhe përse në mënyrë të paligjshme ky py proces nuk ndalon së zhvilluari për arsye që mbetet një ndër të vetmet zgjidhje për të qenë larg vorbullës së madhe të varfërisë dhe paqartësisë që ka mbërthyer realitetin Shqipëtar. Të rinj të shumtë shpikën mënyra dhe arsye nga të ndryshmë për të qenë përfitues të azilit në shtetin Gjerman dhe Frances ku për fat të keq përvec torturave dhe humbjes ekononomike nuk perfitojnë gjë tjetër.

Objektiv tjetër i të rinjëve dibran kohët e fundit duket që është larg europës. Anglia mbetet një nga destinacionet më të lakmuara por me një vështirësi realisht të madhe për të arritur deri atje. Shuma maramendëse parash dhe vuajtjet bëhen pjesë e tentativave të cdo të riu që merr përsipër rrisqe të detyruara nga rrethanat që ndodhemi në vendin tonë. "Duhet të udhëtoje me javë të tëra në mënyrë ilegale, në kamionë mallërash dhe frigoriferikë. Ditë të shumta pa ngënë e ku vdekja të qëndron kudo mbrapa":- janë këto fjalët e Lirit 23 vjec nga fshati Borovjan i Dibrës pas tentativës së dështuar për tejkalimin e kufirit në tokën e premtuar. Pagova gjashtë mijë paund në këmbim të kalimit në territorin Anglez. Qëndruam pesë ditë në Francë, afër një porti duke flejtur në shi, poshtë një ure dhe me ushqim sa për të mbajtur frymën. Policia qëndrontë afër cdo kamioni dhe na u desh të udhëtonim në shtetin Spanjoll, ku me vështirësi hypëm në një kamijon ngarkuar me tulla duke udhëtuar për tri ditë pa pushim deri sa ramë në duart e policisë Angleze. Këto ishin fjalët që Liri tregon plot vuajtje dhe dëshpërim që nuk arriti të shkonte deri në destinacion teksa ecen duke menduar në pllakat e sapovëna të bulevardit të qytetit.

Drejt rrugës së largimit nga Dibra nuk janë vetëm ajo kategori e të rinjëvë që nuk kanë një arsim por dhe ajo elitë e të rinjëve që studiojnë në universitet kryesore të vëndit dhe jo vetëm.

Mënyra jo e përshtatëshme e përzgjedhjes së kuadrove dhe vëndeve të punës në administratë dhe në bisnesin privat dhe një mentalitet i ngurtë bën që të rinj të talentuar dhe profesionistë të zhvillojnë aktivitetet e tyre gjithnjë e më larg Dibrës. Arsyet janë me të vërtetë të ndryshme dhe pjesa më e madhe janë këtyre janë meshkuj por dhe femrat nuk mbesin pas. Të rijntë janë një pjesë shumë e rëndësishmë e shoqërisë njerëzore dhe e trashëgimisë të një vendi.

Largimi i këtyre të rinjëve i sjell Dibrës jo pak mungesa në fuqinë punetorë duke qenë se ajo zotëron një reliev mjaftë të përshtatshëm për zhvillimin e kulturave bujqësore dhe blektorale. Këto emigrant punojnë tokat e fqinjëve tanë duke lënë djerr trojet e tyre. Resulset kulturore dhe turistike të rrethit të Dibrës janë dhe te pazëvendësuesshme. Ato pervec investimit kanë nevojë edhe për një promovim, gjë që të rinj profesionistë në këtë fushë mund të përmirësojnë dhe të hartojnë guida turistike në mënyrë që këto vlera të promovohen. Ka jashtëzakonisht shumë të interesuar për të parë vënde të tilla. Të rinjtë të shkolluar në universitetet kryesore të vendit dhe në ato të europës priren me idene që mos kthehen të kontribojnë në vendin e tyre për arsye te ndryshme, një ndër to mënyra e papërshtatëshme e përzgjedhjes së vendeve të punësimit. Administrata shtetërore dhe bisnesi privat në rrethin e Dibrës ka nevoja të personave profesionistë për shërbimet cilësore në funksionin qe ato kanë. Keto nevoja nuk plotësohen në rastin kur këto të rinj zgjedhin që profesionet e tyre ti zhvillojne në qendrat urbane.

Samet ZAGRADI

Themelohet Shoqata "Gryka e Vogël - Dibër"

Më datë 17 shkurt 2017 themelohet shoqata "Gryka e Vogël"-Dibër. Grupi nismëtar i themelimit janë Shpëtim Cami, Gëzim Dumani, Hamdie Beqiri, Tufik Kurti, Vehbi Xheka, Roland Muka dhe Shehat Cami.

Të mbledhur në zyrën e avokatit Tufik Kurti, grupi nismëtar, unanimisht themeloi shoqatën, duke e emëruar"Gryka e Vogel -Dibër", me inicialet e SHGVD.

"Grupi nismëtar miratoi statutin e shoqatës dhe të gjithë dokumentacionin procedurial që shoqëron një shoqatë, duke përcaktuar edhe fushën në të cilën do të ushtrojë aktivitetin e saj kjo shoqatë: shoqatë atdhetare, kulturore, historike", thuhet në një njoftim të shpërndaë nga grupi nismëtar.

janë të interesuar për një gjë të tillë".

Më tej, grupi nismëtar thekson se "objektivat e SHGVD janë konkrete, të thjeshta, të rëndësishme, të zbatueshme. SHGVD do të kujdeset të inkurajojë dhe të promovojë trashëgiminë kulturën dhe historinë e krahinës "Gryka e Vogël - Dibër". Të forcojë dashurinë, respektin dhe shpirtin e sakrificës e të ndihmës për njëri-tjetrin. Të ruaj dhe të forcojë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me organizatat e tjera lokale, kombëtare apo ndërkombëtare. Të ruaj një jetë të gjallë shoqërore, kulturore, artistike dhe sportive të anëtarëve të saj. Të ruaj dhe të forcojë marrëdhëniet midis brezave. Të ngrejë lart punën vetmohuese dhe traditat e mira të të parëve tanë, emrin e mire që



"Duke u mbështetur në këto kolona, ecja e shoqatës do të jetë në shina të vërtetë, thuhet në një deklaratë të shpërndarë për publikun nga grupi nismëtar. Ne do të luftojmë për të ruajtur parametrat atdhetare, kulturore e historike. Dibra ka kaluar shumë luftëra, por shumica e tyre ka filluar nga ''Gryka e Vogël". Ne këtë do mundohemi ta promovojme duke e vendosur ne vendin që e meriton".

"Gryka e Vogël është një thesar i folklorit, traditave e zakoneve. Është një pasuri e jashtësakonshme ujore, me burime, me peizazhe mahnitëse, me prodhime te gjithëllojshme perimtarie e frutikulture.Gryka e Vogël ka histori kuvendesh,luftërash e bese.Për këto e të tjera do të punojmë pa u lodhur", theksohet në deklaratën e themeluesve.

"Në statutin e shoqatës përcaktohen objektivat , mënyra e antarësimit, mënyra e financimit, e organizimit, e funksionimit, si dhe organet drejtuese të saj. Shoqata"Gryka e Vogël" Dibër do të ketë logon, vulën dhe gazetën e vet.

SHGVD është joqeveritare, jopolitike, jofitimprurëse. Selia qëndrore e saj do të jetë në Tiranë, kurse degë do të ngrihen brenda e jashtë Shqipërisë, kudo ku ka dibranë nga "Gryka e Vogël" dhe ata kanë krijuar me punën,sjelljen dhe qytetarinë e tyre dhe t'i cojë ato përpara".

SHGVD, me statutin e saj, kërkon të krijojë një model disi më ndryshe të funksionimit të një organizate.Në fillim kjo është sfida me vetëveten, pastaj me të tjerët. Kemi miratuar me statut, që kryetari i SHGVD ka një mandate dy vjecar dhe të drejtë rizgjedhje vetëm një here. Ne kërkojmë dhe do të luftojmë për këtë, që SHGVD të jetë:

-përfshirëse, ku çdo fshat i kesaj krahine të ketë një përfaqësues anëtar të shoqatës;

- gjithëpërfshirëse, ku të mos ketë kufizime krahinore, ngjyre, fetare apo politike;

- fleksibël, të reagojë shpejt, të veprojë në kohën e duhur, të përshtatet me situatën. Sigurisht që të realizohen këto objektiva, kërkohen projekte e programe. Që projektet e programet të jenë të suksesshme, ato duhet të jenë përfshirëse, gjithëpërfshirëese, fleksibel, të përgjegjëshme e këmbëngulëse. Projektet e programet e suksesshme veprojnë në mjedise që i trimërojnë njerëzit për të ndërtuar marrëdhënie të fuqishme, të bazuara në besim e respekt të ndërsjelltë.

"Ne jemi nisur, të bindur e të vendosur në misionin tonë. Zoti na ndihmoftë!", mbyllet deklarata e grupit nismëtar të SHGVD.

Ertila, vajza që mundi vdekjen

Nga **Samet ZAGRADI**

Thonë që njeriu lind bashkë me fatin e tij dhe në çdo hap të jetës ai e ndjek nga pas, si hije e eksperiencave jetësore. Çdo përpjekje për ta ndryshuar atë thuhet se është e kotë sepse rrjedha e jetës varet pikërisht nga ai. Njeriu paska fatin e tij unik destinuar vetëm për të, fat ky që jo rrallë herë ndodh që të jetë kundër tij në një apo në një tjetër aspekt të jetës.

Ertila është një nga njerëzit që me forcë, durim dhe këmbëngulje ju kundërvu fatit dhe deri në ditën e fundit të kalvarit të vuajtjeve të saj. Ajo ka lindur në qytetin e Peshkopisë, ishte vajza më e madhe e dy prindërve të varfër, të cilët jetonin ashtu si të gjithë nën valën e mentalitetit të kohës dhe zonës. Historia e saj nisi në vitin 2007 kur ajo ishte vetëm 16 vjeç dhe përkatësisht në klasën e tetë. Ishte në një moshë ku logjika nuk zotëronte kapacitete për të marrë vendime jetësore.

Ditën e parë të vitit 2007 në shtëpinë tonë erdhën dy miq të babait, me pretekstin për të shkëmbyer urimet për Vitin e Ri, nis të tregojë historinë Ertila, tashmë 25 vjeçe. Duke ju dridhur zëri tregon se nuk ishte ky qëllimi i ardhjes së tyre. Ata erdhën duke i thënë babait që duam që vajzën tuaj ta marrim për nuse, sepse ne njihemi si familje dhe përse mos e vazhdojmë më tej miqësinë? Babai heshti dhe bashkë me ta heshta dhe unë. Pas largimit të tyre çdo presion i mundshëm bie mbi mua. Prindërit e mi nën presionin e mentalitetit këmbëngulnin herë pas here, e më pyesnin nëse kisha dikë tjetër. Unë nuk flisja, nuk kuptoja çpo ndodhte dhe pas disa orësh këmbëngulje duke qarë guxova të thoja vetëm diçka duke u drejtuar nga nëna ime:

- Mam, ju nuk keni bukë për të më dhënë që po më nxirrni nga shtëpia ime? Çdo fjalë në ato çaste ishte e tepërt. Çdo detaj i prindërve të mi më shtynte të besoja që ato kanë të drejtë dhe kështu u fejova me dikë që nuk e doja, më një moshë të vogël dhe pa u pjekur si njeri për të ndërmarrë një vendim kaq të rëndësishëm për jetën time.

Pas zyrtarizimit të fejesës çdo fundjavë shkoja të ndihmoja vjehrrën për shkak se ishte e vetme. I fejuari ishte emigrant në Itali dhe komunikimi me të ishte me të vërtetë i pakët. Flisja rrallë me të dhe çdo bisedë ziheshim e përfundonim me fjalën që "Të kam marrë për mamanë" ti shërbesh asaj. Një fejesë e krijuar pa dashuri nën guaskën bosh të dogmave dhe traditave. Formaliteti kishte rëndësi më shumë se lumturia e Ertilës, e si Ertila ka akoma shumë vajza që fejohen, martohen me dikë që nuk e duan.

Teksa vazhdon të rrëfejë historinë asaj zëri fillon të dridhej. Në një nga fundjavat, vazhdon ajo, që në darkë nuk ndihesha mire. Ndjeja dhimbje të fortë në bark. Menjëherë më dërguan në spitalin e Peshkopisë kryen procedurat dhe morën analizat. Atë natë qëndrova



atje dhe të nesërmen mora analizat ku u pa që gjendja ime ishte shumë e keqe. Unë nuk dija asgjë, por të gjithë rreth meje qanin. Unë isha prekur nga një sëmundje shumë e rëndë, dhe patjetër duhet të operohesha ndryshe i kisha ditët e numëruara. Pas operacionit nuk mund të lëvizja, isha e mpirë dhe mora vesh që pas tre ditësh duhet të nisesha drejt Tiranës për një vizitë ose ndosha një operacion më i specializuar. Mbaj mënd, tregon Ertila, që në QSUT takova dr.Silvën, një njeri i qeshur dhe që të falte pozitivitet. Ajo u kujdes për mua për një javë deri kur u duk sikur gjendja ime u përmirësua.

Pas dy vitesh (2009) shëndeti im u përmirësua dhe familja vendosi të më bëjë një dasëm të madhe. Të vishje fustanin e bardhë, ëndërr e çdo femre ishte e jashtëzakonshme, sidomos pas kalimit të një sëmundjeje të rëndë, e cila mund të mos më linte ta vishja kurrë atë fustan. Çdo gje dukej sikur po sheshohej, marrëdhënjet me tim shoq, me familjarët dhe shëndetin tim. Shtëpia jonë ishte dy katëshe, pas saj një tarracë që përdorej për të tharë rrobat dhe për tu ngjitur në të përdornim shkallë druri. Ngjitesha shpesh aty, po kur është e shkruar asgjë s'do ta ndalonte.

Rrëzimi nga ato shkallë rihapën dhe trazuan plagë të hershme. Dhimbjet shpeshtoheshin çdo çast. Spitali rajonal i Peshkopisë nuk më dha asnjë shpresë. Maqedonia më pas Greqia ishin destinacionet e vizitave, por as aty nuk merrnin përsipër operacionin. Gjendja ime po përkeqësohej shumë ndërkohë pas kthimit nga Greqia lashë takimi me dr.Halim Kosovën, por as ai nuk mori përsipër operacionin tim. Historia kthehet sërish në Tiranë tek dr.Silva në spitalin "Nënë Tereza" Tiranë. Gjendja ekonomike ishte realisht e keqe dhe shpenzimet ishin tepër të mëdha. Gjendja po keqësohej më tej derisa u vendos një operacion tjetër në qendrën spitalore universitare " Nënë Tereza" Tiranë .... Zoti më bëri të fortë, por kur shihja prindërit e mi që vuanin me të vërtetë tmerrohesha. Flinin në karrige me netë të tëra...

Mes vuajtjeve të shumta Ertila sërish mbetet e fortë edhe pas disa kimioterapish të detyrueshme. Flokët nisën t'i bien e trupi filloi të mos kishte më fuqi. Sëmundja

"Kisha nevojë për mbështetje dhe ngrohtësi, thotë ajo. Çdo natë shikoja fëmijë në ëndërr. Doja me patjetër të kisha një fëmijë në krahë, dhe pse jo biologjikisht i imi. Askush nuk e dëshironte këtë. Pas një viti mora vendimin se kjo martesë nuk shkon më...

tashmë po degradonte më keq dhe shpresat sa vinin e pakësoheshin. E vetmja shpresë ishte një tjetër tentativë për një kurim më të specializuar. Mundësitë nuk ishin por kur vjen puna tek shëndeti duhet të bësh çdo gjë. Kontaktet e para ishin me spitalin Averses, Moscati në Napoli ku ju nënshtrua kontrolleve të shumta dhe nga konstatimet u pa nga mjekët që të gjithë operacionet, ilaçet që kishin përdorur për të nuk kishin bërë asnjë efekt, logjikisht dhe jeta e saj tashmë ishte në rrezik. Ai spital nuk mund të mbulonte atë shërbimin për një operacion. E vetme në mes të katër rrugëve Ertila nuk kishte më asnjë shpresë për pasur një kurim. Prindërve të saj u mbaruan dokumentet dhe nuk kishin të drejtë qëndrimi në Itali. Rastësia është mbret i botës thonë dhe në rastin e saj ishte arsyea që ajo është akoma gjallë. Njohja e një prifti bëri që Ertila të lidhej me Caritas Italia dhe më pas takimi i disa mjekëve të spitalit Frederico Secondo. Për rreth katër ditë u kryen analizat dhe u vendos një operacion urgjent, ku nuk mund të bëhej gjë tjetër përveç heqjes së mitrës duke e bërë atë të mos ëndërronte kurrë më për një fëmijë të saj. Mjekët treguan që në ajo kishte vetëm tri ditë jetë në qoftë së nuk do të kishte bërë operacionin dhe heqjen komplet të mitrës. Ajo operohej dhe dy herë të tjera për tu kontrolluar. Shëndeti i saj për herë të parë filloi të përmirësohej.

Problemet nuk kanë të sosur për të, duke mos mjaftuar kjo ftohja me bashkëshortin dhe njerëzit e familjes së tij. Mentaliteti famëkeq i një zone kaq të mbyllur nuk e lejonte atë që të birësonte një fëmijë. Shëndeti i saj fizik tashmë ishte përmirësuar ndjeshëm.

"Kisha nevojë për mbështetje dhe ngrohtësi, thotë ajo. Çdo natë shikoja fëmijë në ëndërr. Doja me patjetër të kisha një fëmijë në krahë, dhe pse jo biologjikisht i imi. Askush nuk e dëshironte këtë. Pas një viti mora vendimin se kjo martesë nuk shkon më...

Sot ajo është 25 vjeç dhe gëzon një shëndet të plotë. Punon dhe jeton ne shtetin italian dhe është me të vërtetë një person që përcjell gjithmonë mirësi dhe forcë. Me dëshirën e Zotit dhe me durimin njerëzor çdo gjë arrihet. Çdo gjë është e mundur në qoftë se këto dy gjëra ekzistojnë, thotë Ertila, për çdo njeri që do të lexojë këtë histori...

Rruga e Arbërit nr. 131

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një copëz nga Dibra,
pavarësisht vendndodhjes në çdo skaj të botës...

të rinj të talentuar

Lunada Methasani: **Punoni** shumë **në heshtje, lini suksesin** të bëjë zhurmë **për ju**



Lunaja ju njiheni si vajza e mjeshtrit të gazetarisë sportive, Defrim Methasanit. Çfarë mund të thuash më tepër rreth vetes për lexuesit tanë?

Te jesh vajza e një personazhi publik ndonjëherë duket se i ke thënë të gjitha, por në të vërtetë nuk është kështu, pasi duhet punë e dyfishtë të krijosh emrin tënd. Ky epitet më ka ndjekur gjithmonë dhe jam e lumtur për këtë fakt, pasi kam ndjekur rrugën e tim eti dhe dua që një ditë t'i ngjaj atij, duke qenë se kemi pasionin e përbashkët për gazetarinë. Përpos kësaj, më pëlqen të jem në kontakt të vazhdueshëm me njerëz, të krijoj ura bashkëpunimi, ndaj edhe aktualisht jam në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar si Koordinatore e Marrëdhënieve me Publikun. Për të tjerat t'ia lemë kohës...

Si ka qenë fëmijëria juaj dhe sa e lidhur ka qene ajo me Dibrën?

Unë kam lindur në Peshkopi dhe për këtë fakt jam shumë e lumtur. Edhe pse u largova foshnje disa muajshe drejt Tiranës (ku jetoj sot) gjithmonë e kam pas kokën pas, sepse me këtë vend më lidhin shumë gjëra. Mbaj mend sa shpesh udhëtonim drejt Dibrës me mamin kur isha e vogël, sepse kam ende të afërm që jetojnë atje. Mezi prisja verën, të lahesha në lumin Drin. Më jepte një emocion dhe kënaqësi të veçante çdo gjë, duke filluar që nga ajri i pastër dhe natyra piktoreske e deri te mikpritja tipike dibrane apo gatimet tradicionale bio që gatuante nëna. Këto, por edhe njerëzit më bënin të kthehesha sërish me shumë mall.

Mund të na thuash si nisi dhe si vazhdon karriera juaj si gazetare dhe moderatore?

Gazetaria dhe moderimi kanë qenë një ëndërr që ndoshta do të mbeteshin në sirtar gjithmonë pasi unë ndoqa Universitetin për Ekonomi dhe më pas Masterin Shkencor për Marketing. Kjo zgjedhje ishte disi e ndikuar edhe nga prindërit, pasi profesioni i gazetarisë të detyron terrenin dhe nuk ofron komoditetin e nevojshëm për femrat. E tillë mbeti derisa këtë dëshirë ia shpreha mikut tonë të familjes nga Kosova, Milaim Krasniqi, kryeredaktor në RTK dhe ishte i pari që besoi në aftësitë e mia dhe më mundësoi që të moderoj një event mode në Tiranë me të ftuar të rëndësishëm. Duke parë performancën time, pasi mbaroi me sukses eventi, me kontakton një producente shqiptare për një tjetër spektakël ndërkombëtar dhe kështu ndoqën njëra-tjetrën modelimet, të cilat janë transmetuar edhe në ekran. Mund të them që kam pasur mbështetjen e vazhdueshme të familjes time, veçmas babit, për çdo spektakël që kam pasur në Shqipëri dhe Kosovë. Dalëngadalë ju afrova TV, ndërkohë që vazhdoja edhe studimet e larta, të cilat nuk i kam ndërprerë asnjëherë. Në ekran kam marrë eksperiencë në TVSH dhe Ora News në programacion, por edhe në lajme. Gazetaria, sidoqoftë, mbetet një profesion të cilin e bëj me pasion të madh.

A ka qenë e lehtë të arrish deri këtu dhe cilat kanë qenë vështirësitë që ke hasur në rrugën drejt suksesit tuaj?

Natyrisht që çdo profesion ka vështirësitë e tij, por gazetaria ka shumë elemente që ta bëjnë më të vështirë punën. Emocionet para kameras, të gjesh fjalët e duhura në moment (pasi kam qenë gjithmonë drejtpërdrejtë jo me regjistrim), korrektesa me oraret dhe të ftuarit, vrapimi të kapësh lajmin i pari etj., etj., më kanë skalitur. Por televizioni është një luftë për mbijetesë, duke marrë parasysh se je në konkurrim thuajse çdo minutë nga gazetarët e rinj që shtohen çdo ditë dhe kjo është gjë e mirë. Por më ka shërbyer shumë kjo eksperiencë.

Sa ka ndikuar babi juaj në karrierën tuaj?

Babi ka qenë shtylla ime, gjurmët që i kam ndjekur e sigurt. Që e vogël mbaj mend që më aktivizonte shumë në përshkrime, fjalime dhe kurrë nuk m'i bënte hartimet në shkollë (madje ndonjëherë mërzitesha me të). Kështu më ka nxitur të shkruaj dhe të mendoj vetë. Edhe pasi u rrita dhe nisa të bëhesha aktive, më merrte gjithmonë me vete në shfaqje dhe koncerte, sportive dhe jo vetëm... Ka qenë me mua në moderimin e parë dhe çdo herë tjetër. Nuk më ka parë si vajzë, por si kolege, gjithmonë i gatshëm për ndonjë vërejtje të vogël, pasi donte të shihte tek unë më të mirën. Nuk më ka imponuar kurrë një zgjedhje apo bindje. Thjeshtë ka respektuar zgjedhjen time. E kam shok, me shumë sesa baba...

Ju jeni një nga personazhet të cilët nuk e keni harruar prejardhjen tuaj, përkundrazi jeni promotore dhe krenare për të. Përse e bëni këtë?

Kur isha më e vogël, gjithmonë jam paragjykuar si "malokja e Dibrës" ose "ja, erdhi kjo nga Dibra të bëhet e para në mësime këtu në Tiranë" etj. Kur e kujtoj, më vjen të qesh. Në fillim mërzitesha, por kjo më bëri të vazhdoj më tej e fortë, sepse nuk e kisha kurrë për turp që kam lindur atje. Madje gjithmonë në hartime apo projekte në shkollë flisja për Dibrën. Një meritë të madhe kanë edhe gjyshërit e mi, veçmas Shuaipi, i cili më bënte gjithmonë kurioze të dëgjoj tregimet dhe alegoritë dibrane në dialekt. Duke u rritur, rritej edhe malli për atë vend, ndaj sa herë mundem, flas për të dhe shumë shokë dhe shoqe në universitet apo punë bëhen kuriozë për ta parë Dibrën. E bëj këtë nga malli për dibranët dhe atë vend, që mua më duket se është i bekuar nga natyra...

Cili është mendimi juaj për të rinjtë dibranë dhe çfarë mesazhi do t'ju jepje si një njeri i suksesshëm?

Faleminderit për konsideratën nga ana juaj. "Dibranët janë shumë punëtorë". Këtë shprehje e dëgjoj nga njerëz të qyteteve të ndryshme dhe e pohoj plotësisht. Gjithmonë jam ndjerë krenare për shumë suksese te tyre në çdo fushë dhe them dibranët mund të arrijnë shumë. Kemi shumë të rinj dibranë që kanë çuar jehonë deri në Amerikën e largët për sukseset e tyre. Madje gjej rastin të të përgëzoj shumë edhe ty Samet, si një i ri dibran që ka premisa të shkojë larg. Mesazhi im për të rinjtë dibranë është i thjeshtë, ashtu siç janë dibranët: "Punoni shumë në heshtje dhe lini suksesin të bëjë zhurmë për ju".

Çfarë ndjesie të jepet kur intervistohesh nga një gazetë e vendlindjes? Çfarë do t'u thoshe lexuesve dibranë?

Gazetën "Rruga e Arbërit" e dua shumë, sepse është promotorja më e mirë e Dibrës. Familja ime ka abonim vjetor dhe gjithmonë e shfletoj me dëshirë, pasi dua të di çdo herë e më shumë për vendin tim, por nuk më kishte shkuar kurrë në mend që do të jem pjesë e intervistave të saj, aq më pak si një e re e suksesshme nga Dibra. Madje, lajmin e parë për suksesin tim në moderim e ka nxjerrë gazeta "Rruga e Arbërit", ndaj jam dyfish e lumtur dhe falënderuese ndaj stafit të palodhur që bëjnë një punë të shkëlqyer. Kjo gazetë është një copëz nga Dibra, pavarësisht vendndodhjes në çdo skaj të botës...

Samet Zagradi

ELVIS PRENÇI, NJË NGA TË PAKTËT DIBRANË TË EKIPIT TË KORABIT

Korabi do të bëhet faktor **në Superligë**



Elvis, je një ndër të paktët futbollist profesionistë me origjinë Dibrane që aktivizohesh me ekipin e Korabit. Çfarë ndjesi të jepet të luash dhe të shënosh për ekipin e vendlindjes?

Nuk e kisha menduar kurrë të luaja me ekipin e Korabit në superligë, duke pasur parasysh shumë faktorë të ndryshëm që bënin të pamundur që Korabi të konkuronte mes ekipeve me elitare të Shqipërisë. Është një ndjenjë vërtetë fantastike, e pabesueshme të luash për njerëzit dhe tifozërinë e vendlindjes tënde. Unë shënova një gol për kupë dhe të dëgjosh emrin tënd të brohoritur nga tifozëria, nuk shpjegohet me fjalë. Unë që në moshë të vogël kam qenë pjesë e ekipit të Korabit dhe pasi u largova nga Peshkopia sërish e ndiqja ecurinë e tij si një tifoz i zjarrtë. Babai im, Kujtim Prençi, ka qenë një nga futbollistët e Korabit dhe më ka bërë ta dua më shumë këtë ekip.

Çfarë përfaqëson Elvisi jashtë fushës së blertë?

Unë jam diplomuar për menaxhim biznesi. Sigurisht, që edhe jashtë fushe mundohem të tregohem sa më profesionist dhe i thjeshtë. E gjithë dita ime është e lidhur me sportin. Miqtë e mi pothuajse pjesa më e madhe sportistë ku flasim për situatat e ekipeve tona ku luajmë. Familja për mua është e shenjtë dhe një pjesë të mirë të kohës mundohem ta kaloj me ta. Jam tip që më karakterizon humori kudo që ndodhem.

Sa ka ndikuar babai juaj në sukseset e tua?

Babai im ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në karrierën time. Shpesh kam hasur probleme dhe mbështetja e familjes nuk më ka munguar kurrë. Babai im më shoqëron në çdo ndeshje dhe atë e kam trajner personal duke më vënë ne dukje ëdo detaj, sigurisht me qëllim për të përmirësuar.

Meqë jemi te karriera, si nisi dhe si ka vazhduar ajo deri në ditët e sotme?

Fillimet e mia nisën me ekipin e Korabit që në moshë të vogël. Më pas u transferova tek akademia e ekipeve zinxhir të Tiranës, duke vazhduar më pas në ekipin e parë të Kukësit. Pas Kukësit u transferova tek Partizani duke vazhduar tek ekipi i Teutës së Durrësit ku aty pësova një dëmtim që më mbajti plot një vit larg fushave. Me dëshirë pas plot një viti vështirësi u riktheva kësaj radhe në superligë tek ekipi i Korabit për të ndjekur gjurmët e babait tim.

Ti ke luajtur me kombëtaren e moshave. Çfarë do të thotë të këndosh hymnin dhe të veshësh bluzën e një kombi?

Kulmi i karrierës time ka qenë grumbullimi im me kombëtaren U21 me të cilën kam luajtur 20 ndeshje me një emocion shumë të madh. Këndimi i hymnit është një emocion i papërshkrueshëm. Ajo bluzë ka një peshë dhe një përgjegjësi të jashtëzakonshme.

Si duhet të veprojë një futbollist profesionist në rastet kur shkelet etika e tifozëve dhe jo vetëm ndaj tij?

Ne jetojmë në Shqipëri dhe kultura që tregojnë tifozët lë për të dëshiruar. Por një futbollist profesionist duhet të menaxhojë situatat delikate duke kuptuar tensionin dhe adrenalinën që ndjeshja krijon. E njëjta gjë duhet të ndodhë mes futbollistëve dhe arbitrave.

Na trego pak çfarë ndodh brenda skuadrës, larg syve të tifozëve?

Ekipi ku ne luajmë është me të vërtetë si një familje sepse ka ditë të javës që më shumë rrimë me shokët e ekipit se sa me familjet tona. Ne stërvitemi, grumbullohemi për ndeshje, apo qoftë dhe ndonjë kafe.

Sa vlerë ka futbolli në Shqipëri?

Futbolli në Shqipëri është përmirësuar shumë. Ju e shikoni që shumë ekipe kanë në përbërje lojtar cilësor të huaj. Kjo do të thotë që edhe kostoja është e lartë. Mendoj që një lojtar i Superligës paguhet shumë mirë duke hequr pjesën e problemeve financiare që kane disa ekipe si vonesa në rroga apo mospagimi në mënyrë korrekte.

Sipas teje, çfarë i mungon futbollit Dibran, dhe çfarë këshille do u jepje të rinjve që kanë ëndërra futbollin?

Mendoj që sportit dibran i mungon infrastruktura, duke bërë që investitorët të jenë skeptik në financimin e sportit në Dibër. Marrim shembull skuadrën e Kukësit, që me përmirësimin e kushteve sportive, pretendon sot të jetë ekipi kampion i Shqipërisë. Talentët dibran nuk mungojnë. Kam parë talente në ekipet zinxhirë dhe atyre djemve u them që punoni, djersiteni, këmbëngulni mbi vështirësi sepse asgjë nuk është e pamundur.

Cilat janë fjalët e tua për tifozërinë e zjarrtë dibrane.

Dua t'i përshëndes me gjithë zemër të gjithë tifozërinë e pakrahasuesshme të Korabit. Unë personalisht, por edhe në emwr të ekipit, e kuptojmë mërzitjen dhe dëshpërimin e tyre mbi situatën që ndodhemi në kampionat, por mendoj se ndikojnë disa faktorë që tashmë duhen përfshirë edhe problemet financiare kohët e fundit që vështirësojnë situatën. Sigurisht, përgjegjësia bie mbi futbollistët. Dua të falenderoj tifozët që na mbështesin në humbje dhe fitore. Padyshim që Korabi do të bëhet faktor në Superligën shqiptare...

S.Zagradi

botim i ri

Fjalori i *HAJRI SHEHUT*, një nga veprat më të mira leksikografike

Prof. dr. **ENVER HYSA**

Ky fjalor krahinor përfshin lëndë nga një zonë etnografike e gjuhësore e veçantë e rajonit të Dibrës, siç është Ujemuja. Ajo shtrihet në veri të qytetit të Peshkopisë, në kufi me zona të Kukësit dhe zona të tjera në faqen lindore të malit të Korabit, që i ndan nga të folme të shqipes jashtë kufijve shtetërorë. Ky pozicion i jep kësaj zone një rëndësi të veçantë edhe në aspektin gjuhësor.

Autori i fjalorit, prof. Hajri Shehu, leksikograf e leksikolog me përvojë shumë të gjatë, i lindur e i rritur në ato anë, njohës shumë i mirë i pasurisë gjuhësore dhe i së folmes së tij të vendlindjes, ka përgatitur për botim një vepër që i bën nder atij dhe së folmes së tij të vendlindjes. Edhe pse i lindur në ato anë, për informacionin rreth fjalëve të përfshira në fjalor, ai nuk është mjaftuar vetëm me vjeljet e veta, që i ka gjurmuar nga prindërit e njerëzit e tij më të afërt, por edhe nga banorë të tjerë dhe nga ekspedita të qëllimshme leksikologjike në fshatra të tillë, si Kallë, Sllovë, Ratke, Zall-Kalis, Lugjej, Sllatinë, Venisht, Shumbat e Dypjakë. Për grumbullimin e lëndës autori ka shfrytëzuar çdo mundësi që i është dhënë – nëpër dasma, nëpër odat e burrave, në kuvendime e biseda për ngjarje historike, bëma, tradita historike, punë bujqësie etj., madje edhe në rrugë, në lojërat, shakatë e humorin e të rinjve - për leksikun me vlerësim negativ, mallkime e vulgarizma. Nga ana tjetër, autori pohon se ka vjelë shtershëm edhe lëndën folklorike të mbledhur prej tij në këto anë në vitet 1962-1965. Në Hyrje, autori pohon, gjithashtu se fjalë e shprehje të këtij fjalori janë botuar prej tij në mënyrë të përzgjedhur në revistat shkencore të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë - *"Studime filologjike"* dhe *"Gjuha jonë"*, prej nga një pjesë e tyre janë marrë e janë përfshirë në fjalorë të gjuhës shqipe.

Fjalori është diferencues, çka do të thotë se ai përfshin kryesisht fjalë dhe shprehje që janë karakteristike për të folmen, fjalë e shprehje që ruhen në folklor, sinonime vendore që përdoren në vend të fjalëve të mbarë gjuhës etj.

Siç e ka theksuar edhe vetë autori në Hyrje, që prin lëndën leksikografike, fjalori përfshin mbi 8000 fjalë, përveç njësive frazeologjike dhe fjalëve të urta. Ai përfshin pesë shtresa fjalësh: 1. fjalë që përdoren në këtë të folme, të cilat nuk i kanë përgjegjëset e tyre sinonimike në gjuhën e njësuar letrare; 2. fjalë të mbarë gjuhës, por që në të folmen përkatëse përdoren me kuptime dhe ngjyresa të ndryshme kuptimore; 3. fjalë që plotësojnë çerdhen fjalëformuese të gjuhës letrare; 4. fjalë të prejardhura, të formuara sipas modeleve tipike popullore; 5. variante fjalëformuese, por edhe morfologjike e fonematike të fjalëve të mbarë gjuhës. Natyrisht, ky fjalor, si pasqyrues besnik i pasurisë leksikore të zonës, nuk mund të linte jashtë edhe fjalë me burim nga gjuhë të tjera e që përdoren në këtë të folme, si sllavizma e turqizma, të cilat janë jo vetëm karakteristikë e stilit bisedor, por kanë një shtrirje edhe në folklorin e pasur tradicional të krahinës.

Fjalori do të jetë mjaft i kërkuar nga mësuesit, në radhë të parë, dibranë, të cilët do ta shohin atë edhe si një ndihmë e model mjaft të mirë për të ndërmarrë vepra të tilla për të folme të tjera të zonës së Dibrës...

Lënda është trajtuar, analizuar dhe zbërthyer kuptimisht në mënyrë të saktë e të hollësishme, sipas parametrave leksikorë të gjuhësisë sonë të sotme. Ajo është një pasuri gjuhësore kombëtare, e mbledhur me kujdesin e studiuesit të përkushtuar. Dija leksikografike shqiptare do t'i referohet me siguri gjithnjë, për të nxjerrë prej saj njësi me vlerë letrare potenciale, domethënë, fjalë, frazeologji etj. që mund të shtrihen gjerësisht në përdorim edhe në gjuhën standarde.

Besojmë se fjalori krahinor i prof. Hajri Shehut do të mbetet nga veprat më të mira leksikografike të llojit të tij. Jemi të bindur se ai do të mirëpritet jo vetëm nga dibranët, të cilët do të dëshironin që pasuria e të folmeve të tyre të bëhet e njohur gjerësisht, por edhe nga studiuesit, që do të gjejnë lëndë për studime të natyrave të ndryshme. Besojmë, gjithashtu se fjalori do të jetë mjaft i kërkuar nga mësuesit, në radhë të parë, dibranë, të cilët do ta shohin atë edhe si një ndihmë e model mjaft të mirë për të ndërmarrë vepra të tilla për të folme të tjera të zonës së Dibrës, për të menduar më vonë, për një atlas krahinor e fjalor të përgjithshëm të të folmeve të Dibrës.

(Librin e gjeni pranë librarisë së botimeve M&B. Kontakt: 069 20 68 603/Email: mbbotime@gmail.com)

Besojmë se fjalori krahinor i prof. Hajri Shehut do të mbetet nga veprat më të mira leksikografike të llojit të tij. Jemi të bindur se ai do të mirëpritet jo vetëm nga dibranët, të cilët do të dëshironin që pasuria e të folmeve të tyre të bëhet e njohur gjerësisht, por edhe nga studiuesit, që do të gjejnë lëndë për studime të natyrave të ndryshme.



Prof. dr. Jani Thoma vë në dukje se "Fjalori" është hartuar sipas kritereve leksikografike bashkëkohore në të gjitha elementet e tij: në zgjedhjen e fjalësit, në paraqitjen leksikografike të fjalëve dhe të paragrafit për çdo fjalë, në trajtat e shënimet gramatikore dhe të vlerave të mbishtresuara shprehëse-emocionuese (tall., mospërf., përçm., shar. etj.), në mënyrën e dhënies së frazeologjisë e të thënieve tipike vendore etj. Për saktësi shkencore dhe për ekonomi të paraqitjes, autori shpesh i është referuar "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe" (1980), çka i jep këtij fjalori krahinor edhe një krakter krahasimtar me leksikun, frazeologjinë e sematikën e pasqyruar në një fjalor kombëtar...

E folmja e Ujemujës në një fjalor shkencor

Këto ditë doli nga shtypi libri më i ri i prof. dr. Hajri Shehut "Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës (Qarku i Dibrës)".

Ky libër, i botuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, është një nga të rrallët e kësaj fushe, dhe modeli i mbledhjes, përpunimit dhe strukturimit të tij, është një model se si në të ardhmen një botim të ngjashëm të realizohet për të gjithë Dibrën.

Libri shoqërohet me një hyrje nga akademik, prof. dr. Jani Thomai dhe prof. dr. Enver Hysa.

"Në shekullin e ri, në kushtet e reja të Shqipërisë me ndërrimin e sistemit dhe me hapjen e plotë, kur ndikimi i globalizmit është i fuqishëm në të gjitha fushat dhe kur zhvillimi modern i ekonomisë, i shkencës, i kulturës dhe i jetës përgjithësisht sjellin ndryshime të thella edhe në gjuhë, kryesisht në leksik, ndër të tjera duke shtyrë prapa e duke hedhur në harresë fjalë, kuptime e shprehje popullore shqipe e duke hapur rrugën për huazime, shpesh të panevojshme, që prekin identitetin kombëtar të shqipes, hartimi i fjalorëve dialektorë e krahinorë, që nxjerrin në dritë pasurinë vetjake të shqipes, e shpëtojnë nga humbja dhe e vënë në përdorim të përgjithshëm, bëhet edhe më i domosdoshëm, edhe më i dobishëm. Këtij qëllimi i shërben edhe *"Fjalori me fjalë e shprehje popullore nga Ujemuja"*, i hartuar nga profesor Hajri Shehu", shkruan në parathënien e a**kademiku, prof. dr. Jani Thomai.**

Prof. dr. Hajri Shehu është një leksikolog e leksikograf i njohur, me përvojë të pasur si bashkautor në hartimin e fjalorëve kombëtarë si: *"Fjalor i gjuhës së sotme shqipe"* 1980, *"Fjalor i shqipes së sotme"* 1984/2002, *"Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe"* 2004, *"Fjalor i gjuhës shqipe"* 2006, *"Fjalor elektronik i gjuhës shqipe"* 2014 etj.), ose si autor, bashkautor a bashkëredaktor në hartimin e disa fjalorëve gjuhë e huaj - shqip e shqip - gjuhë e huaj (*Fjalor anglisht-shqip* 2010, *Fjalor i termave të prapavijës/shqip-anglisht-rusisht* 1987, *Fjalor themelor i termave të bujqësisë/shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht* 2006 etj.), me formim të plotë edhe në teorinë leksikografike dhe me seriozitetin shkencor të nevojshëm për një gjuhëtar të mirëfilltë.

"Fjalori me fjalë e shprehje popullore nga Ujemuja", i hartuar nga profesor Hajri Shehu, është i një cilësie të lartë shkencore, sjell një pasuri leksikore, frazeologjike e semantike të panjohur përgjithësisht, por që duhet të bëhet e njohur me botimin e tij për vlerat e shumta që ka për mbrojtjen e pasurisë gjuhësore vetjake...

"Fjalori" ka mbi 8000 fjalë, përveç njësive frazeologjike e fjalëve të urta burimore, por vlera e tij rritet më tej me të dhëna të tjera semantike për shumë fjalë e njësi frazeologjike, që përbëjnë, bashkë me fjalët e njësitë frazeologjike, një pasuri me shumë vlerë në leksikun e shqipes.

"Autori i ka vënë qëllim vetes të japë leksikun, frazeologjinë e semantikën leksikore të vaçantë të së folmes në klasa e grupe tematike fjalëformuese, por edhe lëndë tjetër nga toponimia etj. Fjalori është i tipit diferencues, por me pesë shtresa fjalësh vendore ai sjell një pasuri të çmuar të shqipes, shumë prej saj e panjohur përgjithësisht, ndërkaq e dobishme edhe për pasurimin e shqipes standarde. Fjalët, kuptimet e veçanërisht frazeologjia e pasur popullore në *"Fjalor"* mbartin edhe vlera shprehëse-emocionuese, aq të kërkuara jo vetëm në ligjërimin artistik, por edhe në ligjërimin e zakonshëm për forcën, saktësinë e bukurinë e tyre, duke zgjeruar kështu mjetet e shprehjes stilistike", shkruan në parathënien e librit Jani Thomai.

Thomai vë në dukje se "Fjalori" është hartuar sipas kritereve leksikografike bashkëkohore në të gjitha elementet e tij: në zgjedhjen e fjalësit, në paraqitjen leksikografike të fjalëve dhe të paragrafit për çdo fjalë, në trajtat e shënimet gramatikore dhe të vlerave të mbishtresuara shprehëse-emocionuese (*tall., mospërf., përçm., shar.* etj.), në mënyrën e dhënies së frazeologjisë e të thënieve tipike vendore etj. Për saktësi shkencore dhe për ekonomi të paraqitjes, autori shpesh i është referuar *"Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"* (1980), çka i jep këtij fjalori krahinor edhe një krakter krahasimtar me leksikun, frazeologjinë e sematikën e pasqyruar në një fjalor kombëtar, duke e spikatur më mirë kështu ç'të re sjell ai në këto fusha.

"Fjalori me fjalë e shprehje popullore nga Ujemuja", i hartuar nga profesor Hajri Shehu, është i një cilësie të lartë shkencore, sjell një pasuri leksikore, frazeologjike e semantike të panjohur përgjithësisht, por që duhet të bëhet e njohur me botimin e tij për vlerat e shumta që ka për mbrojtjen e pasurisë gjuhësore vetjake të shqipes, për pasurimin e leksikut të saj e veçanërisht të standardit, për shkrimtarët, përkthyesit, publicistët, shkollarët etj., por edhe për studimet shkencore në fushë të leksikut të shqipes, shkruan akademik Jani Thomai. Sipas tij, "ky fjalor do të pasurojë bibliografinë leksikografike shqiptare dhe me vlerat shkencore e praktike që ka, do të renditet në radhët e para të fjalorëve të këtij tipi."

Shaqir Skarra / Dritëhijet e një poeti
Botimet M&B
ISBN:978-9928-4397-5-8
Çmimi: 1000 lekë
Kopertina e realizuar
nga Zaim ELEZI (*Zaya*)

Elegji për një bilbil

Nga **Ilir Spata** (*SHBA*)

Dibrës së lashtë maja, maja,
Një vaj gjame vjen së largu.
Me yrnek të Mide Dodës.
"Paska vdekun Naim Plaku!?"
Ç'paskan kangët që lotojnë?!

Nëpër buzë pse dridhet vargu?
Pushoi zani i bilbilit,
Që jehoi në mal e fushë.
Bama brezash, atdhetarësh,
U këndoi sikur askush.
Këngë dasme e hareje,
Zjarre t'shueme t'ue përpushë.

Kangë djepi stërgjyshore,
Turrë trimash si rrufe,
Fjalë e lot si vajtimore,
I përzieu gjak e dhé.
Plagë përgjakun zgjoj kreshnikët:
Azem Bejta hej ku jeee!

Ambëlsi e fjalës shqipe,
Ja shoqëroi çdo strofë e varg.
Me hir nusesh si prej Dibre,
Dritë e rreze lëshoi larg.
Fjalë zemre dashurie,
Si ai askush si pat.

"Paska vdekun Naim Plaku!"
Ujë e m'Ujën e ka lanë,
Çdo prag dere të Sllatinës,
Fjalë e ngrime vjen si gjamë.
Lisa, gurë zanë e përloten,
Britma kuje në Tiranë.

Shamibardhat zunë kujën,
Kanga m'vishet në të zi,
Grykës Drinit hapet kuja,
Lot e dhimbje tu i përzi.
Pikojnë strofat helm e lot,
Dhimbja vargjet i përpi.

Trup i lodhun i poetit,
Do pushojë në Tiranë.
Kangët e tij të pavdekshme,
Trojeve shqipe anembanë.
Do t'i ndezin trimat prapë,
Skuqin gjak trollin ku ranë.

Ç'paska kanga që asht mekun?
Ç'ka sot Dibra që loton?
Naim Plaku paska vdekun!
Za bilbili ma nuk rron.
Dibrës lashtë maja, maja,
Si ai nuk ka kush i këndon.

Dibrës lashtë maja, maja,
Naim Plaku hee ku jeee!
Pse m'i lae n'gjysëm kangët?
Trimat vorresh kush i ngre?
Kangë e shpirt përjetësisë,
Trup i lodhun njësh me dhé.



Vlerësime për Naim Plakun

ENVER HYSA: Naim Plaku ishte një njohës shumë i mirë i të folmeve të Dibrës në përgjithësi, po dhe i të folmeve të shqipes. Naimin e karakterizonte seriozitet dhe ishte tipi i studiuesit që i përcillte njohuritë në sistem e jo në mënyrë të shkëputur. Po në fushën e gjuhësisë shqiptare, Naim Plaku mbeti, siç thotë Migjeni, një "kangë e pakëndueme", sepse, me gjithë dhuntitë mjaft të mira që kishte, nuk arriti ta zbrazte gjithë bagazhin gjuhësor, që kishte grumbulluar. Emri i tij jeton sot në qindra e qindra skeda në kartotekat gjuhësore të leksikut e të toponimisë të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, që mund të mjaftonin, ndoshta për të bërë një fjalor dialektor për trevat e vendlindjes. Kjo se ai arriti të gjurmonte fjalën e gjallë shqipe jo vetëm nga bisedat me të moshuar, po dhe me dijet e gjera që zotëronte vetë, për të folmet e zonave të tij të vendlindjes.

SHABAN SINANI: Unë e kam njohur Naimin në mesin e viteve 70', kur isha nxënës në shkollën e mesme pedagogjike të Peshkopisë. Në atë kohë kishte shumë pak shkrimtarë në Dibër. Prej asaj kohe unë e kam ndjekur në një mënyrë të vëmendshme veprimtarinë e tij dhe do të doja të veçoja, përveç shumë punëve të bukura në krijimtari, atë çfarë ai i ka kushtuar traditës gojore të popullit të Dibrës, traditës etno-zakonore dibrane, studimeve me karakter historiografik dhe etnologjik, krijimtarinë letrare në përgjithësi, sidomos poezinë. Por jo vetëm poezinë, ka edhe... publicistikë, tregime, folklor, ku të gjitha gjinitë letrare i ka shumë të vlerësuara.

XHAFER MARTINI: Naim Plaku na bashkoi me jetën, me këngën, por na bëri bashkë edhe me vdekjen. Këtë nuk e bëri thjesht, pse qemë, pse u mblodhëm për një qëllim, por pse qëllimi u pasurua me përmbajtje të re, me gjendje të re emocionale nga ato që krijojnë vetëm arti dhe artisti i madh.

ALI AHMETI: Mua dhe shokëve të mi, kur luftonim për të drejtat e popullit shqiptar, na jepnin zemër dhe na hidhnin në flakën e betejave këngët e mrekullueshme që këndonin Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula dhe të tjerë këngëtarë. Por në atë kohë unë nuk e dija që tekstet e tyre aq të fuqishme i kishte bërë Naim Plaku!

SHKURTE FEJZA: ... Ai i përket një plejade të artë të poetëve shqiptarë. Poezia e tij ka shpirt dhe i jep motiv kompozitorit, që të kompozojë, por edhe këngëtarin e frymëzon për të kënduar me shpirt. Ndoshta edhe vetë Dibra me historinë e saj, ka bërë që të jetë një vatër e madhe dhe mjaft e suksesshme artistësh të mëdhenj, të cilët kanë dhënë shumë për kulturën shqiptare. Në mesin e tyre shkëlqen emri i Naim Plakut.

FEJZULLA GJABRI: Në vëllimet e Naimit ka frymëzim vendlindor, dibran dhe gjithëshqiptar. Aty është lashtësia, aty burojnë mesazhet, aty ngrenë krye hulumtimet. Shkenca do t'i grupojë në: frymëzime poetike që këngëtari e ka të lehtë t'i kthejë në jone, gjuhëtari në toponomastikë, etnologu në etnologji e etnografi, dikush në histori, gjeografi, folklor etj. Të gjitha i gjen në veprën e botuar e të pabotuar të Naim Plakut.

Libra të rinj nga Naim Berisha



Naim Berisha
Sonete (*Përkthim*)
Botimet M&B
ISBN 978-9928-4397-4-1
Çmimi: 500 lekë



Naim Berisha
Kaleidoskop
Botimet M&B
ISBN 978-9928-4397-7-2
Çmimi: 500 lekë

Vlerësime për Naim Berishën

Naim Berisha shkruan pastër dhe pa estetizime e letrarizma të panevojshme. Deri tani e ka përballuar me sukses maratonën e pamëshirshme në hapësirën e poezisë, këtë vrapim të madh që është krejtësisht i pakorruptueshëm. Naimi premton shumë për të ardhmen. ***Dritëro Agolli (1996)***

Naim Berisha nuk vjen nga librat, por nga nëna. Ai mëson nga letërsia, por nuk imiton letërsi. Ashtu si në jetë edhe në krijimtari, ai është një zë i sinqertë, një talent gjenuin, veprat më të mira të të cilit, bëjnë pjesë në fondin më të mirë të letërsisë sonë. ***Teodor Laço (2010)***

Naimi ka gjetur rrugën për të bashkëbiseduar me lexuesit. Ai është origjinal dhe nuk përsërit as veten, as të tjerët, ndaj poezia e tij do të pëlqehet shumë.

Odhise Grillo (1995)

Poezia e Naimit është e veçantë. Ajo mbart historinë dhe filozofinë e Dibrës, vendlindjes së tij. Poezia N. Berishës ka identitet dhe mua më ka pëlqyer.

Fatos Arapi (1996)

Kënga e këtij poeti të ri nuk njeh kufij shtetërorë. Ajo troket në zemrën e çdo shqiptari, pasi ka marrë me vete aromën e kësaj toke të shenjtë, uturimën e furtunave që kanë kaluar mbi këtë truall. Lexojini me vëmendje poezitë e tij dhe do të vëreni se ato mbartin karakteristika të veçanta të shprehura me një figuracion funksional.

Bedri Dedja (1993)

Në prozë, Naim Berisha di të gërshetojë linjat kryesore të subjektit me detajet konkrete. Lirshmëria narrative, bukuria e shkrimit dhe prania aktive e autorit në rrëfim e bën prozën e tij të gjatë, konfidente dhe të dashur për lexuesin.

Gjovalin Kola (1996)

Mesazhet filozofike përcillen tek romani "Bjeshkët e dashurisë" të Naim Berishës, përmes një gjuhe të gjallë e të pasur dhe një stili elegant, që kushtëzon në bukurinë e shprehjes koncize dhe lakonike.

Fatmir Terziu (2010)

Naim Berisha është një zë origjinal jo vetëm në poezi, por edhe në prozë.

Behar Gjoka (2010)

Në romanet e tij Naimi operon me një stil modern. Ai gërryen në kuintesencën e pak personazheve. Në konfigurimin e plotë artistik romani i tij të shkakton kënaqësi estetike si një shëmbëlltyrë që të kënaq me rrëfimin lirik.

Hajri Mandri (2010)

portret

Ndërmendje në 103 vjetorin e lindjes së Selim Alliut, këtij burri të zëshëm

Selim Alliu, simbol i dijes, tolerancë dhe mirëkuptimit

Nga **HALIL TEODORI**

Dibra ka mbartur përgjatë krejt kohështrirjes së saj një nevojë për t'u çliruar nga verigat e paranojës së pushtimeve të gjata shekullorë, për t'u ngritur nga nënshtrimi i gjymtimit që trashëgoi nga e shkuara e hidhur dhe ia ka arritur kësaj përmes dijes. Ka qenë ajo, të cilën e mbartën dhe e trashëguan mësuesit, duke ushqyer brezat me dije dhe kombëtarizëm.

Kësokohe, më shumë se për gjithçka kishte nevojë për një dorë të paqët, ku me mençurinë dhe urtësinë që e karakterizonte, bëh ai, Selim Alliu, ish-mësues në Normalen e Elbasanit, partizan që mori pjesë në luftën Nacional Çlirimtare, dekoruar nga pushteti i kohës me titullin "Mësues i Popullit".

Selim Alliu, i vjen Dibrës në kohën e duhur, intelektual i paqtë dhe i arsyeshëm, që mundte të çante pa droje mes përmes terrin, si një shkëndi drite ngadhënjimtare dhe të flakadante si një moment shprese për Zerqanin që e lindi dhe Dibrën që e rriti këtë intelektual me vlera të mëdha .

Në kujtesën e historisë dhe arsimit, Selim Alliu mbetet ndër ato emra të veçuar, të cilët erdhën për të mbetur përgjithmonë si jetësorja e patjetërsueshme e që me punën e tij pasionante arriti t'i shndërronte ata në podin e famës.

Selim Alliu do të mbetet në memorien e të gjithëve si një testament i çmuar i arsimit ne vendin tonë.

Në karrierën e tij të gjatë që fillon qysh prej vitit 1934 kur mbaroi me rezultate të shkëlqyera Normalen e Elbasanit, akti i tij krijues përshkohet prej një filli shkëlqimtar fame që rrëzëlleu në më shumë se askush tjetër si ai. Dibranët arsimdashësit , miqtë dhe admiruesit e mbajnë në kujtesë dhe e mbulojnë me nderim dhe respekt këtë njeri të përkorë, këtë dishepull vlerash. Ai erdhi për të mbetur testamenti më i çmuar i arsimit shqiptar.

Gjithmonë inteligjenca e tij prej dishepulli dhe shërbyesi, shpërfaqej në botën e inteligjencës dhe dijes në Dibër si një vullnesë e mirë, si një motivim.

Selim Alliu, konsiderohet si një nga figurat dhe personazhet më të rëndësishëm të arsimit shqiptarë, ku, përgjatë gjithë rrugëtimit të vet tregoi vlera dhe fjala e tij e matur dhe me vend ishte si një prekje shëruse, si një balsam që paqton lëngimin, dhe qasej të mbante në jetë besimin tek populli dibranë e gjithë kombëtarë, të cilët i janë mirënjohës ndikimit pozitiv që mëshiroi, ai mësuesi i popullit Selim Alliu.

Ai ishte një ndër arsimtarët më të njohur në Shqipëri. Mbaroi me rezultate të shpëlqyera Normalen e Elbasanit dhe për shumë vite ju përkushtua luftës Nacional Çlirimtare ku mori pjesë aktive për çlirimin e vendit njëherësh si intelektual dhe si anëtar i zgjedhur i Këshillit Nacional Çlirimtare në Dibër.

Puna e palodhur si mësues i popullit te Selim Alliu njihet për një vërshim të vrullshëm dhe plot temperament. Tematika e gjithanshme dhe kumti krijues, e pozicionon atë në rendin e personaliteteve të njëmendta kombëtare, në fushën e arsimit e të dijes në Dibër.

Kontributi i tij është një vlerë e pazëvendësueshme e memories historike të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ndihemi të privilegjuar që i përkasim asaj zone që u ballafaqua me një vullnesë të mirë të këtij dishepulli të dijes në Dibër.



Selim Alliu është nderi dhe krenaria e Dibrës, ku ne gjeneratat e sotme përulemi me respekt për atë për çfarë ai punoi në ëndjen tonë të etur për dije e kulturë.

Selim Alliu bën pjesë në plejadën e intelektualëve dibrane dhe gjithëkombëtare që shkruan faqen më të rëndësishme të arsimimit te brezave te ri ne Dibër. Përkushtimi, karakteri, vendosmëria zgjuarsia e shënojnë, atë Selim Alliun si një pikë e rëndësishme e arsimit ne vendin tone.

Gjithashtu edhe si një sprovë e ngadhënjimit mbi një jetë gjithnjë të vështirë jo vetëm ekonomike, por politike, sociale, shoqërore dhe qe nuk refuzoi sikurse një here punën e pa lodhur ne shërbim të dijes në Dibër.

Kuvendi Popullor i Shqipërisë i ka dhënë titullin e madh "Mësues i Popullit".

Selim Alliu është nderi dhe krenaria e Dibrës ku ne gjeneratat e sotme përulemi me respekt për atë për çfarë ai punoi në ëndjen tonë të etur për dije e kulturë.

Me vullnetin e jashtëzakonshëm, me kontributin e pashoq, ai jo vetëm shkroi një faqe të historisë së krenarisë së vendlindjes së tij, Strikçan (Zerqan), por nguliti në memuarin e kohëve një përvojë, një sfidë dhe një mundësi të shpirtërore që këndon pambarim.

Deri në momentet e fundit të jetës së tij qëndroi me kokën lart, pa u ankuar, pa kërkuar privilegje dhe pa u fshehur pas emrit të madh.

Cilido që e njohu atë, njohu tek ai më të mençurin e miqve, e shokëve, e bashkëpunëtorëve të tij. Selim Alliu jetoi një jetë si një ikonë simbol i mençurisë dhe urtësisë. E gjitha kjo rrezatoi në mënyrën më të fuqishme në ditët e çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashist. Vlera për të cilat ai, që në rininë e tij të hershme, kishte luftuar i vendosur të sakrifikonte gjithçka, bazuar te liria e kombit.

Sa ma shumë kalojnë vitet, jam i bindur se me kohën, figura dhe personaliteti i tij vazhdojnë të marrin përmasat që ai kishte me të vërtetë, përmasa më të mëdha. Ai do të shndrisë gjithnjë e më shumë në botën shqiptare. Nuk mund të mos shprehem ndryshe veçse "në botën shqiptare", sepse Selim Alliu ishte një nga personalitetet, një nga figurat më poliedrike të kohës që jetoi dhe i tillë do t'u përcillet brezave dhe kohërave.

Ndër gjithë dimensionet e shquara të Selim Alliut, në qendër të tyre, do të shkëlqejë gjithmonë dimensioni i tij i lirisë. Pasardhës i një familjeje patriotike, ai pati fatin më të madh në moshën më të re, të marrë një nga vendimet më të rëndësishme të jetës së tij, të rrok armën e të dalë malit për liri, të luftojë me heroizëm pushtuesit, të luftojë me trimëri të madhe për çlirimin e trojeve shqiptare jo vetëm në Shqipëri por në Kosovë e Maqedoni, në të gjitha tokat ku jetonin e luftonin bashkëkombësit e tij.

Të dhimbshme, preokuponte, të dashura, të rëndësishme, ishin jo vetëm problemet e shoqërisë shqiptare në Shqipëri, por problemet e shoqërisë shqiptare në Kosovë, Çamëri,në Maqedoni....

Ndaj le të përulemi sot në 103 vjetorin e lindjes me nderimin më të madh para veprës së tij të ndritur dhe le të shprehim gjithashtu, krenarinë tonë, sepse sot, pas kaq vitesh, e gjejmë këtë burrë disa herë më të madh sesa ditën që u nda nga ne.

Selim Alliu figura qendrore e arsimit në Dibër u lind në vitin 1914 në fshatin Strikçan të Zerqanit. Ai Selim Alliu mbaroi Internatin e Kastriotit në vitin 1928 me rezultate të shkëlqyera. Ndërsa në vitin 1934 mbaroi po me rezultate të shkëlqyera Normalen e Elbasanit.

Është shquar për rezultate të larta në mësime si dhe krijues letrar me shije të vërteta artistike.

Shkrimet e tij ishin skica letrare dhe novela, si :

"Gjaku i malë-sorëve",
"Lulëkuqja e çuditshme",
"Agai i fshatit",
"Ku dergjen dëshmorët",
"Dashuria ime"etj. e që i botoi në revistën "Normalisti" e cila u drejtua për një farë kohe nga ai.

Ka punuar si mësues në Pepel, Gjirokastër, kryemësues në Trebisht – Gollobordë, mësues në Ushtrimoren e Elbasanit, drejtor i shkollës së Zerqanit, shef i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës të Qarkut Dibër, në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës, shef i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit Dibër dhe drejtor i Gjimnazit të Peshkopisë, deri sa doli në pension, në vitin 1974. Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në zhvillim dhe përparimin e arsimit, në vitin 1979, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë iu dha titulli më i lartë "Mësues i Popullit".

Vdiq me 13 korrik 1977 duke lënë një emër të rëndësishëm në historinë e traditat e Dibrës në përgjithësi dhe Zerqanit në veçanti. Me ikjen të gjithë lënë një boshllëk, por ikja e mësuesit, edukatorit, dijeshumit, të urtit dhe të mirit Selim Alliu bën pjesë në ikjet që lë një boshllëk dhe një dhimbje, të cilën rreket ta mbushi malli dhe kujtimet.

Emin Jashari, mësuesi i Maqellarës

Emin Jashari është ndër mësuesit më të vjetër të Maqellarës. Për rreth 40 vite mundi dhe djersa e tij u derdhën për një kauzë të madhe, atë të edukimit të brezit të ri që pa dyshim ka dhënë rezultatet e veta. Së bashku me Shaban Asllanin, Petrit Miftarin, Sulbie Poturin, Lirie Kërkutin, Tule Liçajn, Qani Tafçiun, Xhevrie Brahajn, Tefta Shehun, Liljana Skukën (Neziri), Ilmi Kallçishtën, Sere Skarrën, Ylvije Strazemiri, Drita Xholi e qindra mësues të tjerë arritën që shkollat e Maqellarës të jenë shembull i një përvoje të përparuar në rrethin e Dibrës. Nga duart e tyre kanë dalë kuadro si Rakip Dançe, Musa Rama, Adnand Gjoli, Basri Neziri, Xhevat Dani, Qemal Skuka, Bilbil Qoku etj. që kontribuan në shumë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, arsimit e kulturës.

Nga dy mësues me arsim pedagogjik, që kishte Maqellara në vitin 1952, sot ka 15 kopshte me 401 fëmijë të cilët i mësojnë 15 edukatore, katër shkolla 9vjeçare me 1524 nxënës dhe 114 mësues, një shkollë të mesme me 387 nxënës me 24 mësues. Shumica e personeli pedagogjik që punojnë në Maqellarë janë me arsim të lartë dhe arsim përkatës pedagogjik, pjese dërmuese femra dhe në moshë të re.

Emini, i biri i Shahin Jasharit nga Kovashica e Maqellarës lindi më 24 Qershor 1929. Familja e Jasharëve është e njohur në Dibër për veprimtari patriotike e atdhetare brez pas brezi.

Ajo u shqua për luftën kundër turqve, austriakëve, serbëve, mbrojtjen e Revolucionit demokratik borgjez 1924; Ndihmesë të veçantë dha gjatë luftës Nacional-çlirimtare që nga pjesëmarrja aktive e deri transportin e vlerave monetare nga familja Lleshi për Çetën e Pezës si njerëz të besës e trimërinë e treguar në aksionet e çetës e batalionit partizan të Dibrës. Shtëpia e tyre në Kovashicë ishte një bazë e e rëndësishme e Luftës, ishin edhe dajat e Halit e Aqif Lleshit.

Shkollën fillore Emini e kreu në Kovashicë (ajo u hap në 1936). Mësuesit e tij ishin Barjam Nura nga Kosova, Ylli Seva nga Gjirokastra, Abas Xhafa (nga Kovashica e Shupenzës), Adem Shehu nga Vlesha e Sllovës.

Pas një ndërprerje si pasojë e luftës filloi shkollën unike (7 vjeçare) në Peshkopi me bursë shteti më 1945 për të vazhduar pa ndërprerje shkollën Pedagogjike duke e mbaruar atë më 1952. Ai pati fatin të jetë pjesë e maturës së parë të Pedagogjikes.

Më entuziazëm e vrull filloi punën si mësues në 7 vjeçaren e Maqellarës (ajo u hap më 1947); shpejt u bë edhe Drejtor i saj deri më 1954. Me 12 prill 1954 shkoi si Drejtor shkolle në Selishtë (shkollë verore), më 1956 Drejtor shkolle në Muhurr (6 muaj), në shtator u rikthye në Maqellarë, pas 1 viti drejtor shkollë në Sllovë, gusht 1957 deri me 1 shtator 1958. Më 1960 mbaroi Institutin Ped. Aleksandër Xhuvani në degën gjuhë-letërsi;

Pas mbarimit të institutit u emërua në Komitetin Ekzekutiv të rrethit si inspektor arsimi, pas 1 viti dha mësim 5 vjet në shkollën 12 vjeçare Demir Gashi, Peshkopi; 14 vjet brodhi shkollave të Dibrës, punoi me ndërgjegje e përkushtim në zonat e thella e larg familjes.

Së bashku me mësuesit e tjerë në shkollat e zonat ku punoi, dhanë një ndihmesë të madhe për zhdukjen e analfabetizmit, zgjerimin e arsimit 7 vjeçar, përmirësimin e mënyrës së jetesës në zonat e thella, gjallërimin e jetës kulturore në fshatrat e tjerë.



Emin Jashari ishte ndër mësuesit e dashur e të respektuar në Maqellarë. Ndihmoi mjaft mësuesit e rinj nëpërmjet përvojës që kishte fituar, por edhe të asaj përvoje në shkallë rrethi që e njihte dhe përpiqej ta përgjithësonte në shkollë e jashtë saj.

Me pasion ai aktivizoi tek shkollat nxënësit e të rinjtë në veprimtari sportive. Kishte prirje e kishte prirje e rezistencë në vrapimet e gjata qysh kur ishte në Pedagogjike.

Më 20 mars 1951 kish zënë vendin e parë në krosin pranveror në qarkun e Dibrës. (Gazeta "Sporti Pop." 6 prill 1951).

Më 2 shkurt 1966 filloi punë në Maqellarë deri më 1988 kur doli në pension. Në shkollë e jashtë saj ai ka patur marrëdhënie të mira me nxënësit, prindërit e kolegët. I rregullt, korrekt, sistematik, i disiplinuar Emin Jashari ishte ndër mësuesit e dashur e të respektuar në Maqellarë. Ndihmoi mjaft mësuesit e rinj nëpërmjet përvojës që kishte fituar, por edhe të asaj përvoje në shkallë rrethi që e njihte dhe përpiqej ta përgjithësonte në shkollë e jashtë saj. Gjeneratat që kaluan nëpër duart e Eminit ruajnë kujtimet më të mira për jetën shkollore; ata janë mirënjohës për këshillat, porositë dhe mësimet e tij për tu bërë të aftë për veten, familjen dhe shoqërinë.

Si veprimtar shoqëror punoi pa u lodhur me njerëzit, kategoritë e të gjitha moshave, ai ishte njeri i muhabetit, i aksionit, i unitetit, i matur, aktiv e krijues, shumë i apasionuar pas gjuetisë.

Pas daljes në pension, si shumë dibranë Emini erdhi në Tiranë. Familja dhe fëmijët e tij janë një shembull i mirë i bashkëjetesës në lagje, qytet, kudo ku punojnë e jetojnë.

Pas pak ditësh ai mbush 88 vjeç, si mësues veteran në përvjetorin e shkollave të Maqellarës, i urojmë jetë të gjatë e të lumtur!

Zabit LLESHI, Demir OSMANI

Ibrahim Kika, 97-vjeçari nga Valikardha e Zerqanit, i infiltruar nga komunistër në sekretarinë e Konferencës, tregon ngjarjet e atyre viteve, në një rrëfim ekskluziv për gazetën "Rrugën e Arbërit".

Nga i infiltruar në bashkëpunëtor, letra anonime nga vendlindja: "Ka bashkëpunuar me Ballin Kombëtar"

Nga **HYSEN LIKDISHA**

(vijon nga numri i kaluar)

Pjesëmarrja në Konferencën e Zall Herrit e organizuar në tetorin e 1943 nga fronti nacionalist BK dhe Legaliteti, të ndihmuar edhe nga paria e vendit, ku u vendos formimi i qeverisë së përkohshme në qytetin e Peshkopisë, ku komunistët më infiltruan për të qenë syri dhe veshi i tyre, nuk kaloi pa pasoja për të ardhmen time. Nisur nga mosha e re, pjesëmarrja në formacionet partizane për çlirimin e vendit, anëtarësimi në parti, I mendoja si tregues mjaft pozitiv për të ardhmen time. Aq më tepër me fitoren e LNÇL, kjo bindje mu përforcua akoma më tepër. Por përkundër kësaj, e kaluara ime, konkretisht pjesëmarrja në Konferencën e Zall Herrit, më solli mjaft pasoja, gjë të cilën as që e mendoja. Fundi i '43 dhe '44 deri në çlirimin e vendit, vijova pjesëmarrjen në LNÇL partizan në Brigadën e 18-të Sulmuese. Pas çlirimit të vendit mbarova shkollën e ndërlidhjes në Tiranë, e cila vijoi për 17 muaj, ku përgatiteshin kuadro nënoficerë për ushtrinë. Me mbarimin e kësaj shkolle, në vitin 1946 emërohem instruktor i ndërlidhjes për përgatitjen e radistëve në Divizionin e 8 të Korçës, me komandant Beqir Balluku dhe komisar Panajot Plaku. Isha i ri dhe plot energji e vullnet për punë, gjë që më bëri t'i kushtohem me mish e shpirt punës për përgatitjen e radistëve të këtij divizioni. Kur mendoja sakrificat dhe kontributin që kisha dhënë në dobi të luftës për çlirimin e vendit, si dhe përkushtimin dhe ecurinë e mirë të punës për përgatitjen e radistëve, nisur dhe nga mosha e re, kurrsesi nuk më kishte shkuar ndër mend, se një ditë të bukur e kaluara ime mund të vihej në diskutim, aq më tepër të akuzohem si bashkëpunëtor me ballistët pra antikomunist.

INCIDENTI ME PANAJOT PLAKUN.

Panajot Plaku: Kemi sjellë ujkun nga mali, që të na hajë dhentë.

Ibrahim Kika: Ujku nga mali, ka ardhur pa dhëmbë

Kur mendoja se çdo gjë po shkonte në favorin tim, për të ecur përpara pa pengesa, krejt pa pritur dhe kujtuar, ndodhi e papritura. Më bëjnë me haber se komisari Panajot Plaku, më kërkonte në zyrë. – Për çfarë mund të më kërkojë, mendoja me vete? -Çfarë nuk bluante truri në ato momente: Të më caktojë me një detyrë tjetër? Të më ngarkojë me mision zbulimi në kufi, si ajo që kisha kaluar në Zall Herr? Ku nuk shkonte mendja, por jo tek arsyeja e vërtetë për të cilën ai më thërriste!

Anëtar i partisë isha që në 1946-tën. Dhe përsëri niste filli i hamendësimeve: Të më caktojnë në një detyre tjetër, qoftë edhe më e lartë, unë sapo kisha filluar punë dhe ku në zyrën sekrete të ndërlidhjes? -Përse pra mund të më ketë thirrur, përse?! -E vetmja gjë në ato momente që nuk më erdhi në mendje, nxitur kjo dhe nga mosha e re dhe kontributi që kisha dhënë në LNÇL, ishte ajo për të cilën unë isha thirrur, për tu akuzuar si i përfshirë me BK kundër komunistëve dhe LNCL. Krejt i emocionuar me shpejtësi për të mësuar sa më parë për enigmën e kësaj thirrje të beftë nga komisari.

Pasi bëjmë ftohtë përshëndetjet e rastit, Komisari i Divizinit, Panajot Plaku, drejtohet në karrige, duke lëshuar drejt meje pyetjen e parë:

–Keni gjë hasmëri apo inate me Qamil Dishën, (ish Kryetar i Komitetit Shupenzë, në atë kohë)?



Letra anonime nga fshati për bashkëpunim me tradhtarët. Kthimi në Tiranë dhe takimi me Haxhi Lleshin, Zoi Themelin dhe Dalip Gurrën. Dëshmia që e shpëtoi nga dënimi...

- Jo i them, ashtu shpejt i befasuar nga pyetja e parë që lëshoi -pa e ditur se pse po ma ban këtë pyetje.

– Po me Musa Lalën, si ke shkuar?

–As mirë as keq – i them.

–A ke qenë i angazhuar me Ballin?

– Po i them, -vetëm 1 vit kur kam shërbyer si xhandar i thjeshtë, për të ushqyer familjen me bukë, se isha djali më i madh i shtëpisë. Në asnjë rast apo moment, nuk kam luftuar kundër partizanëve, por kam qenë i angazhuar totalisht me ta.

-Me këtë që shkruajnë autoritetet vendore të zonës, t'i duhet të dorëzosh zyrën sekrete ku punon dhe të përjashtohesh nga partia. Në këto kushte, -vijoi fjalën ai, i bie që ne të kemi sjellë ujkun nga mali, për të na hëngër delet.

Të them të drejtën në atë moment më erdhi zyra vërdallë, nuk dija ku ta nisja muhabetin. Ashtu vetimthi, siç isha ulur ngrihem në këmbë duke i thënë:

-"Ujkut për të cilin ju flisni, ja kanë hequr dhëmbët shoku komisar". – Jam angazhuar në formacionet partizane që në '43 e deri në çlirimin e vendit, dhe në parti jam pranuar në '44 dhe deri më tani nuk kam asnjë vërejtje apo masë tjetër ndëshkimore në kartën e regjistrimit. – Sa për pjesëmarrjen me Ballin, unë kam letrën e firmosur nga Isuf Sula, Zoi Themeli dhe Dalip Gurra, e cila konfirmon se që nga 1943, kam qenë i angazhuar në formacionet partizane dhe kam punuar për partinë. Madje kjo letër mban edhe vulën e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe është në dijeni edhe ish komandanti i Batalionit Partizan të Dibrës, Haxhi Lleshi.

–Mirë, atëherë kjo mbetet për tu provuar?!

Më vonë, kur gjithçka në lidhje me këtë letër u sqarua, jam takuar me Qamil Dishën dhe e kam pyetur mbi autorësinë e kësaj letre. – Ibrahim, më thotë ai, -isha i detyruar ta përcillja këtë informacion pasi pothuaj për çdo ditë në zyrën time vinin individë dhe grupime personash nga vendlindja jote Valikardha, që siç duket të përfshirë nga ethet e cmirës, denonconin përfshirjen tuaj me BK. Ndaj isha i detyruar që ta përcjell këtë informacion, për të hedhë dritë mbi të vërtetën. Dhe më bëhet qejfi tani kur çdo gjë u qartësua dhe foli në të drejtën tuaj. Duke të uruar gjithë të mirat, nuk besoj të na kesh keqkuptuar.

KTHIMI NË TIRANË DHE TAKIMI ME HAXHI LLESHIN, ZOI THEMELIN DHE DALIP GURRËN.

Letra e ardhur nga baza e partisë, ku akuzohesha si i përfshirë me BK, duhej përgënjeshtruar me fakte. Kështu për të provuar të kundërtën, mu desh të kthehesha në Tiranë për të kontaktuar me Haxhi Lleshin, Zoi Themelin, Isuf Sulën dhe Dalip Gurrën, të cilët ishin ideatorët dhe autorët që më kishin dërguar në Konferencën e Zall Herrit, për të qenë atje syri dhe veshi i komunistave. Fillimisht shkoj për tu takuar me Haxhi Lleshin.

–Më duhet një letër me firmën tuaj ku të konfirmoni se përfshirja ime në Konferencën e Zall Herrit, është bërë me dijeninë tuaj, - i them. Më pa ashtu krejt ftohtë, me shikim të hedhur kushedi se ku, gjë që dinte ta bënte mjaft mirë si askush tjetër vetëm ai.

–Shoku Haxhi, - besoj e mbani mend takimin në shtëpinë e Ramiz Murrës në Shupenzë, ku në prani edhe të Zoi Themelit, Isuf Sulës, e Dalip Gurrës, ju shpalosa përpara në tavolinë proces-verbalin e mbajtur në Konferencën e Zall Herrit, gjë për të cilën edhe më falenderuat. Pasi vijoi të më vështronte krejt ftohtë, më thotë: -Nuk të kam çuar unë, tha! Mbeta krejt i shtangur. – Si mund të jetë njeriu kështu? -Sa të madh e konsideroja gjatë luftës këtë njeri dhe sa i vogël mu duk në këtë moment. I zhgënjyer, me sytë mjegull e këmbë të këputura ec në bulevardin e Tiranës, për tu takuar me Zoi Themelin.

Duke ecur në qendër të Tiranës, takoj toger Dalip Gurrën. Përqafohemi me Dalipin dhe futemi në një klub për të pirë kafe. Pasi pyetemi e rrëfehemi me Dalipin, ai më drejtohet duke më thënë: - Ibrahim si i trazuar më dukesh? -Po i them, jam i mërzitur sa nuk ka ku të shkojë dhe nis e i tregoj për hallin e ardhjes në Tiranë. Pasi më dëgjon me vëmendje për hallin që më kishte detyruar për të ardhur në Tiranë, pa e bërë dysh fjalën thotë: -"Mos u bëj merak fare, pasi pjesmarrja jote në Konferencën e Zall Herrit, u bë për llogarinë tonë që të marrim vesh se çfarë do vendosej në atë konferencë nga nacionalistët dhe kjo është krejt e qartë si drita e diellit dhe askush nuk mund ta errësojë një gjë të tillë. Pasi marr deklaratën nga Dalipi, drejtohem për tek Zoi Themeli. Punonte në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Sapo më pa më drejtohet: - hë mor pallosh groshe, ç'e mirë të paska sjellë deri këtu?

- Mos pyet, -i them dhe i tregoj për Haxhi Lleshin. Në këtë kohë Zoi ishte drejtor i Sigurimit të Shtetit. –Ibrahim, - më drejtohet Zoi. –Mos e bëj gajle fare dhe më jep të firmosura dy letra. – Njërën e ke për komandën e Divizionit të Korçës dhe tjetrën ma dha të mbyllur në zarf për Panajot Plakun, ku më porosit për t'ia dhënë në dorë. Aty në praninë time mori në telefon Beqir Ballukun dhe pasi foli për historinë e "përfshirjes" time më ballin, - i tha: -"Ky që të tregova shkurt ne telefon, është pra Ibrahim Kika, "ujku i maleve, që na ka ardhur për të na hëngër delet".

Çuditërisht fati e deshi, që të gjej në valixhen time që e kisha lënë në Tiranë, tek një i afërmi im që nga koha kur vazhdoja shkollën e ndërlidhjes, letrën origjinale të firmosur nga Isuf Sula, Zoi Themeli dhe Dalip Gurra, për përfshirjen time në Konferencën e Zall Herrit.

Kthehem në Korçë dhe krejt serbes shkoj në zyrën e komisarit të divizionit, Panajot Plaku, për ta vënë në dijeni me dy letrat e marra nga Tirana. I zhgënjyer dhe ftohtë më thotë: t'i je i dyti Ibrahim i Korçës, pas Ibrahim Kovaçit.

BOTIME M&B



HISTORIA E DIBRËS

KRISTO FRASHËRI

Akademik Kristo Frashëri: "Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës, - kam dashur të shoqëroj dhe mendjen. Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor. Por Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa ia kam arritur."



KANUNI I DIBRËS

Trashëgimi etnojuridike

XHAFER MARTINI

Kanuni i Dibrës vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit" dhe me "Kanunin e Skënderbeut" (me variantet dhe invariantet e tij), – "Kanuni i Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t'i gjeni në "Hyrjen" e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshëm, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës – papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t'i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, – Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje "të nxehta" si "gjakmarrja", "hakmarrja", "gjaku", "xhipi"etj. Një tjetër "avantazh" i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik. "Kanuni i Maleve të dibrës" është dëshmia monumentale e asaj "atlantide" civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit.

www.facebook.com/ M&B - Botime dhe Studio Grafike / www.mbbotime.com
Për porosi: botimemb@gmail.com
Cel: 069 20 68 603

recensë

Demir Rusi promovon dy libra
me mesazhe aktuale

Dhimbja për djemtë kufomë-prishur të mbetur deteve

Nga **HALIL RAMA**

Promovimi i dy librave të shkrimtarit dhe publicistit Demir Rusi, në mjediset piktoreske të resortit "Merlin Park" u shndrrua në një manifestim të shkëlqyer kulturor. Jo vetëm për praninë e qindra intelektualëve, poetë, prozatorë, publicistë e personalitete të shquara të fushave të ndryshme: gjeneralë, kolonelë, juristë e mjekë, por dhe për mesazhet aktuale që përcolli kjo veprimtari promovuese.

I moderuar me mjeshtri dhe profesionalizëm të rrallë nga gazetari i talentuar, Defrim Methasani, ky promovim është ngulitur thellë në memorien e qindra pjesëmarrësve. Si rrallë herë, pa ndonjë skenar paraprak, ai do t'ia jepte fillimisht fjalën redaktorit Namik Selmani – gazetar dhe shkrimtar i njohur për të bërë një prezantim të shkurtër të dy librave mjaftë cilësorë të kolegut Rusi.

Nëse në librin e parë me titullin sinjifikativ "Djali që bleu vdekjen", sipas recensentit Selmani, "Mbetet në gjithë sipërfaqen shkronjore dhimbja, mbetet drama, mbeten viktimat dhe fajtorët e një tragjedie që quhet kurbet i paligjshëm. Mbetet emocioni i rrëfimit...", për vëllimin poetik "Ura e fjalës", në pozicionin e redaktorit, ai pohon se "Poezia e Demir Rusit është trashëgimia e bukur që mund të gjesh në gjuhën shqipe".

Në të njëjtën linjë e vlerësoi krijimtarinë produktive e cilësore të Demir Rusit edhe shkrimtari e publicist H. Rama, duke evidentuar kulturën e lartë gjuhësore, në ditaret, përshkrimet e poezitë e tij.

Për profilin e veçantë krijues të D.Rusit foli më pas dr.Hajri Mandri, poet, publicist e studiues.

Dhe ai që la mbresa te të gjithë pjesëmarrësit qe padyshim Gjeneral Rrahman Parllaku - Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit. Si një enciklopedi e gjallë që mbart peshën e 98 viteve jetë, pikërisht në kohën kur duket haptazi se ka humbur disi interesimi i brezit të ri për librin, duke rendur pas rrjeteve sociale, Parllaku do të evidentonte domosdoshmërinë e rikthimit tek libri. Midis të tjerash



Autori është mjaft bindës në konkluzionin për ekzistencën e të gjitha mundësive që Italia dhe Shqipëria të kthehen në simbole të vërteta miqësie e solidariteti.

ai tha se janë dashuria për librin, e pandarë që nga fëmijëria e deri në këtë moshë, por edhe angazhimi për të lënë të shkruara si trashëgimi për brezat gjithë historinë e tij të lavdishme, të kohës kur drejtonte njësitë më të mëdha partizane dhe më vonë ato të ushtrisë shqiptare, si dhe kujtimet për shokët, që kanë ndikuar dhe ndikojnë në profilin e tij të admirueshëm intelektual e njerëzor.

Më pas, dy botimet dinjitoze të Demir Rusit u vlerësuan nga përfqësues të "Mendimit pozitiv", që kishin ardhur nga Prizreni e Gjakova, por dhe nga personaliteti i jurisprudencës, Fehmi Abdiu, nga gjenerali në pension Ismail Shulku e nga disa miq e shokë të autorit. Një përshëndetje miqësore i drejtoi atij edhe kreu i Shoqatës Atdhetare-Kulturore "Bulqiza", z. Bashkim Lami, ndërkohë që me vëmendje të veçantë u ndoq nga pjesëmarrësit edhe përshëndetja e vëllait të autorit, avokatit Baftjar Rusi.

Vlerësime inkurajuese për autorin bënë edhe Dr.Nazmi Koçi si dhe miku e bashkepunetori i tij i ngushte, Sokol Agolli. Ata evidentuan veçanerisht vlerat e familjes arsimdashëse e atdhetare RUSI, të brujtura e transmetuara me dashuri nga brezi në brez, për vite, dekada e shekuj të tërë.

E përbashkëta e këtyre vlerësimeve konsiston në dobinë më të madhe të rrëfimeve brilante te libri "Djali që bleu vdekjen", rrëfime këto që mund të kthehen në një vlerë letrare në një novelë, në një roman, në një film, në një dramë a një cikël me poezi. Dhe "të latuara" mjeshtërisht në fazën e ribotimit nga redaktori Selmani, këto rrëfime marrin vlera shumëdimensionale. Kjo për faktin se Demir Rusi prezantohet si vëzhgues i mprehtë i realitetit shqiptar dhe atij italian. Në këtë botim produktiv dhe cilësor rrëfehet intelektuali që përjetoi strese të fuqishëm shkatërrues, por që nuk u tundua nga grishja për veprime aventurore në fushën e kontrabandës mafioze... ,rrëfehet intelektuali i mirëfilltë që kishte shërbyer me devotshmëri si oficer dhe si publicist ushtarak e si kryeredaktor i gazetës "Minatori", të cilin koha e gjykoi së mbrapshti, duke e dëbuar nga puna me motive krejt absurde dhe pa asnjë mbështetje, as juridike dhe as logjike.

Duke përshkruar si askush tjetër emigranët që i janë lënë rastësisë, të jetojnë ku të mundin e si të mundin, të fituar apo të humbur, të gjallë apo të vdekur, pa një mbrojtje juridike siç e kërkojnë Kartat Ndërkombëtare, D.Rusi shpreh njëherazi dhimbjen për djemtë e mbetur deteve, kufomëprishur, ushqim për peshqit!. Ndjeshmëria e mërgimtarit shprehet qartësisht sidomos në rrëfimin për hollësitë e asaj nate pus të zezë në Grykën e Otrantos.

Në librin "Djali që bleu vdekjen", (si edhe në vëllimin poetik) autori dallohet dhe për gjuhën e pasur në përshkrimin e personazheve dhe sidomos të miqësisë së tij me profesorin e nderuar italian, Xhovani Karbone. Pikërisht kur shpreh admirimin, respektin e mirënjohjën për këtë personalitet të shquar italian, teksa ai e takon me një nga miqtë e tij që kishte shërbyer në Shqipëri gjatë luftës së lavdishme nacionalçlirimtare, evidenton edhe kontributin e partizanëve të batalionit "Antonio Gramshi" dhe veçanërisht heroizmin e Tercilio Kardinalit. Dashuri të pakufishme shpreh autori sidomos për nënat që janë njësoj në gjithë botën, që një emër dhe një zemër kanë.

Duke lexuar më vëmendje librin e D.Rusit "Djali që bleu vdekjen", edhe më pesimisti gjen forca për t'u bërë optimist, pasi përvoja e tij jetësore na mëson se "njeriu duhet të bëhet i fortë dhe t'u bëjë sfidë vështirësive që i dalin përpara; duhet të jetë optimist nëse dëshiron t'i mposhtë pengesat...Edhe kur është keq, njeriu nuk duhet t'i nënshtrohet së keqes....". Ndërkohë autori është mjaftë bindës në konkluzionin për ekzistencën e të gjitha mundësive që Italia dhe Shqipëria të kthehen në simbole të vërteta miqësie e solidariteti.



TREGIMET E DRINIT / DIONIS XHAFA

Mort në fshatin e largët

Isha i vogël në atë kohë. Kishte mbaruar shkolla dhe se tanimë vinin pushimet e verës. Më pëlqenin shumë këto pushime, pasi më shpesh shkoja te dajat e mi, që ishin larg, shumë larg zonës ku banoja unë dhe familja ime. Unë isha i vetmi që shkoja shpesh te dajat e mi, ndryshe nga gjithë pjesëtarët e familjes sime. Në fakt, unë isha bërë kështu edhe i preferuari i dajave, më njihnin në fshatin atje dhe më respektonin si mysafir special si të thuash. Këtë herë që do të nisesha, në fshatin e largët të dajave, që në fakt sërish ishte në rrethin e Dibrës, do të shoqërohesha edhe nga ana e familjarëve të mi, nga ana e atyre të afërt shumë, trungut familjar. Më saktë, mamaja dhe nga vëllai e motra. Udhëtimi ishte pjesa që e kisha shumë merak realisht. Anëtarët e familjes mua më linin atje për 2 a 3 muaj dhe se gjëja që më bezdiste më shumë ishte ai udhëtim, që në të vërtetë ishte realisht i tmerrshëm do thosha, sidomos për kushtet e atyre viteve.

Udhëtimi më dukej kaq i tmerrshëm, sa nuk kalonte ditë që nuk e kujtoja si diçka jo të dëshirueshëm kur isha në fshatin e dajave. Madje, atë kisha frikë, shkuarjen atje dhe pastaj kthimin, pasi më pëlqente shumë ai vend, ku kishte argëtim, male e fusha të gjëra. Nejse, të dal në thelb. Udhëtimi që kur nisi, si gjithmonë kisha frikë. Udhëtoja zakonisht me furgon dhe se rruga qoftë nga Maqellara në Peshkopi, por sidomos nga Peshkopia në Sllovë ishte tmerr më vete. Ja, kjo ishte rruga që duhet të përshkruaja dhe që në ato vite ishte e rëndë, mbushur me vapë, me pluhur e me pritje pa fund në qytetin e Peshkopisë, pasi kishte një orar të caktuar dhe shpesh vonohej dhe ai orar, për shkak se duhet të ishin që të gjithë pasagjerët. Pjesa e parë u përmbush dhe me zor arritëm në Peshkopi. Aty jemi herët dhe shëtisim thuajse gjatë gjithë ditës nëpër qytet. E pas kësaj sakrifice të mundimshme, një më e rëndë është në sfond. Mbaj mend sasa e rëndë ishte ajo rrugë e gjatë, atëherë e shkatërruar thuajse totalisht, që shpesh bëhej pluhur i madh dhe ngjante sikur po ecte ajo makinë e stërmadhe nëpër shkretëtirë. Po ishte tmerr edhe më i madh një rrugicë e ngushtë pranë liqenit në Shtumbat, ku makina e stërmadhe lëkundej dhe dukej sikur do të bjerë në njërën atë në atij liqeni.

E më e rëndë akoma ishte se kur kam qenë i vogël, pikërisht në Maqellarë, kishim rrugën afër dhe se pati vdekur një djalë i ri në moshë, që ia përplasi kokën makina në rrugë të madhe e se ai me origjinë ishte diku nga një fshat në Kastriot dhe rrugës, paksa larg mund t'ia dalloje varrin edhe atij djali. Shihja shokun tim pra që nuk ishte më, por tanimë ai ishte veçse një pllakë mermeri. E tmerrshme mendoja se edhe unë mund ta kem kushedi një fat të tillë, pasi gjëja më e frikshme që mendoja ishte fakti se jeta ime nuk ishte në dorën time, por të shoferit!

Gjithsesi, ne shkuam në fshatin e dajave të mi, të gjithë si familje. Familjarët e mi qëndruan për pak kohë dhe ikën ditën e dytë ose të tretë, ndërsa unë qëndrova si gjithmonë. Pas nja shumë ditësh, pasi kaloja paksa mirë, por shpesh edhe mërzitesha ndoshta dhe luaja për të shtyrë kohën, pikërisht nga ftoi ku kisha lidhur litarin e kolovarëses, shoh poshtë në sheshin qendror të fshatit. Unë arrija ta shihja sheshin që aty, nuk e kisha larg. E afrova dhe më tej shikimin. Ishte ora diku 14.00 dhe se ishte diell i madh e pika e vapës. Avash-avash po ndihej se diçka e pazakontë ishte duke ndodhur. Afër meje erdhën edhe daja, së bashku me gjyshen nga ana a mamasë, si dhe gruaja e dajës. U mblodhëm të gjithë. Unë pashë diçka jo të zakontë për moshën që kisha.

Në mes të fushës, aty ku ishte pluhur i madh, përpara shkollës së fshatit, u mblodhën shumë njerëz. Kalonin njerëz të shumtë. Ata kishin mbi duar një arkivol. Po një arkivol, pasi prapa shkollës ishin varrezat.

Atëherë dëgjoj të afërmit e mi, që mua më kishin nip dhe ata thoshin me vete dhe me zë të ngritur se ai arkivol mbante trupin e një djali që kishte ardhur nga Greqia sa mbaj mend. Kishte vdekur në punë ose ishte kapur duke vjedhur ndoshta dhe e kishte vrarë pronari. Një nga këto histori ishte e se cilado të ishte historia, mu duk e trishtë shumë. Shihja nga larg një arkivol, që dukej i kuq, pasi e kishin mbuluar me flamur kombëtar e se njerëzit ecnin burrnishëm në heshtje. Atëherë ishte periudha e emigrimit të madh, kur njerëzit kishin lënë katandi e shtëpi dhe ishin turrur drejt shteteve perëndimore, si e si të gjenin para dhe të mbanin familjet me bukë, më e pakta, sidomos në këto zona. Jo vetëm në këto zona, por në mbarë qarkun e Dibrës varfëria ishte realisht e madhe. Më erdhi të qaj, por edhe u përmbajta disi. Më erdhi mirë që në atë moshë fillova të kuptoj disi jetën, sa e trishtë dhe e dhimbshme ishte ajo.

Kur pas nja dy orësh shkova poshtë në fushë dhe se do luanin djemtë e fshatit, në fakt u bashkova edhe unë. Por ndëra të tjerët luanin me qejf, mua më kishte ngelur mendja te ai arkivol, te ai flamur, te ajo fushë e mbushur me njerëz hallexhinj, që vajtonin fatin e trishtë te vetin. E ajo pamje nuk bënte të më shqitej, edhe kur e kisha unë topin. Isha përhumbur, duke menduar se një jetë ishte nën dhe e se ne luanim futboll, pas një ore apo dy, sikur asgjë mos të kishte ndodhur. Ishte në fakt një moment që më dëshpëroi, shumë jashtë mase. Ndjeva dramën e fshatit të dajës sim, dramën e krahinës së Dibrës, dramën e madhe të popullit shqiptar që e ka shoqëruar dhe po e shoqëron edhe në këto kohë "moderniteti".

Cilido që e njeh mjekun Kurt Kurti zbulon tek ai thjeshtësinë, nderimin për shokët, urtësinë, dashurinë për vendlindjen,

Intelektual i vlerave dhe përkushtimit **për jetën**

Nga **MEVLUD BUCI**

Krenaria dhe thjeshtësia, dy tipare të çmuara njerëzore, dy shina jete, të cilat, siç thotë populli, lum kush i ka. Krenarinë e ka intelektuali i përkushtuar, i urtë e zemërdlirë. Thjeshtësinë e ka po ky, por që djersë e shpirt i ve në sherbim të popullit, të jetës, të njerëzve në nevojë.

E dha mirësia, si i thonë, të njoh mjekun Kurt Kurti, birin e Shkallës së Xibrit të Matit, për atë që kisha dëgjuar për punën dhe provat në sherbim të detyrës. Vërtetë del ajo që thotë mençuria popullore: Me të mirin të pjek fati... E kur takon njerëz të mirë e fisnikë, si mjekun Kurt Kurti, sikur të thërret një zë i brendshëm, të nxit një thirrje njerëzore për të shkruar qoftë edhe pak radhë. Përsëri sikur mbetemi me një peng, një boshllëk të madh në zemër e në shpirt përpara punëve, provave, gomerëve të jetës, sepse kurrësesi nuk mund të thuhen në përimtësi shembëllimet në detyrë, arritjet, traditat e mbi të gjitha humanizmi në një shkrim të theshtë, si është ky imi, siç është rasti i familjes Kurti nga Shkalla e Xibrit të Matit. Një familje në frontin e mjekësisë, dy prindër: mjeku Kurt Kurti e ndihmës mjeke e mamì Nahile Kurti (Dalliu) me tre fëmijët intelektualë të shquar në mjekësi, në sherbim të shëndetit, të jetës.

• • •

Jeta është luftë, jeta është provë dhe shembëllim. Por këto i ka ai që e vlerëson, që lufton për jetën, për mirësinë, për të lënë gjurmë fisnikërie. Provat dhe shëmbëllimi janë dy bedena që e lartësojnë dhe e zbukurojnë jetën. Këto dy bedena rrezatojnë në jetën e mjekut Kurt Kurti.

Kurt Veli Kurti u lind më 4 prill 1953 në fshatin Shkallë të njësisë vendore të Xibrit të Matit. Arsimin fillor e mbaroi në fshatin e lindjes, në Shkallë, kurse atë 7-vjeçar në Klos. Arsimin e mesëm në gjimnazin "31 Korriku" e përundoi në vitin 1970. Në çdo cikël shkollimi ra në sy zelli, përkushtimi për dituri dhe arritjet e larta mësimore. Në vitin 1976 Kurt Kurti u diplomua mjek në Universitetin e Tiranës. I edukuar nga familja e tij me virtytet e rralla, me dashuri për mësimin dhe traditat, kulturën e mikpritjes, të peshës së fjalës së dhënë e të përpjekjeve për jetën.

Mjeku i ri Kurt Kurti filloi punë dhe shërbeu dy vite në Burrel, shtatë vjet në Xibërr, katër të tjera në Seksionin e Shëndetësisë në Burrel dhe i Qarkut Dibër nga viti 2007 deri 2013. Më 15 gusht 2018 mbushen plot 30 vite pune si mjek i palodhur i ekspertizës në degën e Sigurimeve Shoqërore në Burrel. Kudo ku punoi la gjurmë të përkushtimit, korrektësi e lidhje të ngushta me njerëzit, i thjeshtë, gojëmbël e i papërtuar në mbrojtje të shëndetit të popullit. S'ka fshat e lagje të Xibrit, Klosit, Matit në përgjithësi dhe rrethinat e tyre, që nuk ka shkelur mjeku Kurt Kurti. Te dashuria për profesionin dhe respekti për njerëzit, te vlerësimi i detyrës, njohja e gjuhës së popullit dhe traditave qëndron suksesi në arritjet e këtij intelektuali këmbëngulës në shërbim të popullit, në ndihmë të pacientëve a të njerëzve që janë në nevojë, në kërkim të së vërtetës ligjore në fushën e mjekësisë. Janë të panumërta rastet kur mjeku Kurt Kurti u ka ardhur njerëzve në ndihmë në Shkallë, Xibër, Ketë, Qafë-Murrizë,



Guri i Bardhë etj, duke thërmuar edhe gjumin, duke rendur si maratonomak në ruajtjen dhe kujdesjen e shëndetit. Dhe puna e mirë, shpirti i dlirë, pasioni e sedra profesionale i ka dhënë emër, "dekoratat" më të mëdha, (ndonëse në 43 vite punë shembullore nuk ka asnjë dekoratë) të cilat janë nderimi dhe respekti i popullit, i kolegëve, i lagjes dhe vendlindjes. Provat dhe shembëllimi, ja dy bedenat e mjekut Kurt Kurti.

• • •

Udhët e dijes e të puës, provat në aftësimin profesional dhe ato të sherbimit të kulturuar janë dëshmitë e rritjes që rrezatojnë fisnikëri nëpër vite. Gjurmët e punës së mirë nuk arrihen lehtë. Ata kërkojnë dije, përkushtim, sedër e shpirtmadhësi, cilësi këto që kanë rrezatuar e rrezatojnë te mjeku Kurt Kurti. Kultura dhe traditat familjare, aftësimi dhe pasioni për profesionin, shërbimi ndaj popullit, kanë bërë që të rritet në sy të brezave, të shëmbëllejë dritën e humanizmit, dritë mirësie.

Cilido që e njeh mjekun Kurt Kurti zbulon tek ai thjeshtësinë, nderimin për shokët, urtësinë, dashurinë për vendlindjen, krenarinë legjitime për traditat e familjes, për bashkëshorten e nderuar Nahile Selim Kurti (Dalliu), për tre fëmijët si yje e të mbarë: Miranda, Eduardi dhe Arenita, intelektualë të palodhur në udhën dhe frontin e mjekësisë. Atdhetarizmi dhe geni i bujarisë familjare dëshmojnë qartë te provat e fisnikërisë së babait Veli Kurti e nënës bujare Hamide Osman Kurti (Hidri), të cilët rritën dhe edukuan mjaft mirë djemtë: Kurt (mjek), Ramazan (mësues histori-gjeografie në Kamëz të Tiranës), Haki (bujk në shkallë dhe minator miniere në Batërr e Bulqizë), Hydajet (elektricist në Xibër), si dhe vajzat Mane e Nazmie. Secili nga vëllezërit dhe motrat e Kurt Kurtit ka bërë emër pune, emër për vlerat njerëzore, për fisnikëri të trashëguar nga familja dhe farefisi i nderuar.

Babai, Veliu, në vitin 1944 u radhit në Brigatën XXIII Sulmuese, si luftëtarë i lirisë, ku kreu me besnikëri detyrat si partizan në skuadrën e disiplinës në rajonin Mat-Krujë. Sot bijtë, nipërit dhe mbesat ruajnë si relike të çmuar dëshminë e tij të partizanit, luftëtar i atdheut. Shpesh ai, krahas luftës e qëndresë, kujtonte emrat e Ali Rexhës, Mustafa Kaçaçit e plot të tjerëve. E ëma, Hamide Osman Kurti (Hidri), tregoi prova bujarie e kulture, ku me sakrifica rriti dhe edukoi gjashtë fëmijët (katër djem e dy vajza). Është mbesa e Ali Ahmetit në Xibër-Murrizë, i cili strehoi karvanet e Dibrës dhe njerëzit e eksodit që shkaktuan pushtuesit serbë e plot të tjerë. Për vëllezëtit e nënës së Kurtit, Beqir dhe Halil Hidri, ka shkruar i paharruari Dhimitër S. Shuteriqi. Saliu (brigadier në minierën e Batrrës) dhe Mehmet Hidri në bujqësi, janë modeli i njerëzve të punës, bij të lidhur me fshatin, me traditat e fisnikërisë, njerëz të urtë të kulturës popullore. Të lidhur me minierën dhe bujqësinë, me familjen dhe përvojat e jetës, ata janë shembulli më i mirë i virtyteve, i vlerave dhe tipareve të njerëzve punëtorë me shpirt të fisnikëruar.

Krahas prindërve e dajave të mjekut Kurt Kurti në ecjen përpara ka ndikuar edhe familja e tij e kulturuar dhe e përkushtuar. Bashkëshortja Nahile Selim Kurti (Dalliu), ndihmës mjeke e mamì, që prej vitit 1974 shërben me devotshmëri. Së bashku rritën dhe edukuan tre fëmijë, secili më i mirë e më i zoti se tjetri. Vajza e madhe është infermiere e lartë, specialiste e palodhur laboratori biokimie. Djali Eduardi ka përfunduar Fakultetin e Mjekësisë për stomatolog dhe ka klinikë pune në Paskuqan të Tiranës. Vajza tjetër, Arenita, ka përfunduar Fakultetin e Mjekësisë për farmaciste. Pra, pesë pjesëtarët e familjes Kurti shërbejnë në mjekësi, të gjithë të arsimuar e të përkushtuar. Edhe tre fëmijët me fakultet mjekësie pasojnë shembulllin e prindërve, shembullin human që këto tregojnë mbi katër dekada në ruajtje të shëndetit, në roje të jetës. Gjithçka në përvojat e traditës e të punës në familje ka lënë gjurmë te mjeku Kurt Kurti dhe nuk harrohet në udhët e profesionit e të shërbimit. Kështu, vëllai i gjyshit të Kurtit, Beqiri, ka qënë kryeplak në Shkallë për shumë kohë, por edhe 7-8 vjet emigrant në Turqi.

Mjeku Kurt Kurti gjithnjë flet për traditat dhe kujton me nderim kolegët Xhelal Dezhgiu, Fotaq Gjika, Besim Hoxha, Arianit Bukaçi, Nikollë Bushi, Muharrem Rama, Xhemal Keshi... Për mjekun Kurt Kurti flasin me respekt të thellë të nderuarit Hamdi Hysuka, Faik Xhani, Hasan Nur Frangu, Adem Taka i Xibrit. Jeta dhe puna e mjekut Kurt Kurti është sa e thjeshtë aq dhe e madhërishme, sa e bukur aq dhe e përkushtuar, sa e lodhshme aq dhe krenare. Për vitet e shkollës e të punës, për shërbimet e pakursyera në roje të shëndetit, për familjen dhe fëmijët e edukuar dhe të shquar si intelektualë të mjekësisë, për bashkëshorte Nahilen, ndihmës mjeke dhe mamì e dalluar, mbesë e filozofit, poetit dhe ish-mësuesit të parë Normalist, qëndrestarit përballë vuajtjeve nga diktatura, hafiz Ibrahim Dalliu, për shokët dhe miqtë e harruar, për përvojat dhe gjurmët në roje të shëndetit e të jetës. Ja pra, përse krenohet e duhet të krenohet mjeku Kurt Kurti i Matit. Shërbimet në Burrel e në vendlindje (krahinën e Xibrit), puna në Qarkun e Dibrës dhe përvoja në Seksionin e Shëndetësisë Burrel, tashmë tri dekada pune mjek i ekspertizës në Sigurimet Shoqërore në Burrel, thonë plot gjurmë pune e jete. Ndonëse më 1985 u vendos me banim në qytetin e Burrelit, së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët, nuk e harrojnë vendlindjen, traditat, përvojat. Shembëllimi ndaj detyrës, pasioni në profesion, korrektësia në sherbim mbi dyzet vite punë, kultura e komunikimit, mirësjellja dhe mirënjohja njerëzore, fjalët e mirësisë që shpreh cilido që e njeh në Mat e Dibër, Bulqizë, Klos e Xibër a gjetkë, tregon se mjeku Kurt Kurti është intelektuali i vlerave dhe përkushtimit për jetën. Urime në breznì mjeku Kurt Veli Kurti i Shkallës së Xibrit të Matit!

Dodë Bibë Vladi, kreshniku i Lurës

Nga **DEDË DOÇI**

Lura, jo vetëm është një vend i bukur, të cilën natyra e ka stolisur me të gjitha bukuritë natyrore, por është edhe vendi që ka nxjerrë burra kreshnikë, të njohur jo vetëm në Lurë, por edhe jashtë saj.

I tillë ka qenë Dodë Bibë Vladi nga Lura e Vjetër. Lindi në një familje me tradita atdhetare. Të parët e Dodës, të njohur për besë e trimëri, bujari e mikpritje, punëtorë e të respektuar, për bëmat e tyre jo vetëm janë respektuar por dhe shpërblyer. Doda u rrit krenar për prejardhjen e të parëve të tij, por vetë kaloi një jetë me plot vështirësi, por me punë, guxim, vendosmëri arriti që t'i kalojë vështirësitë dhe të bëjë emër për mirë.

Dodë Bibë Vladi ishte i dashur me njerëzit e afërm të tij, por dhe me fshatin dhe i njohur për pritjen e përcjellje më gjerë. Ai i gëzonte pa masë njerëzit e miqtë që i shkonin në shtëpi, kur thirrej emri i Dodë Bibë Vladit, nga jehona mikpritëse e tij gëzohej edhe dhoma dhe miku apo vizitori i rastit, respektohej dhe i qeshte fytyra nga pritja që bënte. Ky njeri tepër i dashur e gojëmbël. Dodë Bibë Vladi e respektonte fisin e tij, i donte shokët, i ndihmonte dhe gjithmonë u qëndronte pranë. Dodë Bibë Vladi, ky njeri me vlera gjigante njerëzore, ishte nip te fisi i nderuar i Doçit. Aq shumë i donte dajat e vetë sa nuk kursente asgjë për to. E donin dajat por dhe ai i donte shumë. Dodë Bibë Vladi ndihmoi Gjokë Doçin dhe u interesua me të afërm të tjerë, Gjokën si jetim e ka dërguar në strehën varfërore në Shkodër, ku ai i shkollua dhe u formua me ato ide të cilat e çuan deri në aktin sublim që u bë hero i popullit dhe ra heroikisht në luftë kundër gjermanëve. Për formimin e Gjokës ka një meritë të veçantë Dodë Biba, nipi i Doçit të Lurës. Gjoka nderoi veten, Doçet, nipin Dodë dhe gjithë Lurën me luftën që bëri. Pra Doda ishte dhe humanist i madh, bujar e i dashur. Dodë Biba është nipi i Doçit, i ka dashur dajat e vetë gjithnjë, por dhe ato e kanë dashur, e mbanin afër se ishte i vetëm, vinte, punonte e shoqërohej me dajat e vet se për fat i kishte afër. Por Doda jo vetëm si nip i nderuar, por si njeri i madh ka ndihmuar pa masë dajat e vet në momente të forta. Doda ishte i lidhur me forcat partizane, djemtë e tij Biba, Nikolli dhe kushëri Marku punonin për çlirimin e vendit. Në kohën kur partizanët kaluan në Lurë, ato u pritën nga Lura e vjetër dhe shumë partizanë kanë qenë edhe te Gjon Bibë Doçi, i cili ishte major. Pas këtyre momenteve vjen një situatë që shtëpia e dajave të Dodë Bibës, do të digjej nga forca që nuk e dinin veprimtarinë e gjon Bibë Doçit. E në ato çaste kritike, ku Doçi pothuaj se me atë rast do të eliminohej në të gjitha gjërat, roli i Dodë Bibës që shumë i madh. Familja Doçi ishte në mal, shtëpitë do të digjeshin dhe Doçi do të shuhej ndoshta edhe padrejtësisht. Atëherë Doda me guximin e tij të madh, me trimërinë e rrallë që kishte dhe si nip i dashur i Doçit niset dhe shkon e takon Mehmet Shehun, Komandant i Brigadës 2 Sulmuese, e vë në dijeni dhe e njofton se Doçit që ka pritur e përcjellë partizanët po i djegin shtëpitë dhe po e shkatërrojnë atë familje padrejtësisht. Mehmet Shehu i jep letrën Dodës ku theksohej se familja e major Gjon Bibë Doçit nuk i ka lyer duart me gjakun e popullit dhe prandaj të mos i digjet shtëpia dhe familja Doçi të kthehet në shtëpi, sepse nuk e prek kush. Kështu Dodë Biba bën vepër shumë të madhe, që brezat e familjes Doçi nuk duhet ta harrojnë asnjëherë dhe për këtë veprim me pasardhësit e Gjon Bibë Doçit, i jemi tepër mirënjohës atij veprimi që bëri Doda për familjen tonë. Doda luftonte edhe për luras të tjerë që ka shembuj plot që ka bërë mirë. Por edhe me dajën e vet Llesh Bibë Doçin nipi Dodë Bibë Vladi është treguar burrë trim dhe shumë i dashur. Në kohën që Llesh Bibë Doçi do të arrestohej edhe padrejtësisht, Doda, shkon dhe e lajmëron: Dajë ik, largohu se do të arrestojnë. E kush mund të lajmëronte në atë kohë për ato veprime? Vetëm një njeri trim e shumë i dashur si Dodë Biba. Prandaj Doda është ndër nipat më të mirë të shtëpisë së Doçit. Ai ishte kushëriri i Mark Ndoc Vladit, Beqir Valterit, Dalip Kacit, Gjokë Lleshit, Ali Musë Hotit, Hamit Kolës etj. Dashurinë për dajat e vazhduan edhe Biba, Nikolli e Gjoni djemtë e Bibës. Familja e Dodë Bibë Vladit ka spikatur dashuri njerëzore, humanizëm. Doda dhe djemtë e tij e njihnin jetën prandaj Biba i shkolloi djemtë e vajzat. Nga familja e Bibë Vladit doli mësuesja e parë e Lurës, Margjela Vladi, doli deputeti Dodë Bibë Vladi (i riu). Dodë Bibë Vladi jetoi një jetë mbi një shekull, por gjithmonë ishte zemërmirë, bujar dhe edukoi brezin e ri me shembullin e vet. Dodë Biba është modeli i njeriut të mirë. Ai ishte një burrë fisnik, një kreshnik malesh.



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Me rastin e 20 vjetorit të vdekjes

Mentor Disha dhe familja Disha nga Dibra

Nga **ARSIM KOLARI**

Familja Disha nga Dibra e Madhe është njëra nga ato familje që ndër vite ka kontribuar në mjekësi, jo vetëm për qytetin, por edhe më gjerë. Kontributin, kjo familje, më së shumti e ka dhënë në fushën e mjekësisë, profesion ky që cilësohet "i shenjtë" dhe mjaft fisnik. Duke zgjedhur këtë profesion, për të cilin lirisht mund të themi se më shumë të bën të japësh sesa të marrësh, familja Disha e krijoi një imazh pozitiv në sytë e gjithë atyre që i njohin. Para pak kohësh, ndërroi jetë "kryekurora" e kësaj familjeje, prof. dr. Mentor Disha, i cili la pas vetes një bagazh të madh mbushur me veprimtari të gjithanshme profesionale.

Ai u lind në vitin 1934 në Dibër, shkollën fillore e kreu në qytetin e lindjes, të mesmen në Tetovë, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin Farmaceutik në Zabreb, në vitin 1963. Pas mbarimit të studimeve, prof. dr. Mentor Disha fillimisht u punësua si mësimdhënës në gjimnazin e Dibrës, pastaj edhe në Laboratorin Biokimik të Qendrës Diagnostike të Prishtinës, në të cilin që nga viti 1970 u emërua kryeshef. U martua me zonjën Myrvete Dehiri – Disha, me profesion matematikante, e cila vjen nga një familje e ngritur në Prizren dhe është motra e prof. dr. Ismet Dehirit, njërit nga profesorët më të dalluar të katedrës së matematikës në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1973, prof. dr. Mentor Disha u specializua në Biokiminë mjekësore në Lubjanë, ndërsa më 1975 emërohet shef i Laboratorit të Radio kimisë në Njësinë e Mjekësisë Nukleare të Qendrës Diagnostike në Prishtinë. Pas 2 vitesh e mbron temën e magjistraturës me titull: "Ndikimi i acidit askorbik në nivelin e holesterolit në gjak".

Që nga viti 1978 u përzgjodh si ligjërues i lëndës "Farmakologji dhe toksikologji" në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Temën e doktoraturës "Hulumtimi i ndikimit të kortikosteroideve në funksionin e gjëndrës mbiveshkore", e mbrojti në vitin 1985 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Një vit më pas zgjidhet docent, ndërsa si profesor inordinar në lëndën e Farmakologjisë me toksikologji. Prof. dr.Mentor Disha është autor i tre librave universitarë: "Receptura mjekësore" (1985, 1987, 2001), "Farmakologjia mjekësore" (1988, 1990) dhe "Bazat e farmakoterapisë" (2000,2003). Ai ishte pjesëmarrës në shumë simpoziume dhe kongrese, e deri në fund të jetës botoi mbi 50 punime profesionale e shkencore. Kontributi i tij në hapjen e Degës së Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë së Prishtinës, është i madh.



Kontributi Mentor Dishës në hapjen e Degës së Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë së Prishtinës është i madh. Në vitin 2016 u dekorua nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi me Medaljen Presidenciale të Meritave për kontributin e dhënë në shërbimin civil.

Pensionohet në vitin 2003, ndërkaq në vitin 2016 u dekorua nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi me Medaljen Presidenciale të Meritave për kontributin e dhënë në shërbimin civil.

Djali, Bersanti ka kryer fakultetin e ekonomisë në Angli, ndërsa aktualisht është drejtor në njërën nga sipërmarrjet më të fuqishme për konsultime biznesore në Kosovë që titullohet "Recura". Adem Disha është vëllai i prof. dr. Mentorit, i cili deri në pension punoi si mjek i përgjithshëm në Dibër dhe Tetovë, ndërkaq vajza e tij Dafina është farmakologe në Tetovë. Kushëriri, Abdulla Disha ishte internisti më i dalluar në rrethin e Dibrës, dhe më gjerë, i cili la pas vetes një karrierë të mbushur me suksese mjekësore. Edhe fëmijët e kushëririt tjetër Abdylit (ekonomist), janë me profesion: Kushtrimi, specialist për kardiokirurgji në Gjermani, Liridoni mjek amë me ambulancë private, njëkohësisht dhe bashkëshortja e Abdylit, Myzejeni ka qendrën e saj gjinekologjike në Tetovë.

Njerëzit që përmbushin objektivat në jetë, janë të rrallë, ndaj në rastin tonë mund të themi se kemi të bëjmë me intelektualë të cilët dhanë dhe vazhdojnë të japin kontribut të madh për shoqërinë tonë. Gjetja e lumturisë së jetës ka ndikim më të madh në qenien njerëzore, sesa kushtet ekonomike, e familja Disha ka preferuar të parën që me punën e palodhshme t'i bëjë të lumtur të gjithë ata persona që u janë drejtuar, ndaj për ne ata sot janë "heronj të kohës"!

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Shefki Lleshi, 50 vjet këshilltar i fshatit Zogje të Dibrës

Nga **YMER STOJKU**

20 vjet më parë më 11 prill 1997 u nda nga jeta patrioti e veterani i luftës dhe i punës, Shefki Lleshi.

Fshati Zogje i Grykës së Vogël të Dibrës është një fshat me histori të vjetër të shkruar me gjak e skrifica në luftë për liri, pavarësi e dinjitet. Aty banon një popull nga gjiri i të cilit kanë dalë, luftëtarë, patriotë, burra shteti, njerëz të zgjuar, punëtorë e atdhetarë. Njeri prej tyre është dhe Shefki Allaman Lleshi lindi më 25 janar 1921 në një familje të varfër, me pak tokë, por me zemër të madhe. Babai i tij Allamani ish martua me Handije Abaz Xhurxhin nga Hoteshi, vëllai i së cilës Abdullai i porsa fejuar u vra më 1913 tek Ura e Topojanit kundër serbëve. Më 23 Janar 1913 shtëpia e Allaman Lleshit bashkë me fshatin u dogjën nga pushtuesit sërb, Siç tregonte nën Hamdija më shumë keq më erdhi se bashkë me shtëpinë u dogj një kostum kombëtar me xhubletë që të parët e kësaj familje e kishin rruajtur brz pas brezi. E kisha porosi nga vjera ime ta rruahj brez pas brezi.

Në vitin 1913 në Zogje u dogjën shumë shtëpi nga serbi, ndër të cilat dhe shtëpia e Allaman Lleshit. Nëna e Qamilit dhe Shefkiut tregonte se nuk më erdhi keq për shtëpinë sa më erdhi keq për arkën time në të cilën kisha një kostum me fustanellë burrash, që ishte ruajtur për shumë breza, të cilin ma kish lënë në ruajtje vjehrra ime.

Gjendja ekonomike e familjes u rrënua pasi Allamani vdiq më 1925 duke lënë 4 fëmijë jetim në moshë të vogël. Me ndihmën e njerëzve të afërm, Bexhet, Nezir, Dilaver e Sinan Lleshi mundi të mbijetonte. Qamili, duke qenë më i madhi i ra barra për drejtimin e familjes. Me punën e tij u bë e mundur të shtojnë tokën ekzistuese, të bëjnë disa investime të vogla, pak blegtori, një dyqan që e furnizonte me mushkë nga Tirana për nevojat e fshatit, duke përmirësuar gjendjen ekonomike.

Të dy vëllezërit e ndjenë thellë në ndërgjegje pushtimin e vendit nga Italia fashiste. Informacionin për gjendjen Qamili e merrte gjatë lëvizjeve që bënte nga Zogjet në Tiranë, tranzit, ku ishte dhe garanti kryesor i mbajtjes së kontaktit të Haxhi Lleshit me Bab Myslimin, shpesh edhe njeriu i besuar për sjelljen e florinjve të familjes Lleshi për Çetën e Pezës.

Me krijimin e Çetës së Dibrës familja e Qamil e Shefki Lleshit u lidhën me luftën, ashtu si gjithë fshati ishte bazë e saj. Më 30 Shtator 1942 në dasmën e Qamil Lleshit ishin ftuar të gjithë partizanët e Çetës së Dibrës. Dy kompani italjane rrethuan fshatin dhe dogjën shtëpinë e Haxhi Lleshit. Pasi çau rrethimin Çeta u ngjit malit, ndërsa italjanët i kapi paniku, duke kërkuar garanci për të zbritur në rrugën nacionale. Kjo ngjarje bëri bujë në fshatrat e Grykës së Vogël duke rritur simpatinë për luftën partizane që u duk me shtimin e rradhëve të çetës me vullnetarë të rinj.

Në reaksionin e dimrit të shkurtit 1944 një togë gjermane vjen në Zogje e kontrollojnë për armë fshatin. Kontroll të imtësishëm ushtruan në shtëpinë e Qamilit e të Shefkiut duke i rënuar gjthëçka. I arrestuan dhe i dërguar në burg në Dibër të Madhe ku qëndruan dy muaj. Ferit Leka kryeplak i fshatit,



Shefki Lleshi gjithë jetën e tij ia kushtoi luftës për çlirim, për lulëzimin e përparimin e fshatit, për edukimin e forcimin e familjes, duke çuar përpara traditat e patriotizmit, besës, bujarisë, mikpritjes, dashurisë për njerëzit...

burrë fisnik e trim, mbështetës i luftës, bëri përpjekje për lirimin e dy të rinjve, por vendimtare për arratisjen e tyre nga burgu ishte ndihma e Qazim Nokës. Atij i dedikohet shpëtimi i Qamil dhe Shefki Lleshit.

Më 26 korrik 1943 Qamili e Shefkiu u inkuadruan në Bataljonin partizan të Dibrës, pas një viti në Brigadën e 18-të sulmuese. Në mars 1943 këshilli Nacionalçlirimtar zgjodhi Iljaz Lekën kryetar e Shefki Lleshin sekretar. Për pjesëmarrjen në luftë si partizan që me krijimin e Çetës së Dibrës është dekoruar me medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe Trimërisë. Mori pjesë në të gjitha aksionet e çetës të batalionit të Dibrës, ku spikati guximi, qetësia e ndihma për shokët, njohës i mirë i teritorit ku bëheshin luftimet, zgjuarsia në manovrimet e shpjetësia e veprimeve luftarake për asgjësimin e armikut me sa më pak humbje.

Në dhjetor 1947 martohet me Muzejen Selim Zeraliu (motra e Ali Zeraliut), një familje fidsnike, bujare e shumë humane nga Dibra e Madhe, ardhur në Hotesh, pastaj në Çetush e Peshkopi, sot në Tiranë. Më 1947 filloi punën si nëpunës i Komunës Zerqan, por u largua nga puna se e mobilizuan në ushtri. Gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak e mobilizuan në aksionet e ndërtimit të rrugës Berat-Skrapar dhe Gramsh-Lozhan (1949) ku mori edhe medalje pune. Me përfundimin e shërbimit ushtarak u kthye në fshat dhe u muar kryesishtë me bujqësi duke përmbushur eshe detyrat shoqërore si këshilltarë. Uzgjodh edhe anëtar i këshillit të rrethit Shuprnzë dhe anëtar i këshillit të Lokalitetrit.

Më 1958 i vdes vëllai i madh Qamili prandaj iu desh të përballojë rritjen e shkollimin e 9 fëmijëve, 1 inxhinjer, 2 mësues, 2 oficerë, 2 ndihmës mjekë e 1 mekanik.

Shefki Lleshi për 40 vite rrjesht si kryetar këshilli (1952-1992) bëri përpjekje për ruajtjen e unitetit në fshat. Bashkë me Dan Dacin, Sali Menën, Ismail Kajën, Faik Lleshin, Haxhi Lekën, Lahim Lleshin, Xhevat Dacin, Siri Marken, Shefqet Dacin, Skender Krrusën, etj. Bën të mundur që fshati Zogje të dallohej në përmirësimin e mënyrës së jetesës, shërbimit mjekësor, zgjerimit të arsimit, shërbimit tregëtar etj. Më 1960 u ndërtua shkolla 7 vjeçare, më 1968 fshati u lidh me rrugë automobilistike, më 1969 ishte në krye të aksionit të elektrifikimit, më 1984 u hap shkolla e mesme bujqësore, maternitetit, njësia e re tregëtare, etj.

Përgjegjës sektori për disa vite në kooperativën bujqësore për fshatrat Zogje, Shtushaj e Bllacë, ai kishte një autoritet që imponte respekt, ishte i matur, fjala e tij kishte peshë dhe zinte vend.

Marrëdhënjet e tij me njerëzit ishin të sinqerta e tepër njerzore, kujdesej për lejet e punësimit në ndërmarjet shtetërore për bashkëfshatarët, shkollimin e fëmijëve në shkolla të mesme e të larta, për leje të ndërtimeve të reja të shtëpive, të kanaleve vaditëse, ujit të pijshëm, etj.

Me ardhjen e demokracisë, në Zogje nuk pati asnjë problem për trojet e zëna. Disa vite më vonë, Lazim Leka banor i këtij fshati tregon se paraqita pranë këshillit një kërkesë për leje ndërtimi për shtëpinë e re. Megjithëse kërkesa ishte brenda vijës së verdhë të miratuar për ndërtim, Shefkiu më porositi të shkoj e të bisedoj me të zotin e tokës para kolektivizimit dhe nëse ai është dakort, filloje ndërtimin e shtëpisë se do t'a marrësh lejen. Kështu veproi Shefkiu me të gjithë fshatarët që ndërtonin shtëpi të reja në Zogje.

Për arsimtarët, kuadrin mjekësor, të ekonomisë, etj. që vinin me shërbim e punë në Zogje ai tregonte një interes e kujdes të veçantë për strehimin, furnizimin, shpesh i merrte në shtëpinë e tij për t'u krijuar ambjent të ngrohtë e dashamirës. Shumë nga kuadrot që punuan në Zogje si Thanas Caka, (Tiranë) Kadri Kashari (Elbasan), Rakip Çirku, Ibrahim Derni (Krajkë), Muharem Kurti, Ramadan Meta, (Zall Sopot),* Shaqir Shaba e Sabri Apulja (Dibër), Ali Puca (Zerqan), Muharrem Kurti (Ostern), Ibrahim Dervishi (Krajkë), Ramadan Meta (Zall Sopot), Hamdi Pira (Kishavec), Skënder Kuta (Blliçe), Lume Kuka (Zerqan), Abedin Ethemi, Hashim Osmani e Halim Stafa (Maqellarë), Sadik Meda e Sami Kola (Brezhdan), Muharrem Skana (Lurë), Naim Manuka (Luzni), Sokol Agolli (Tiranë), Ali Izvira (Gjoricë), Jahe Bojku, Arif Mata, Kristo Mazniku, Baftjar Shahini, Uran Besatari e Burhan Xhembulla (Peshkopi), Shuaip Methasani (Sohodoll), Fiqiri Sefa (Tiranë), Vladimir Pashaj (Sarandë), Spiro Treska (Korçë), Kosta Fera (Gjirokastër), Mustafa Doku e Rakip Skuqi (Kavajë), Safet Rugji e Koço Kromidha (Sarandë), Hekuran Rezhda (Librazhd), Alem Bode (Gjirokastër), Sulejman Haxhia (Tiranë), etj. krijuan miqësi e ruajtën lidhjet midis tyre për një kohë të gjatë.

Shefki Lleshi gjithë jetën e tij ia kushtoi luftës për çlirim, për lulëzimin e përparimin e fshatit, për edukimin e forcimin e familjes, duke çuar përpara traditat e patriotizmit, besës, bujarisë, mikpritjes, dashurisë për njerëzit, të afërmit, miqtë e dashamirësit. Shembulli i tij do të kujtohet e respektohet brez pas brezi.

Tiranë mars 2017


Radomirë
Korab-Koritnik
Peshkopi
Tomin
Zall Dardhë
Fushë Çidhën
Arras
Kastriot
Fushë Muhur
Luzni-Bulac
Selishtë
Tamishej
Gropa (fusha) e Panairit
Karsti i Malit te Bardhe
Bjeshka e Zonjave
Pasqyrat e Grames
Vakufi i Sines se Siperme (Lis)
Shpella e qytezes
Burim termomineral i Lixhave
Rabdishtë
Burimet e Belloves
Shkolla e Kultures Fizike
Kisha e Shpërfytyrimit
Kalaja e Grezhdanit
Ujevara e Pocestet
Burimi i Kerçinit
Kisha Shën Mitrit
Kërçisht Sipërm
Kërçisht I Poshtëm
Pocestë Magellarë
Rrapi i Kercishtit
Banistë
Xhamia e Allajbegisë
Kulla e Sali Markës
Kulla e Zunës
Brest I Sipërm
Brest I Poshtëm
Sohodoll I Vogël
Sohodoll
Katund I Ri
Lugjej
Nezhaj
Sillovë
Vleshë
Ujë ftohtë-Vleshe
Dardhë
Tartaj
Lashkizë
Shënllesh
Soricë
Mezes
Cenaj
Gështenjë
Remaj
Shullan
Tallamaz
Kroi i Mbretit-Serakol
Liqeni i Zi
Derbac
Stordok
Rade
Cernier
Palokut
1304
Sufaj
Lemç
Ymeraj
Elezi
Bodine
Dacellarë
Kallé
Zall Kalis
Ratkë
Lahaj
Curraj
Shafell
Hisë
Sllatinë
Dushka
Manjanet
Venishtë
Fezai
Rucaj
Dipjakë
Palaman
Trojak
Lubers
Lugjej
Cankade
Shumbat
Prenxhaj
Mustafë
Gjonaj
Ruse
Gur I Zi
Grykë Nokë
Cidhën
Cidhna e poshtme
Koder Leshaj
Laçaj
Rreth Kale
Kuben
Rreth Ri
Billiçe
Renxe
Renz
Dece
Limjan
Rremallat
Vranjt
Shllinasi
Kodrat e Lajthise
Kodrat e Nalta
Vcles
Estrefaj
Bahute
Zimurë
Makishti
Kulla e Zunës
Kukaj
Pergjergje
Vajmëdhe
Vajnëci
Deshat
Borovjan
Kishavec
Kandër
Hasaj
Hysena
Zdojan
Brezhdan
Ushtelencë
Pollozhan
Dohoshisht
Grevë
Bugjunec
Cipure
Rashnapojë
Tomin
Pitare
Kabes
Lisi
Kabe
Staravec
Cerjan
Melan
Ilnicë
Trenë
Pjeçë
Pejkë
Trepçë
Selanë
Arn I Sipërm
Arn I Poshtëm
Lisnan I Sipërm
Lisnan I Poshtëm
Hotesh
Erebarë
Dovolan
Popinarë
Gradeci
Greadeci
Cukaj
Mazhicë
Gjuras
Shpukthi
Kovashicë
Fushë E Vogël
Katund I Vogël
Topojan
Çernenë
Voinikë
Bunm
Majtarë
Kllobçisht
Podgorcë
Okshatinë
Bllatë E Sipërme
Bllatë E Poshtme
Bllacë
Kodras
Zogaj
Stushej
Shtylla e Eperme
Vlorës
Lukan
Butell
Rabos
Selishtë E Sipërme
Kacni
Sheshi I Madh
Prati
Derrave
Xhetaj
Shorokan
Bulaçe
Muhur
Hurdhë Muhur
Shqafn
Vishe
Deve
Gjilote
Doke
Gjate
Sinë E Sipërme
Sinë E Poshtme
Pashnjaj
Meskan
Qan
Krashi
Ymeraj
Vila
Ceraj
Xhedhu
Topuzaj
Nezhaj
Ruse
Gur I Zi
Gryke Nokë
Cidhën
Koder Leshaj
Mustafë
Prenxhaj
Gjonaj
Lazdre
Sarai
Kodër Leshaj
Rreth Ri
Laçaj
Arras
Vakufi i Sines se Siperme (Lis)
Sinë E Sipërme
Sinë E Poshtme
Pashnjaj
Doke
Gjilote
Gjate
Bulaçe
Muhur
Hurdhë Muhur
Shqafn
Vishe
Deve
Lukan
Butell
Rabos
Selishtë E Sipërme
Kacni
Sheshi I Madh
Prati
Derrave
Xhetaj
Shorokan
Tartaj
Lashkizë
Shënllesh
Soricë
Mezes
Cenaj
Gështenjë
Remaj
Shullan
Tallamaz
Kroi i Mbretit-Serakol
Liqeni i Zi
Derbac
Stordok
Rade
Cernier
Palokut
1304
Sufaj
Lemç
Ymeraj
Elezi
Bodine
Dacellarë
Kallé
Zall Kalis
Ratkë
Lahaj
Curraj
Shafell
Hisë
Sillatinë
Dushka
Manjanet
Venishtë
Fezai
Rucaj
Dipjakë
Palaman
Trojak
Lubers
Lugjej
Cankade
Shumbat
Prenxhaj
Mustafë
Gjonaj
Ruse
Gur I Zi
Gryke Nokë
Cidhën
Cidhna e poshtme
Koder Leshaj
Laçaj
Rreth Kale
Kuben
Rreth Ri
Billiçe
Renxe
Renz
Dece
Limjan
Rremallat
Vranjt
Shllinasi
Kodrat e Lajthise
Kodrat e Nalta
Vcles
Estrefaj
Bahute
Zimurë
Makishti
Kulla e Zunës
Kukaj
Pergjergje
Vajmëdhe
Vajnëci
Deshat
Borovjan
Kishavec
Kandër
Hasaj
Hysena
Zdojan
Brezhdan
Ushtelencë
Pollozhan
Dohoshisht
Grevë
Bugjunec
Cipure
Rashnapojë
Tomin
Pitare
Kabes
Lisi
Kabe
Staravec
Cerjan
Melan
Ilnicë
Trenë
Pjeçë
Pejkë
Trepçë
Selanë
Arn I Sipërm
Arn I Poshtëm
Lisnan I Sipërm
Lisnan I Poshtëm
Hotesh
Erebarë
Dovolan
Popinarë
Gradeci
Greadeci
Cukaj
Mazhicë
Gjuras
Shpukthi
Kovashicë
Fushë E Vogël
Katund I Vogël
Topojan
Çernenë
Voinikë
Bunm
Majtarë
Kllobçisht
Podgorcë
Okshatinë
Bllatë E Sipërme
Bllatë E Poshtme
Bllacë
Kodras
Zogaj
Stushej
Shtylla e Eperme
Vlorës